# Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (102). TETOR 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.






**Market KEN**

*Laprakë, Tiranë*
*Tel: +355 4 22 50 480*
*Cel. 068 20 36 394*




INTERVISTË

## Iva Mera: Babai nuk donte të merresha me art

Nga **SASHENKA NDREKA** - FAQE 10



BOKS

## Keta, flori i mbitokës së Bulqizës!

FAQE 8




## Rikthehet Korabi

# Folklori, teatri *dhe* libri *në* Odën e Dibrës









Zhvillohet në Peshkopi edicioni i 20-të i Odës Dibrane, festivalit folklorik mbarëkombëtar, ku konkurrojnë 25 grupe nga të gjitha trojet shqiptare. Mbi 100 autorë dhe mbi 300 tituj librash prezantohen në Panairin e Parë të Librit në Peshkopi. Autorët dibranë dhe botimet për Dibrën ishin kryefjala e këtij panairi.
Në Dibër të Madhe për 7 net me radhë mbahet edicioni i 13-të i Festivalit të Teatrit Shqiptar.
Raport special nga SASHENKA NDREKA, ATLI DEMA, NEKI FETA dhe opinione nga VELI VRANIÇI, ILIR KROSI, BUJAR LESKAJ, ARIAN SUKNIQI, ZEF ÇOBA, ARIAN AVRAZI, ERMIR DIZDARI, ISAK SHEHU
Speciale në faqet 4-7,9-13

Reportazh / Ne Reken e Eperme, ne gjurmet e ortodokseve shqiptare

# Të (mos) jesh shqiptar

Nga **MARIN MEMA**

Për shqiptarët ortodoksë të Maqedonisë flitet pak. Të lenë mënjanë nën presion të vazhdueshëm dhe ballë skemave përçarëse me shqiptarët e besimit mysliman shumica u asimiluan, duke krijuar një identitet artificial e të largët nga ai i vërtetë shqiptar. Fshatra të tërë që dikur flisnin gjuhën e tyre sot janë braktisur apo janë asimiluar e megjithatë gjurmët janë ende aty. Ne do të përpiqemi të ecim përmes tyre për të sjellë të vërtetat ende të pashuara të këtij komuniteti.

Shumica e këtij komuniteti ka qenë e vendosur në zonën e Rekës së Epërme, jo larg Dibrës dhe dikur pjesë e natyrshme e saj. Deri të paktën 100 vjet më parë në këtë zonë që ka pasur rreth 15 mijë banorë, masa dërrmuese ishin shqiptarë të besimit ortodoks, të shpërndarë në 18 fshatra. Dokumentet që flasin për përkatësinë etnike shqiptare të kësaj zone janë të shumta e mund të gjendet mjaftueshmërisht ndër ata autorë e studiues që kanë hulumtuar mbi Rekën dhe banorët e saj. *(Vijon në faqen 2)*

Studim

## Reka e Epërme, plagë e pashëruar në popull

Në mesin e shumë dijetarëve atdhedashës nga Shtirovica, dallohet edhe Matej Milani, i cili ishte i lindur në fshatin Shtirovicë më 1886. Gjatë kohë jetoi dhe punoi në Rumani. Sipas rrëfimit të birit të tij Danielit, i ati i tij ka qenë atdhetar i flaktë. Aq shumë pat vepruar ai për përhapjen e librit shqip e të dritës së shenjtë të atdhedashurisë shqipare, saqë e zënë serbët dhe e nxjerrin ta dënojnë para krajlit në Beograd....

Nga **EDIBE SELIMI - OSMANI** - FAQE 17

Rruga e Arbërit nr. 102

reportazh

**Emisioni "Exclusive" në Top Channel transmeton reportazhin e gazetarit Marin Mema gjatë udhëtimit në Rekën e Epërme, në kërkim të gjurmëve të Ortodoksëve shqiptarë.**
**Gazeta falenderon gazetarin Marin Mema për lejen e dhënë për botimin e tekstit të këtij dokumentari.**
**Emisionin "Exclusive" mund ta shihni në youtube në linkun e mëposhtëm:**
https://www.youtube.com/watch?v=CdGTDCelcbg&list=UUyny-dfYPbE-CjAkzkZqF8A&index=416

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 10 (102). 1 - 31 Tetor 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: R.Gjini, A.Keta, F.Xhani, S.Mëziu, H.Përnezha, J.Selmani, D.Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

**JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Kontribuan për këtë numër:
Marin MEMA
Sashenka NDREKA
Atli DEMA
Neki FETA
Hysen LIKDISHA
Edibe SELIMI - OSMANI
Nexhmie MEHMETI
Veli VRANIÇI
Bujar LESKAJ
Ilir KROSI
Aria SUKNIQI
Zef ÇOBA
Arian AVRAZI
Ermir DIZDARI
Isak SHEHU
Besnik RAMA
Jahe DELIA (SELMANI)
Ymer STOJKU
Sakip CAMI
Mentor HOXHA
Beqir SINA
Xhelal ROÇI
Faik XHANI
Hasan LLESHI
Ramazan BUCI
Sabri GJECI

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

# Të (mos) jesh shqiptar

*(Vijon nga faqja 1)*

Në dokumentet e kohës së perandorisë osmane, por edhe ato më të vona serbe e bullgare, thuhet se rreth 80 për qind e ortodoksëve të Rekës ishin shqiptarë. Ishte pikërisht përkatësia e tyre fetare ortodokse që tërhoqi fillimisht bullgarët e më pas serbët në turin për të asimilimuar këtë pjesë të komunitetit. Gjithçka nisi kryesisht në fillimshekullin e 19-të u ndal disa kohë për shkak të Luftës së Dytë Botërore dhe mori trajtë të plotë e të dhunshme sidomos pas krijimit të Jugosllavisë ose më së qarti pas prishjes së Shqipërisë komuniste të Enver Hoxhës me Jugosllavinë e Titos. Presioni i vazhdueshëm, dhuna në ndryshimin e mbiemrave, shkollimi i detyrueshëm vetëm në gjuhën sllave e më pas edhe joshja me mënyra të ndryshme çoi në një proces asimilimi dhe largimi masiv. Kjo ishte e vetmja zgjidhje për këtë zonë të thelle, por me zemër të madhe që përballoi tepër dhunë mbi kryet e saj, duke nisur nga humbja e detyruar e identitetit kombëtar. Për të gjetur Rekën e dikurshme mjafton të shikosh fotografitë e vjetra. Dasmat karakteristike, luftëtarët, banorët e këtyre zonave e gjithçka tjetër që flet për identitetin e tyre përmes veshjeve e traditave të shumta.

Zverdhëtira e fotografive humbet shpejt e shkrihet në kërkim të realitetit të sotëm…

***

Menjëherë pas kthesës nga aksi nacional, rruga ashpërsohet e kthehet në një shteg të rrjepur e të lënë pas dore si e gjithë zona. Nishpuri është një nga fshatrat e parë dhe më i afërti me rrugën. Fshati duket i heshtur, shumica e shtëpive, banorët e vetëm kanë drynët e rëndë e të vetmuar që mbajnë kryqëzuar dyert. Pas tyre nuk duket askush.

Nishpuri ka qenë i banuar historikisht nga banorë myslimanë dhe ortodoksë shqiptarë. Po, nëse nga të parët mund të gjesh ende, të dytet, ortodoksit, janë larguar thuajse tërësisht.

Halil Bajaziti:

- Shqiptarët ortodoksë apo ortodoksit e fshatit tuaj flasin shqip?

- Po, flasin shqip. Po për të pretenduar, pretendojnë se janë shqiptarë apo maqedonë? Po s'e pranon kush atë .

- Pse nuk e pranojnë? Ku di unë, ç'të të them për atë? Këtu mendoj një gjuhë kemi, por ama atje kur shkojnë, mendoj në Gostivar, Shkup, flasin maqedonisht.

Mjafton një rrotullim i thjeshtë fshatit për të kuptuar realitetin... tabelat e shtëpive, çezma apo edhe në varreza nuk mund të gjesh qoftë edhe një emër ortodoks shqiptar. As edhe një të vetëm. Gjithçka është në gjuhën maqedone.

Është e kotë të trokasësh dyerve të familjeve ortodokse, nuk gjejmë askënd. Por ajo që vihet re lehtësisht është se shtëpitë e myslimanëve janë të thjeshta, për të mos thënë të rrënuara, ndërsa ato të ortodoksëve janë vila disa katëshe. Nga kjo kuptohen lehtësisht mundësitë e ndryshme financiare. Një ndër skemat e asimilimit ka qenë joshja përmes posteve shtetërore, pse jo edhe të larta në Shkup, çka u garanton të ardhura mjaft të mira në krahasim me pjesën tjetër të shqiptarëve që duhet të përballen me vështirësi të pafundme për të garantuar mbijetesën në këto zona të vështira.

Fshatrat vijnë rreth të njëjtës zonë malore që sa vjen e ngjitet majave. Është e vështirë të orientohesh, aq më tepër që rrugët janë të shkreta e bëhen gjithnjë e më të vështira.

Më në fund duken njerëz, janë dy roje ndoshta të parkut kombëtar, apo të një centrali pranë. Siç thuhet, postet shtetërore ju ofrohen vetëm shqiptarëve ortodoksë, si një mënyrë kjo për të fituar heshtjen e tyre në lidhje me identitetin e vërtetë. Nëse u kërkon një intervistë normale, është e pamundur, askush prej tyre nuk pranon të flasë, ndaj edhe gjithçka duhet bërë në mënyrë të fshehtë. Është interesante të përballesh me një shqipe arkaike, të vështirë shpesh për t'u kuptuar nga ata që nuk e kanë veshin të rrahur. Shqipja ka mbetur e tille, e mbyllur mes banorëve në këto zona të largëta e pa shumë kontakte me pjesët e tjera.

*Rojet:*

- *Si quheni, më fal?*
- *Ilko unë jam.*
- *Ilko?*
- *Po.*
- *Jeni ortodoks?*
- *Maqedon jam unë, maqedon. Ama e di gjuhën .*
- *Nuk jeni shqiptar?*
- *Jo.*

Tabelat udhëzuese duken po aq të vjetra sa gurët e kullave të fshatit të radhës, Brodecit...

Edhe ky fshat ka qenë dikur i tejmbushur me shqiptarë ortodoksë, ndërsa sot duket sikur këtu jetojnë vetëm gërmadhat dhe shtëpitë e vetmuara. Ku humbën shqiptaret, pronarët e vërtetë të këtyre tokave?!

As edhe qoftë një banor nuk duket rrugicave. Shtëpitë hijerënda kanë strukturën tipike të kullave shqiptare, janë të vendosura jo larg njëratjetrës si për të treguar që komuniteti ka qenë mjaft i lidhur. Edhe përmes kishave është e pamundur të identifikosh diçka, sa kohë objektet e kultit të dikurshme u shkatërruan në mënyra të ndryshme në kohën e Jugosllavisë e në vend të tyre u ngritën të tilla tërësisht të reja. Morsa e regjimit sllav duhet të funksiononte edhe mbi besimin e shqiptarëve ortodoksë.

Kilometra më tej ngrihet edhe fshati Bogde, po aq bosh sa edhe pjesa tjetër. Duket sikur mbi këto fshatra ka ndodhur një luftë e në fakt shumë të tilla kanë ndodhur në mënyra të ndryshme mbi banorët. Shqiptarët u detyruan të ikin në një braktisje masive, deshqiptarizimi ishte i pamëshirshëm. Sot shtëpitë e rëna mbi vete flasin më shumë se gjithçka. Dyer të ngujuara, dritare të errëta e zona të tëra që flasin vetëm përmes natyrës e bukurisë së saj. Të vetmet objekte të ruajtura janë kishat, ato rinovohen nga shteti herë pas here, sigurisht ato nuk kanë asnjë element shqiptar.

Si për të konfirmuar tezën e punësimit shtetëror si një formë për të mbajtur varur edhe të mbeturit, tejmi në rrugën për në fshatin Verben takojmë një tjetër roje shtetërore. Edhe pse i ngurte, është më miqësor se të parët. Mes fjalëve të tij mund të kuptosh jo pak.

*Roja:*

- Gjuhë mëmë, kë keni?
- Gjuhën e nënës, atë shqipen .
- Shqipen? Dmth shqipen keni gjuhën e nënës?
- Po, bre, po.
- Tani jeni maqedon?
- Gjuhën e nënës shqip, edhe kemi mësuar maqedonisht dhe kur të shofësh jemi edhe njërën, edhe tjetrën.

Pas rreth 3 orësh për jo më shumë se 150 kilometra nga Dibra e Madhe duket Verbeni. Është ndër fshatrat ku ende ka frymëmarrje e ku pavarësisht largimit ka ende ç'të gjesh.

- Po nja 30, 30 shtëpi apo 30 banorë?
- 30 shtëpi
- Ka qenë më i madh më përpara?
- Po, më i madh ka qenë, ama kanë shku.
- Jeni shqiptar apo maqedon?
- Maqedon jam, por ama dimë shqiptarçe edhe maqedonçe edhe serbçe.
- Këtu fshati është ortodoks?
- Po ka nja dy- tre shtëpi që janë myslimane.
- Ju quheni Josif?
- Po.
- Ju, nga cili vend jeni?
- Ne jemi nga Shqipnia .
- Po e fliskeni shumë mirë shqipen .
- Po, e dijmë jo mirë, ama e dijmë pak.

Nëse i referohesh pozicionit gjeografik të Rekës së Epërme, ajo ka një lidhje të natyrshme me pjesën tjetër të tokave shqiptare, pranë Dibrës së Madhe në krahun maqedonas dhe të njëjtës krahinë në krahun shqiptar... Ndërkohë që dikur kjo zonë ka pasur edhe një pikë kufitare që e lidhte me Kosovën në zonën e Prizrenit. Sot jo pa qëllim ajo nuk funksionon, duke mbajtur edhe më të izoluar banorët e Rekës.

Banorët e Verbenit janë mikpritës edhe pse mes fjalëve të tyre mund të kuptosh presionin e ushtruar mbi këtë komunitet e që vazhdon ende edhe sot. Në shtëpi, në sofra, mes tyre flasin shqip, jashtmi jo. Me ne ndihen disi më të qetë, kjo për shkak se jetojmë jashtë Maqedonisë e për ta nuk përbëjmë asnjë rrezik. Sigurisht për intervistë të hapur nuk bëhet fjalë.

- Nuk kemi mësuar ne në shkollë shqip, maqedonçe.

- Juve flisni më mirë se neve shqip.

- Po, ne shqip flasim . Unë me burrin jemi te shpia, fëmija s'fol kush në fakultet, shqip kuvendojmë te shtëpia, edhe me këta kam motrën , edhe ata shqip kuvendojnë, të gjithë shqip kuvendojmë. A gjëkundi kur dalim jashtë kuvendojmë maqedonçe . Mos na dijnë se shqip kuvendojmë.

- Po pse mos ju dijnë? Nuk duan?

- Po, ashtu maqedonçe .

- Po tamam tani çfarë jeni, shqiptarë apo maqedonë?

- Maqedonë jemi, po me gjuhë shqipe.

Sa më shumë shqiptarë ortodoksë të takosh, aq më shumë teori për gjuhën shqipe do mund të dëgjosh. Disa thonë se e flasin pasi e kanë mësuar nga komshinjtë, disa nga nuse të ardhura, disa se e kanë mbartur nga të parët, apo ka edhe të tjerë që thonë se ishin osmanët që i vunë para një zgjedhje të prerë... të ruanin besimin e tyre ortodoks, por të mësonin gjuhën shqipe. Një koklavitje absurde e ndërtuar ndër vite si një skemë për të humbur apo më mirë për të fshirë identitetin e tyre. Logjika e përdorur nga sllavët ishte e njëjtë në Ballkan nuk ka shqiptarë ortodoksë, por vetëm myslimanë ose turq… ndaj edhe sot banorët e Rekës së Epërme të indoktrinuar me këtë politikë e kanë të vështirë të mendojnë një shqiptar të krishterë në këto zona… edhe pse shqiptarët të krishterë janë ata vetë.

Ndarja fetare ka qenë ajo që ka ndikuar më shumë. Makineria e propagandës ka dhënë rezultatet e saj. Shumica e banorëve të flasin në gjuhën shqip, ka të tjerë që dukshëm të kuptojnë, por nuk duan të përgjigjen. E pavarësisht kësaj, shqipja pasohet natyrshëm brez pas brezi, edhe pse shkolla nuk ka pasur kurrë apo banorët detyroheshin dhunshëm të mos flisnin as rrugicave të fshatit gjuhën e tyre. Që pas viteve '50 dhuna jugosllave godiste në mënyrë të menjëhershme ata banorë që raportoheshin të flisnin shqip rrugicave të fshatit. Ndaj gjithçka bëhej në mënyrë të fshehtë mes njëri-tjetrit apo shtëpive larg njerëzve që mund të tregonin.

- Po nipi nga e ka mësuar shqipen?

- Shqipen na, prej nesh. Edhe me djalin e jem kuvendoji shqip nuk kthen.

- Po, di të kuptojë?

- Po, di perfekt.

- Juve nga e keni mësuar?

- Neve prej pleqve.

- Në shtëpi keni pas fol shqip? Shqip kuvendonim.

- Nëna nga e kishte mësuar shqipen?

- Nëna e ka mësuar prej nonës së vetë.

Të gjithë flasin shqip, por po të gjithë thonë se janë maqedonas, për më tepër edhe pasardhësit e një rilindasi të madh si Josif Bageri.

Josif Bageri ishte poet, gazetar e publicist, i cili që prej vitit 1868 kur lindi e u gatua në këtë zonë e deri në 1915, ka punuar për çështjen kombëtare shqiptare. Pas largimit të tij nga zona e Rekës së Epërme, ai e përqendroi aktivitetin në Sofje të Bullgarisë, duke u kthyer në një ndër figurat qendrore të shoqërisë shqiptare. Takimi me Naim Frashërin ishte ndoshta një ndër gurët më të fortë të themelit të tij intelektual. Ai punoi fort për të përhapur shkollat shqipe, duke çelur një të tillë edhe në fshatin e tij Nistrovë, pjesë e Rekës së Epërme. Në 1902 u takua me Bajram Currin në Sofje, priti Çerçiz Topullin, Mihal Gramenon e Zeman Mashkullorën, ndërsa në Bukuresht takoi Asdrenin. Për një kohë të gjatë në 1910 ai botoi gazetën "Shqipja e Shqipërisë". Bashkëpunoi me dibranët Said Najdeni e Jashar Erebara me Nikolla Ivanajn, Luigj Gurakuqin e Shahin Kolonjën. Pas Shpalljes së Pavarësisë në 1912 Josifi u kthye në Shqipëri, ku qeveria e kohës e emëroi në krye të një gazete të rëndësishme, siç ishte "Ushtima e Krujës". Pas një pune intensive për çështjen kombëtare, në 1915, Bageri i rraskapitur e i

sëmurë vdes  pas një udhëtimi të gjatë. Një jetë e shkuar rrugëve, në emër të shqipes e shqiptarëve, të betejave të forta për të ruajtur në Rekën e tij identitetin kombëtar...

Sot në Verben jeton ende një ndër pasuesit e tij. Pas pyetjesh të shumta e një orientimi jo pak të vështirë mes shtëpive e banorëve, takohemi me stërnipin, edhe ky i punësuar në një central aty pranë. Biseda është zhgënjyese, ndoshta sepse nga stërgjyshi i djeshëm që punoi për çështjen kombëtare shqiptare, sot pasuesi i tij ka harruar gjithçka, e jo thjesht në planin e aktivitetit të Josifit, por edhe të identitetit të tij kombëtar.

- Juve çfarë e keni pas? Çfarë e keni, çfarë bini tamam?

- Si i thoni ju.. .ded, stërgjysh.

- Stërgjysh? Dmth jeni stërnip i Josif Bagerit? Nip apo sternip?

- Stërnip.

-  Sa femijë jeni? Nipër, mbesa, stërnipër?

- Sa të duash, 5 vëllezër kanë qenë, Bageri dhe katër të tjerë, pesë, edhe një motër kanë pas. Po Josifi ka qenë nga ... Nistrova, nga Nistrova .

- Kush ju tha të vini këtu?

- Po, pyetëm në fshat, kudo, do vemi edhe në Nistrovë .

-  Po Josifi ka qenë shqiptar apo maqedon?

- Jo maqedon.

- Dmth gjuhën krejt e folim shqipen edhe gjuhën e nonës e kemi, ama ai maqedon ka qenë.

- Edhe Josif Bageri sipas jush ka qenë maqedon?

- Poooo.

Stërnipi refuzon të flasë në një intervistë edhe kur i themi se reportazhi ynë bazohet pikërisht në figurën e stërgjyshit të tij.

Ne vazhdojmë më tej, asgjë nuk ndryshon nga shtëpia në shtëpi, nga banori në banor, gjithçka është thuajse e njëjtë...

- Sa banorë ka fshati ?

- Këtu jemi 35 familje, tani dimrit. Pa verës mbushen nja 50.

- Po një gjë më bën kurioz?

- Kush?

- Një gjë më bën kurioz pse flisni të gjithë shqip?

- Ju jeni maqedonë apo shqiptarë?

- Maqedonë jemi. Ortodoksë.

- Po pse flisni të gjithë shqip?

- Po pse folim?

- Po ti pse flet maqedonisht?

- Unë s'di maqedonisht .

- Aaaa s'di ?

- Po, s'di, se unë vij nga Shqipëria.

- Të të pyes, këtu folin të gjithë shqip?

- Po, dijnë krejt, krejt e folin.

- Ju vetë nga e keni mësuar shqipen?  Të moshumit kan pas fol shqip?

- Po se di dhe unë me të rrejt, ashtu na kanë lënë e ashtu shkon.

- Ju fëmijëve u keni mësuar shqip??

- Jo jo jo, vetëm maqedonisht.

- Po ju vetë nga e keni mësuar shqipen?? Nga komshia?Po nona, baba??

- Po edhe nona, baba, prej komshisë.

Nga Verbeni në Nistrovë të pret sërisht një rrugëtim i lodhshëm mes maleve.

Fshati ku ka lindur Bageri është kthyer prej kohësh në një zonë të harruar . I ndarë nga pjesa tjetër e qytetërimit ai duket thuajse i kthyer në një ishull mes majave. S'ka ambulancë, arsimi i drobitur e vështirësitë ekonomike, peshojnë pa fund mbi banorët myslimanë të mbetur, sepse ortodoksët janë larguar kohë më parë.

Banorët tregojnë diku mes shtëpive, u vjen natyrshëm të të adresojnë për atje.

Kjo shtëpi sot e rrënuar i përket padyshim përfaqësuesit më të denjë dhe më të njohur të shqiptarëve ortodoksë të Rekës së Epërme. Rilindasit, patriotit Josif Bageri, i cili jetën e tij ia kushtoi çështjes kombëtare . Sot në fshatin Nistrovë , në fshatin e tij, nuk mund të gjesh qoftë edhe një familje ortodokse shqiptare të mbetur.

Në fshat sigurisht nuk gjen asgjë që të të përkujtojë rilindasin Bageri. Ajo që është më e dhimbshme është ndarja që duket qartazi tek banorët e mbetur. Shumë prej tyre duken më shumë se të paqartë. Përçarja ka hedhur rrënjë jo thjesht tek shqiptarët ortodoksë të kësaj zone, por edhe tek ata myslimanë. Myslimanët i quajnë ortodoksit maqedonë, ndërsa ortodoksit myslimanet, shqiptarë.



Nistrovë:

- Si ka mundësi që këta pasardhësit e vetë thonë që është maqedon ? Që ka qenë maqedon.

- Po ti mund të thuash gjithçka të duash tani, gjithçka të duash, ama nuk ka qenë ndonjë njeri, ndonjë pasunik.

- Jo, ça ka qenë, dmth shqiptar apo maqedon?

- Ortodoks, edhe përmbas emrit është maqedon ai. Josif, nuk mund Josif të jetë shqiptar.

-  Po si ka mundësi maqedon dhe punonte për Shqipërinë?

- Nuk ka dit dhe ai aq shumë se çfarë të bënte, ajo ka qenë krejt.

- Pse , më fal të të bëj një pyetje, ortodoksit janë maqedonë?

- Po ata tash maqedon trajtohen, si janë ortodoksit janë maqedonë? Po tash maqedonë trajtohen ata . Po se ortodoksë ka edhe në Shqipëri.

- Po ka mo, po në Shqipëri thonë jemi shqiptarë.

Pas  çapitjesh të gjata ndër fshat, kemi fatin të takojmë një banor ortodoks të kthyer nga Shkupi për të qëndruar dy apo tre ditë në shtëpinë ku është rritur.

- Ju, sa keni që keni ikur?

- Sa vjet kam?

- Po, sa vjet keni që keni ikur?

- Ka 50 vjet. Tamam 50.

- Këtu keni lindur ama...

- Po, këtu.

- Po tani, për një gjë jam kurioz unë, shqipen si e flisni të gjithë? Se ju jeni maqedon apo jo?

- Po, para të gjithë kuvendonim shqip. Nuk kishte problem për atë.

- Po pse kuvendonit shqip?

- Kemi mësu.

- Shkollën çfarë gjuhe e keni bërë?

- Maqedonisht.

- Në shtëpi flisnit shqip?

- Po, shqip.

Ka studiues që pretendojnë se në Maqedoni jetojnë më se 70 mijë apo edhe më shumë shqiptarë të fesë ortodokse. Ka shumë nga ata që s'dijnë të artikulojnë më asnjë fjalë edhe pse vijnë nga Reka. Në familje të tilla presioni ka qenë edhe më i forte, çka e ka bërë të pamundur ruajtjen e saj. Megjithatë, nëse shqiptarët ortodoksë do të zgjoheshin, ekspertët thonë se numri i popullsisë maqedone do të binte deri në 3 apo 4 për qind, me të cilin do të rritej ai shqiptar. Ka të dhëna se nga Reka e Epërme vjen edhe familja e Millosh Gjergj Nikollës, Migjenit, e kjo shpjegon edhe emrin e tij prej të cilit është akuzuar shpesh nga grupe të caktuara se është sllav. Është krejtësisht e pamundur të gjesh që prej kohës kur nisi sulmi për të sllavizuar këtë zonë e deri më sot një banor që të ketë emër e mbiemër të pandikuar. Por kjo kurrsesi nuk i bën që të mos jenë në rrënjë shqiptarë.

Në rrugëtimin përmes Rekës së Epërme, ndalesën e radhës e kemi në Mavrovë, që pak e dinë se është banuar e banohet ende edhe sot nga shqiptarë të besimit ortodoks. Ata fshihen e nuk duan të tregojnë identitetin e tyre. Mavrova është më e ekspozuar ndaj  dhe nuk është e lehtë të jemi të drejtpërdrejtë. Mjafton një kredhje bizneseve të zonës për të kuptuar e për të prekur të vërtetat e tyre, sigurisht, duke pasur këtë herë kujdes më të madh.

- Doni qese?

- Po vallaj, nje qese. Ju jeni nga këtej?

- Po.

- Ju nga jeni?

- Shqipëria.

- Na habitët si ka mundësi që flasin të gjithë shqip këtu?

- Po, dine, kanë mësuar.

- Keni mësuar?!

- Faleminderit.

Edhe pyetjet duhet të jenë të kujdesshme, ose më mirë duhet të duken sa më natyrale, për të mos lënë asnjë hije dyshimi.

- Ju jeni maqedon?

- Po. Ka edhe në Greqi që flasin shqip. Gjithkund ka. gjithkund.

- Megjithatë ju jeni maqedon, apo jo?

- Po.

- Po shqipen e keni mësu në shtëpi apo si?

- Po, në shtëpi. Në shkollë maqedonisht kemi mësu.

- Po pse gjuhë nëne keni shqipen dhe jeni maqedon?

- Po.

Parku kombëtar i Mavrovës, i shpallur i tillë në vitin 1949, shtrihet në një hapësirë të gjere, ku natyra e paprekur ofron bukuri të rralla me florë dhe faunë mjaft të pasur, siç në të gjithë Rekën e Epërme. Kompanitë turistike shqiptare e maqedonase e kanë kthyer në një ndër stacionet më të frekuentuara turistike. Shpesh janë organizuar edhe ture me gazetarë shqiptarë për ta promovuar, por gjithmonë duke fshehur rrënjët e saj, të shkuarën dhe të sotmen e dhimbshme. Shqiptarë në rrënjë me gjuhë shqipe dhe jo shqiptarë sot, edhe pse gjuha është po aty.

- Si jeni? Mirë jeni?

-  Kudo shqip. Shqip unë kuvendoj.

- Po nga jeni?

- Prej këtu jemi.

- Po, si flisni shqip?

- Epo flasim, dimë ne.

Një ndër krenaritë e mëdha jo thjesht të kësaj zone, por edhe të të gjithë Maqedonisë konsiderohet kilometra më tej brenda territorit të Rekës edhe një manastir i rrallë i ndërtuar sipas të dhënave zyrtare diku në vitin 1020.

Ky është manastiri i Bigorskit, siç e identifikojnë dhe siç e kanë pagëzuar maqedonasit, edhe pse në gjuhën e tyre kjo fjalë Bigorski nuk do të thotë asgjë. Ndërkohë emri jo zyrtar me të cilin e njohin dhe e identifikojnë shqiptarët është manastiri mbi gur. Nuk është e vështirë në fakt të ndash dhe të identifikosh këto dy emërtime. Bigorski që nuk do të thotë asgjë në gjuhën maqedone dhe mbi gur, me të cilin e njohin shqiptarët. Mjafton një pamje e thjeshtë nga larg për të identifikuar vërtetësinë e tyre dhe për të parë gjenezën e këtij manastiri.

Manastiri është i vendosur mbi gur, siç edhe përcakton emri shqip i tij e kjo mund të duket lehtësisht në të gjitha anët. Nëse dikush kërkon fakte edhe më të forta, mjafton të shikosh këtë fotografi të vjetër që i përket kohës së para 1912, kur komuniteti i shqiptarëve ortodoksë të Rekës frekuentonin në masë këtë vend. Ishin kohët kur besimtarët i drejtonin memorandume e kërkesa kishave më të mëdha ndër të cilat edhe asaj greke, duke përcaktuar se nuk do të pranonin asnjë prift apo misionar të komanduar që nuk do të dinte të meshonte në gjuhën shqipe. Por këtë gur të fortë të identitetit kombëtar të ortodoksëve shqiptarë nuk e goditën thjesht duke i ndryshuar emrin, por sulmi ndaj tij ishte edhe më i fortë. Në vitin 2009 manastiri u shkatërrua thuajse tërësisht nga një zjarr i papritur e sipas autoriteteve i shkaktuar nga një shkëndije elektrike. Por, në fakt, sipas shumë studiuesve  të kohës, zjarri ishte një mënyrë për të zhdukur përfundimisht çdo provë dhe çdo material që gjendej në bibliotekën e manastirit e që e lidhte atë pashmangshmërisht me shqiptarët e Rekës.

Pas mbetet manastiri mbi gur. Sot ndoshta vetëm guri mund të flasë për hapat që e preknin dikur, për zërat që luteshin e këndonin liturgjitë, për banorët që iknin e vinin, për lutjet e pëshpërimat e tyre.

Deri më sot për këtë komunitet nuk është bërë kurrë asgjë serioze, përveç një shoqate që mban emrin e Josif Bagerit e që po përpiqet të zgjojë e të shpëtojë atë që mund të shpëtohet ende. Politika shqiptare në Maqedoni ka zgjedhur të heshtë, të mos pipëtijë, të mos flasë e artikulojë asgjë. Një hapësirë gjigante sot hesht nga braktisja, por uluret më shumë se gjithçka nga faktet që ende nuk janë shuar. Reka ka në çdo kthinë histori, ka shtëpi boshe që tregojnë, ka gurë që flasin, ka dyer që shikojnë e rrugica të vetmuara ku duken ende fantazmat e djeshme e realitetet e sotme. Vargjet e Josif Bagerit janë ende aty, oshëtuese ...

Msoni gjuhën ju që kini
se një koh e mir mbrrini
Me msim t'mirat i bini
peranden n'errësi mos rrini.

Këto janë të vërtetat e Rekës, të vërtetat e shtëpive të ftohta e të braktisura, të lagjeve të shurdhëta e pragjeve të vetmuara, të banorëve që sot më shumë se kurrë duhen ndihmuar të zgjohen, të përballen me realitetin e vërtetë të tyre e mbi të gjitha të jenë ata që kanë qenë gjithmonë, shqiptarë e asgjë tjetër.




# 20 vite të Odës Dibrane

*Nga* **VELI VRANIÇI**

Kur e filluam këtë aktivitet "Odën Dibrane", rrallë ndonjë optimisti të "çmendur" do t'i shkonte në mendje se do të kishte këtë jetëgjatësi.

Nga kjo veprimtari kulturore, ne besojmë, ka përfituar vetë kultura kombëtare që rifreskon një nga nëndegët e saj më të veçanta dhe të bukura, këngën dhe vallen humoristike, ritin dhe alegorinë.

A i ka realizuar Oda Dibrane pritshmëritë tona në këto 20 vite?! Ne besojmë se po.

Që në fillim ne kishim disa objektiva dhe qëllime. Po rendis disa prej pikësynimeve tona që mendojmë se janë realizuar në këto vite:

Festivali mbarëkombëtar "ODA DIBRANE" si qëllim të parë kishte të bashkonte artistët shqiptarë, pavarësisht nga kufijtë në një "odë", me idenë se "ODA DIBRANE" do të jetë mikpritëse e "ODËS SHQIPTARE".

Të ishte një takim specifik,origjinal në llojin e vet jo vetëm në Shqipëri, por dhe më gjerë. Të ishte takim i këngës dhe valles popullore humoristike, ritit, lojërave popullore dhe alegorisë. Qëllimi i tij ishte t'i rizgjojë këto vlera të papërsëritshme të kulturës tonë, t'i sjellë në kohë dhe t'i bëjë të asimilueshme për shikuesit.

Në këtë festival të paraqiteshin rite të lashta si dhe vegla karakteristike muzikore. Ky festival krijon mundësinë për një rizbulim të tyre.

Ky festival të ishte festival i traditës dhe, duke qenë i përvitshëm, t'u japë mundësi grupeve dhe trevave të ndryshme të kërkojnë, zbulojnë dhe paraqesin vlerat karakteristike të tyre në këtë fushë.

Të gjallërojë jetën kulturore dhe artistike në qytetin e Peshkopisë, si një qytet me infrastrukturë dhe jetë të gjallë kulturore të spikatur.

Në këtë kuptim përfitues do të ishin vetë qytetarët dibranë që u krijohet mundësia të shijojnë këtë pasuri të pafund të kulturës kombëtare.

Përfitues do të ishin grupet dhe shoqëritë kulturore artistike të shqiptarëve matanë kufijve, që në kuadër të pjesëmarrjes në këtë festival mbajnë gjallë dhe ruajnë traditat e folkut popullor të zonës.

Përfitimi më i madhe do të ishte shkëmbimi i vlerave kulturore, zakoneve, traditave dhe krahasimi i tyre nga studiuesit dhe vetë artistët popullorë, që në një farë mënyre ritregojnë lashtësinë e popujve të tyre.

Arti miqëson njerëzit e vëllazëron zemrat. Si rrjedhoje, ky komunikim me këngë e valle do të ishte përfitimi më i madh në marrëdhëniet mes njeri-tjetrit.

Biznesmenët dibranë do të përfitonin direkt ekonomikisht nga ky festival.

Ndaj besojmë se janë realizuar pritshmëritë tona.

Dhe për këtë ndjehemi krenarë!

Arti ka një veçori. Asgjë nuk realizohet vetëm. Bazë ka punën kolektive. Çdo krijim apo aktivitet kërkon mundin e djersen e shumë artistëve, specialistëve e bashkëpunëtorëve. Edhe festivali Oda Dibrane kërkon angazhimin e shumë njerëzve. Për hir të së vërtetës ky aktivitet ka patur magjinë të mbledhë ajkën e artistëve e specialistëve dibranë, shqiptarë, të shqiptarëve të Maqedonisë e Kosovës, e më gjere.

Oda Dibrane ishte një aktivitet i nisur si bashkëpunim mes Peshkopisë, si qendër e rëndësishme administrative e kulturore dhe Shoqërive Kulturore artistike të shqiptarëve në Maqedoni. Kjo veprimtari artistike me përmasa mbarëkombëtare zhvillohet në qytetin e Peshkopisë edhe për arsye simbolike. Duke qenë nje qytet afër kufijve politikë përfaqëson një trevë lidhëse të kulturës shpirtërore të krahinave të ndryshme, u krijon mundësinë grupeve të mbajnë gjallë këngën dhe vallen shqipe që të mos e harrojnë atë.

Që në fillimet e veta të para, ky bashkëpunim ishte shumë i rëndësishëm për të dy palët. Së pari në Peshkopi krijohej mundësia për organizimin e një evenimenti të madh kulturor, duke tentuar ta kthente qytetin në një pikë referimi për grupet artistike të shqiptarëve matanë kufijve me mundësi të pakta për një jetë aktive.

20 vite "Odë Dibrane" nuk janë shumë. Megjithëse kur fëmija arrin në këtë moshë prindërit nuk u besojnë syve, por gjithashtu fillojnë e mendojnë për detyrime të tjera. Kështu, në 20 vjetorin e këtij aktiviteti unik, të papërsëritshëm, na kalojnë para syve breza të tërë të artistëve e punonjësve të kulturës si brenda ashtu dhe jashtë kufijve dhe është detyrimi më i pakët i imi të përmend me respekt e mirënjohje disa prej bashkëpunëtorëve që na qëndruan pranë, na ndihmuan e jetuan me preokupimin tonë, ata të cilët "nuk i zinte gjumi" për Odën e Dibrës.

Nuk mund të harrohet përkushtimi i të ndjerit Alush Hamidi, kryetar i shoqërive kulturore artistike të shqiptarëve në Maqedoni, i cili me qetësinë e tij, fjalën e urtë e të mençur, dijet dhe aftësitë organizative, u bë krahu më i fortë i "Odës Dibrane" në Maqedoni. Haki Fazlliun e papërtuar dhe mjeshtër në komunikim, i cili jo pak herë u bë dhe mbështetës financiar i festës sonë. Po kështu, i ndjeri Nexhbedin Zeqiri.

Do të përmend Adi Kasamin gjithmonë energjik, të gjithë anëtarët e kryesisë së Shoqërive Kulturore Artistike të shqiptarëve në Maqedoni, Zylfi Aliun e Remzi Aliun nga Tetova që na mbajtën në shtëpitë e tyre. Nuk mund të mos përmend të gjithë kryetarët e shoqërive kulturore artistike të qyteteve e fshatrave shqiptarë në Maqedoni, ata që me ansamblet e tyre e "dogjën" Peshkopinë.

Më duhet padyshim të përmend bashkëpunëtorët, dashamirësit e Dibrës së Madhe, gazetarët Lutfi Turkeshi e Nefail Spahiu, apo të nderoj emra të tillë si Violeta Turkeshi, Jakup Markja, Mislim Strikçani, Zenulla Maqellara, vëllezërit Lala, Burhan Skikuli, Nazif Tominajn, drejtuesit e Pallatit për kulturë në Dibër të Madhe, e shumë e shumë të tjerë.

Dhe në Peshkopi, për këtë aktivitet kanë punuar breza të tërë artistësh. I madhi Hazis Ndreu, njeriu i "odave" në Dibër, njeriu që e kërkoi, zbuloi, gdhendi fjalën e bukur të Dibrës. Hazizi i pavdekshëm me këngët e tij, me alegorinë e tij, me krijimtarinë e tij, do të mbetet zemra e këtij aktiviteti.

Mirënjohje krejt e veçante për mikun e bashkëpunëtorin tim më të ngushtë, Përparim Tomçini, që me krijimtarinë e tij, përkushtimin e tij, profesionalizmin e tij ishte garancia e suksesit të festivalit. Artistët si Lefko Popa, Avni Ndreu, Llesh Nikolla, Xhevat Fana, Faik Vojka, Hysni Loka, Flamur Sala, Agim Skara etj., që me përkushtim i dhanë gjak kësaj veprimtarie. Për të vazhduar me emrat simbol të kulturës dibrane si Liri Rasha, Arif Vladi, Qerim Sula - mjeshtër i madh, Vera Laçi, Saje Poleshi, Rozeta Paçuku, Sherif Dervishi etj. Në këtë odë këndoi dyshja e Kalasë së Dodës, Fatmir Daku e Myfterim Kupa, këndoi Melita Shehu, Abdyl Sturçe, Lirim Hoxha, Dritan Jashari, Fatmir Loca, Eduard Hoxha etj.

Në këtë odë u kënduan këngët e Munir Shehut, Tonin Rrotes, Muharem Xhedikut, Përparim Tomçinit, Imer Seferit, Edmond Zhulalit, por dhe të dibranëve matanë kufijve si të Musa Piperkut, familjes Sturçe. Në këtë odë kënduan dhe këngëtarët e Dibrës së Madhe si Haxhi Maqellara, Sajmir Shehu, Xiu etj.

A harrohen Ymer Seferi, Shaban Xhajku, Naim Plaku, që i falën të gjithë dashurinë, të gjithë jetën e tyre, aktiviteteve artistike e kulturore në Peshkopi e në veçanti Odës Dibrane. Po kështu, grupin e valleve me mjeshtrat e kërcimit si Refat Imeri, Rifat Rroka, mbretërit e valles shqiptare Shaban Xhajku e Besmir Aga, i ndjeri Isuf Tusha, mjeshtri i kavallit, Xhafer Shini, Manjola Xhidra etj., etj., si dhe Arben Zeqja, fonist, që ka dhënë kontributin e tij të çmuar dhe është kthyer në një arkiv të gjallë, ndriçimi ndër vite, që nga Ilir Jakupi, Agim Nezha, Adnan Elezi, prapavija me Sajmir Xhajkun, Petrit Xhaferin, Arben Kacanin e shumë e shumë të tjerë.

Një mirënjohje e veçantë edhe për ekonomistët e Institucionit, që me korrektesë e ndërgjegje të pashembullt, përballuan ndër vite të gjithë organizimin financiar të festivalit, si Muharem Hoxha, Shadie Vraniçi (Sala), që njëkohësisht ka qenë dhe moderatorja e parë e Odës Dibrane së bashku me Llesh Nikollën, Ramazan Tota, Teuta Shehu e deri te Edison Daka.

Nuk mund të mos përmend njerëzit që ndër vite pasuruan arkivin tonë me filmime e fotografi, pa punën e të cilëve ai do të ishte i mangët si i ndjeri Sami Selishta, Arben Noka, Adnan Elezi, Neki Feta etj. →

## Oda dibrane sjell në Peshkopi pranverën në fundvjeshtë

*Nga* **SASHENKA NDREKA**

Sipari i Odës Dibrane u ngrit sivjet për të njëzetin vit radhazi. Kjo ditëlindje e veçantë, ky vit maturimi, solli në Dibër një festë të jashtëzakonshme, katër ditë e katër net rresht, duke sfiduar dhe të ftohtin e acartë të atyre ditëve tetori. Që nga viti 1994 merr jetë në skenën e Peshkopisë, Festivali i Odës dibrane, për të rezultuar i suksesshëm, e për të ruajtur traditën edhe sot e kësaj dite.

Çdo tetor në odën dibrane, vijnë e buajnë grupet folklorike anë e mbanë Shqipërisë, madje dhe nga diaspora, duke sjellë me vete copëza folklorike të krahinave përkatëse, me një stil krejt të veçantë të valles humoristike, këngës, ritit dhe alegorisë.

Festivali ka për qëllim të bashkojë artistët shqiptarë kudo që ndodhen, pavarësisht kufijve, me idenë që "Oda Dibrane" do të jetë mikpritëse e "Odës Shqiptare", me një origjinalitet që synon të rizgjojë vlerat e papërsëritshme të kulturës dibrane. Ky festival, i kthyer tashmë ne traditë, veç të gjithash, rrit në Dibër turizmin kulturor, të mbuluar prej vitesh nga pluhuri i harresës.

Oda dibrane simbolizon dhomën e pritjes dhe përcjelljes së mikut, është simbol i mbajtjes së besës dhe bujarisë, trimërisë dhe qëndrueshmërisë, aty ku bëheshin kuvende, shkruheshin kanune, ndaheshin gëzime e hidhërime, aty ku këndonte dasma e qante morti. Aty ku mençuria ishte ulur këmbëkryq, ku ironia nxirrte në pah mençurinë e pamatë dibrane. Jo më kot ka mbetur një fjalë e urtë dibrane, së cilës i tremben të gjithë ato që s'e njohin Dibrën: "Kur të shkosh në odën dibrane, merr më vete një metër, një kandar dhe një kunj". Natyrë e tillë i është dhënë pak a shumë dhe festivali, ndaj konkurrentët vijnë të përgatitur mirë. Festivali i sivjetshëm zgjati katër net, ku njëra nga këto u mbajt në Dibër të Madhe, risi tjetër që solli ky sezon. Është e para herë që Oda zhvendoset në Dibrën tjetër.

Nata e ndarjes së çmimeve u zhvillua në Peshkopi.

Me çmimin e karrierës u nderuan valltarët Zija Aliu nga ansambli "Kemal Azizi", Viti, dhe Rifat Ymeri nga Qendra Kulturore Peshkopi. Gjithashtu, po me këtë çmim u nderua edhe Koço Vasili nga Ansambli Folklorik "Lunxheria" dhe Rizvan Sinani, mjeshtër i kavallit, nga Shoqëria Kulturore Artistike "Jehona e Malësisë së Sharrit".

Me çmime u nderuan edhe këngëtarjet Merita Salihi dhe Sara Frisku, instrumentistët Naser Miftari, Gent Hoxha, ansambli "Katerina Josipi", "Lunxheria", "Çipini", grupet e valleve të Ansamblit "Muharem e Xhevat Qena", SHKA "Agim Ramadani", Ansambli Folklorik "Fiershegan", grupit i valleve "Ibe Palikuqi", Grupi i valleve të Shoqërisë Kulturore "Skampa", grupi i burrave të SHKA "Jehona e malësisë së Sharrit", solistët e grupit artistik të Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci", formacionit instrumental me curle e lodër të Ansamblit "Lidhja e Prizrenit", etj.

Të gjitha çmimet u shoqëruan me mirënjohje nga Kryetari i Bashkisë Peshkopi z. Ilir Krosi dhe Drejtori i festivalit "Oda Dibrane" z. Veli Vraniçi, flamurin me logon e festivalit, me medalionin e festivalit si dhe diplomën e akorduar nga Juria e festivalit.

Pa çmim nuk mund të mbetej edhe Qendra Kulturore Peshkopi, e cila u nderua nga Presidenti i Republikës Bujar Nishani me titullin "Mjeshtër i Madh", me motivacionin "Për organizimin cilësor prej 20 vitesh të Festivalit Mbarëkombëtar "Oda Dibrane", e cila ka dhënë një kontribut të shquar në fushën e mbrojtjes, promovimit dhe popullarizimit të vlerave të trashëgimisë kulturore mbarëkombëtare".

Gjithashtu, edhe drejtori i Odës Dibrane, z. Veli Vraniçi u nderua nga Presidenti i Republikës me titullin "Mjeshtër i Madh", "Për kontribut të rëndësishëm si artist dhe organizator i Festivalit mbarëkombëtar "Oda Dibrane", që me përkushtim dhe profesionalizëm në këto 20 vjet të këtij aktiviteti ka kontribuar në ruajtjen e promovimin e kulturës dibrane, duke i dhënë emër dhe vlera kulturore kombëtare".

# oda dibrane

**Në këtë 20 vjetor ne kurorëzuam objektivin tonë të hershëm, që "odën e Dibrës" ta bëjmë edhe në Dibër të Madhe, ngjarje kjo kulmore dhe e shumëpritur, që tenton "shkrirjen" reale të pengesave dhe kufijve të vendosur në rrethanat e padrejtësive historike të shekullit të kaluar.**

Odës Dibrane asnjëherë nuk i kanë munguar miqtë. Ndaj emri i saj i ka rezistuar kohës. Atë gjithmonë e kanë nderuar miq të shquar, personalitete të kohës.

Vetë ardhja e shumë e drejtuesve të lartë të shtetit që nga Presidenti, drejtues të partive politike, deputetë e ministra të të gjithë Qeverive në vite në festivalin tonë, është jo vetëm një vlerësim për këtë festival, por, besojmë, për vetë kulturën tonë kombëtare, që në këtë rast kishte si emërues "Odën Dibrane". Ndaj krenohemi se "Oda Dibrane" ka kaq shumë miq. Ndjej detyrimin për të shprehur të gjithë mirënjohjen, pasi prania e tyre gjithmonë i ka dhënë nder e shkëlqim festivalit tonë.

Të nderohesh nga "Oda Dibrane" padyshim është vlerësim i madh. E kanë mirëpritur titullin e madh "Nderi i Odës Dibrane" personalitete të politikës e artit si ish presidenti Bamir Topi, mjeshtri i këngës, miku i Dibrës, drenicari Ilir Shaqiri, këngëtari simbol i Dibrës Arif Vladi dhe këngëtarja e pavdekshme dibrane Liri Rasha. Këto emra i kanë bërë nder vetë "Odes Dibrane".

Një falënderim krejt i sinqertë shkon për drejtuesit e grupeve e shoqatave matanë dhe këtë anë të kufirit. Pa përkushtimin, mundin, djersën e tyre, do të ishte e pamundur realizimi i këtij evenimenti të madh kulturor.

Sinqerisht falënderoj, në emër të të gjithë grupit realizues Ministrinë e Kulturës në vite për mbështetjen që i kanë dhënë e vazhdojnë t'i japin këtij festivali.

Oda dibrane gjithmonë e ka një zot shtëpie. Për hir të së vërtetës, pa përjashtim të gjithë drejtuesit e pushtetit vendor të Peshkopisë, Kadri Rrapi, Mentor Bunguri, Bajram Krrashi e sidomos Ilir Krosi meritojnë mirënjohjen tonë për mbështetjen pa rezerva për realizimin e këtij festivali. Gjithmonë tek ta, unë dhe stafi im kemi gjetur mirëkuptim. Ata gjithmonë kanë qenë pjesë e stafit organizativ të Odës.

Kanë kaluar 20 vjet. Pak e dinë se sa mund është dashur për të siguruar fondet e domosdoshme. Vetëm me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës ka qenë e pamundur të realizohej festivali. Por Dibrës asnjëherë nuk i kanë munguar miqtë e "dashamirët". Me dhjetëra mbështetës e biznesmenë kanë sponsorizuar festivalin tonë. Është një listë e gjatë, por që meriton të gjithë vëmendjen e mirënjohjen tonë si organizatorë, por jam i bindur se kanë dhe mirënjohjen e respektin e qytetarëve të Peshkopisë.

Janë 20 vite dhe nuk është mirë të harrohet asnjë nga ata që na ka ndenjur pranë e na janë bërë mbështetësit kryesorë. Nga zemra falënderoj së pari Astrit Ademin dhe hotelin e tij "Korabi" që u bë shtëpia e "Odës" që në fillimet e veta. Falënderoj mikun tim Musa Selami, që me aq zemërgjerësi hapi hotelin e tij dhe krijoi mundësi për të zgjeruar gjeografinë e festivalit. Po kështu falënderoj të gjitha hotelet e Peshkopisë që u bënë pjesë e mikpritjes së artistëve pjesëmarrës.

Në gjithë këto vite, bashkudhëtarët tanë kanë qenë mediat të shkruara e audiovizive, brenda e jashtë kufijve. Pa ndihmën e tyre ky festival nuk do të kishte këtë jehonë. Pa pasqyrimin e tyre korrekt, entuziast e profesional, këtij festivali do t'i mungonte aroma. Ndaj i falënderoj dhe i siguroj se kanë gjithë mirënjohjen tonë.

Falënderoj dhe të gjithë ata qytetarë e dashamirës që janë bërë reklamues të këtij festivali nëpër rrjete sociale. Është e do të vazhdojë të mbetet një kontribut shume i vlefshëm e i mirëpritur.

Festivali Folklorik "Oda Dibrane" është një nga veprimtaritë më të rëndësishme të trashëgimisë shpirtërore shqiptare, me një akses të madh edhe në publikun dibran e më gjerë.

Ndaj falënderimi më i madh u takon artdashësve dibranë, që asnjëherë nuk na u ndanë, nuk na braktisen. Edhe në momentet më të vështira, kur në ndonjë rast ne, të lodhur apo të mërzitur, çonim nëpër mend braktisjen e tij, ishit ju qytetarë të Peshkopisë, që na dhatë kurajo, na "detyruat" që me çdo kusht ta realizojmë. Ndaj e them me bindje se të parët jeni ju në ekipin realizues të kësaj ngjarje të madhe kulturore për Peshkopinë, Dibrën, mbarë vendin, mbarë kulturën kombëtare.

Tani pas 20 vitesh... kur flitet për Peshkopinë, menjëherë të shkon mendja tek "Oda Dibrane", kur përmend Dibrën, menjëherë i bashkëngjitet fjala "Odë"...

** Drejtor i festivalit "Oda Dibrane"*

# Oda, një ngjarje e madhe për kulturën tonë kombëtare

*Nga* **ILIR KROSI***

Oda dibrane në gjuhën popullore simbolizon dhomën e pritjes së mikut. Ajo është simbol i vatrës së besës e bujarisë, qëndresës e trimërisë shqiptare, ku bëheshin kuvende, ceremoni në raste gëzimesh e fatkeqësish, ku shpalosej mençuria dhe urtësia e këtij populli.

Oda ka shërbyer ndërkohë edhe si vendi ku thureshin e merrnin udhë këngët e bukura epike e lirike, ku festohej e gëzohej, ku kumbonte kënga apo niste gjëma, ku pritej e përcillej miku i shtëpisë, ku përdoreshin fjalë të urta dhe dialogu alegorik.

Në këtë "shkollë" u rritën breza të tërë burrash e grash, që veç trimërisë e zgjuarsisë, trashëguan në shekuj atë kulturë, atë pasuri të madhe të folklorit në tërë përmasat e tij, duke fituar kështu vlera të veçanta që po i gjallëron tashmë për çdo vit "Oda Dibrane".

Për 20 vite radhazi Dibra ka hapur Odën e miqve për të pritur Odën shqiptare, ka hapur dyert e zemrën për të pritur kaq artistë që me praninë e tyre e nderojnë Dibrën artdashëse.

Ju faleminderit artistë pjesëmarrës!

Dibra gjithmonë është përmendur për Odën, por tashmë, pas 20 vitesh të këtij festivali, kjo "Odë" është kthyer në simbol. Falë vlerave të këtij festivali, Peshkopia është bërë pikë referimi, e në kulturë, Oda Dibrane është kthyer në një model.

Unë kam pasur fatin që për më shumë se 10 vite të jem në krye të organizimit të këtij evenimenti. Gjithmonë e kam ndjerë veten të lumtur mes aq shumë e shumë artistësh që vinin e sillnin këngët e bukura të vendit e krahinës së tyre, ndiznin Peshkopinë me lodrat e vallet dhe që për aq net sa ishte "Oda Dibrane", ishin qytetarët më të nderuar të Peshkopisë.

Tashmë ata përgjithmonë do të mbeten qytetarë të Peshkopisë. Ne e kemi mbështetur dhe do të vazhdojmë ta mbështesim realizimin e kësaj ngjarje të madhe kulturore për Dibrën, se e dimë që ky aktivitet është dhe një ngjarje e madhe për kulturën tonë kombëtare.

Ky festival vazhdon t'i bëjë jehonë emrit të mirë të Dibrës tonë. Në këtë 20 vjetor, gjej rastin të falenderoj të gjithë mbështetësit, sponsorët, qytetarët, bizneset e kompanitë e mëdha, hotelet e qytetit, firmat e ndërtimit, mbi të gjithë qytetarët e Peshkopisë, që me dëshirë, u bënë pjesë e realizimit të këtij Festivali.

Por kënaqësia ime më e madhe, në këtë 20 vjetor, është se ne kurorëzuam objektivin tonë të hershëm, që "odën e Dibrës" ta bëjmë edhe në Dibër të Madhe, ngjarje kjo kulmore dhe e shumëpritur, që tenton "shkrirjen" reale të pengesave dhe kufijve të vendosur në rrethanat e padrejtësive historike të shekullit të kaluar. Ky bashkëpunim (për herë të parë një festival zhvillohet në dy shtete) kontribuon në aspiratat konkrete të dy vendeve tona për euro-integrimin.

Kam nderin dhe privilegjin që në emër të qytetarëve të Peshkopisë, në emrin tim personal, t'ju uroj për këtë 20 vjetor, me bindjen, se së bashku me qytetarët dibranë, së bashku me ju miq artistë, do të kemi shumë përvjetorë të tjerë po kaq të suksesshëm.

** Kryetar i Bashkisë PESHKOPI*




## GRUPET KONKURRUESE

- Qendra Kulturore, Peshkopi
- Ansambli "Katerina Josipi", Kosovë
- SHKA "Bajram Shabani", Kumanovë
- Rapsodët, Kukës
- Qendra kulturore, Burrel
- Qendra kulturore, Bulqizë
- Ansamblit folklorik Fiershegan, Lushnjë
- Ansambli folklorik "Agim Ramadani", Kosovë-Gjilan
- Ansambli "Lunxheria" , Gjirokastër
- SHKA "Karshiaka", Shkup
- SHKA "Ibe Palikuqi", Shkup
- Ansambli folklorik "Shote Galica" Drenas, Kosovë
- Grupi polifonik "Bashkimi i trevave", Fier
- Ansambli i këngëve e valleve "Lidhja e Prizrenit", Kosovë
- Qendra kulturore "Pjetër Gaci", Shkodër
- SHKA "Jehona e malësisë e Sharrit", Tetovë
- Grupi "Çipini", Vlorë
- Ansambli i shoqatës kulturore "Skampa", Elbasan
- Ansambli folklorik "Muharem e Xhevat Qena", Kosovë
- Ansambli "Kemajl Azizi", Viti, Kosovë

**Grupet përshëndetëse:**

- Ansambli shtetëror i këngëve dhe valleve, Tiranë
- Ansambli "Tirana", Tiranë
- Ansambli shtetëror i Kosovës "Shota", Prishtinë
- Ansambli "Xheladin Zeqiri", Tetovë

## ÇMIMET E "ODES DIBRANE"

1. Zija Aliu - valltar, Ansambli "Kemajl Azizi" Viti, Kosovë - çmimi i karrierës
2. Rifat Ymeri- valltar,Qendra Kulturore Peshkopi- çmimi i karrierës
3. Koço Vasisli- Ansambli folklorik "Lunxheria- Gjirokastër- çmimi i karrierës
4. Rizvan Sinani - mjeshtër i kavallit, SHKA "Jehona e Malësisë së Sharrit" Tetovë - çmimi i karrierës
5. "Valle tradicionale me def", Ansambli "Katerina Josipi", Prizren, Kosovë
6. Këngëtarja Merita Salihi për interpretimin e këngës "Një nuse presin tri kala", Ansambli "Kemajl Azizi", Viti, Kosove
7. Instrumentistit Naser Miftari për "lojën e bukur me kavall" i SHKA "Bajram Shabani".
8. Sara Frisku për interpretimin e këngës "Trëndafili i bardhe", Qendra Kulturore Burrel
9. Grupit të valleve të Ansamblit "Muharrem e Xhevat Qena", Romaje, Prizren, për interpretimin e valles me motive hasjane.
10. Grupit të valleve të SHKA "Agim Ramadani" Gjilan, për interpretimin e "Valles së topallit".
11. Grupit të valleve të Ansamblit Folklorik "Fiershegan" Lushnje, për interpretimin e "valles së ngjalave".
12. Grupit të valleve "Ibe Palikuqi" Shkup.
13. Instrumentistit Gent Hoxha,"për lojën virtuoze me çifteli" i Ansamblit "Shote Galica" Drenas, Kosovë.
14. Grupit të valleve të Shoqërisë Kulturore "Skampa" Elbasan, për interpretimin e "valle me motive të Dumrese".
15. Grupit polifonik të Ansamblit "Çipini",Vlorë
16. Grupit të burrave të SHKA "Jehona e malësisë së Sharrit" Tetove për interpretimin e këngës diafonike "Udhet e Shullanit".
17. Solistët e grupit artistik të Qendrës Kulturore "Pjeter Gaci" Shkodër.
18. Formacionit instrumental me curle e lodër të Ansamblit "Lidhja e Prizrenit" Prizren, Kosovë.
19. Ansamblit artistik "Lunxheria", Gjirokastër "për vallen e kënduar".
20. Qendrës Kulturore Peshkopi , "për vallen e vajzave".

Rruga e Arbërit nr. 102

festivali




# Oda Dibrane, festivali që ka prodhuar vlera

**Ky festival përmbledh mikpritjen dibrane, përmbledh bujarinë dibrane, përmbledh kulturën e lartë dibrane, përmbledh njerëzit e palodhur të kulturës nga Dibra, por dhe nga krahina e qytete të tjera të vendit.**

Nga **BUJAR LESKAJ**

Dashamirësit e Odës Dibrane në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e më gjerë në trojet shqiptare e më gjerë padyshim janë me mijëra. Unë personalisht si qytetar vlonjat ndihem i privilegjuar dhe shumë i vlerësuar që më jepet mundësia që në këtë 20 vjetor të madh të odës dibrane të jap opinionin tim.

Në këtë opinion do të përpiqem të jap një mesazh në pozitat e artdashësit, në pozitat e një njeriu që pëlqen, e dashuron folklorin popullor, e dashuron atë folklor që lëvrohet në Labëri, lëvrohet në veri, në Dibër, Tropojë, Sarandë dhe në të gjitha qytetet, krahinat Shqipërisë e Kosovës, Maqedonisë. Në rast se do të shikojmë me vëmendje ecurinë e festivaleve në përgjithësi dhe të festivaleve folklorike në veçanti në Shqipëri në këto 24 vite, por edhe më gjerë, padyshim të gjithë ne biem dakord që Oda Dibrane është festival unik, është festivali më jetëgjatë, është festivali që ka prodhuar vlera të veçanta, është festivali që i ka rezistuar kohës falë pasionit, mundit, punës së përkushtuar të gjithë ekipit që përgatit festivalin "Oda Dibrane".

Ky është një festival i veçantë në spektrin e tij, pra, është një festival që përmbledh këngën popullore, përmbledh zakonet e ndryshme, lojërat popullore, duke i fokusuar në atë të alegrisë, të humorit, por është një festival, jetëgjatësia e tij 20 vjeçare padyshim na bën ne që, në radhë të parë të shprehim një falenderim e një respekt të veçante për organizatorët e tij, për të gjithë popullin e Peshkopisë, për artdashësit e Peshkopisë,grupet amatore të Peshkopisë, për biznesin që ka mbështetur këtë festival dhe drejtuesit e pushtetit vendor të Peshkopisë, por mbi të gjitha për njeriun që e ka ideuar, e ka organizuar, e ka udhëhequr në këto 20 vite, për artistin e madh shqiptar z. Veli Vraniçi.

Në këto 25 vjet të tranzicionit ka qenë dhe është e vështirë të organizosh festival,për më tepër festival folklorik. Të organizosh festivale e t'i mbash për një kohë kaq të gjatë dhe për më tepër cilësia e tyre artistike, mesazhi i tyre, nga viti në vit të vijë duke u rritur. Dhe unë mendoj që ky 20 vjetor na bën ne krenarë, të gjithë ne vlonjate, dibranë, tiranas, kuksianë, prizrenas, qytetarë shqiptarë të Shkupit, Kumanovës etj., na bën ne krenarë për vlerat e një artisti të veçantë, për vlerat e një shërbestari të madh të kulturës shqiptare, vlerat e një punëtori të palodhur të kulturës shqiptare siç është zoti Veli Vraniçi, i cili ka ditur që atyre vlerave të larta, fisnike, të qytetit të Peshkopisë e të krahinës së Dibrës, atyre vlerave të larta të prodhuar në politikë, në kulturë, në ekonomi nga personalitete të shquara të Dibrës, t'u bashkangjisë këtë event, këtë ngjarje të madhe kulturore për të gjithë Shqipërinë, të cilës ne do t'i festojmë 20 vjetorin.

Natyrisht, një falenderim shkon dhe për të gjithë ata personalitete të kulturës kombëtare, për të gjithë ata drejtues të pushtetit vendor apo dhe qendror, që e kanë ndihmuar e kanë kontribuar në organizimin e këtij eventi.

Për mua si vlonjat ky aktivitet është i veçantë, e theksova më parë, jo vetëm se është unik, por ky aktivitet është një model se si duhet të zhvillohet dhe në qytete e në krahina të tjera të veçanta, duke marrë specifika të caktuar të kulturës tonë kombëtare. Kultura jonë kombëtare, pasuritë e kulturës tonë kombëtare janë si pasuritë e një deti të pafund, janë pasuritë e një lumi të rrëmbyer, janë pasuritë e maleve, të fushave tona, janë pasuritë e atyre njerëzve që kanë lëvruar me sukses në vite e vite, çka na bën ne të ndjehemi shqiptarë, por do të përmendja me një përkushtim, me një veneracion të veçantë e atyre artistëve popullorë, të cilët në këto 20-25 vite të vështira tranzicioni, kanë ditur ta lëvrojnë, ta kultivojnë, ta mbrojnë e të japin mesazhe të qarta për krejt brezin e ri.

Në mbyllje të kësaj përshëndetje të shkurtër, dëshiroj dhe njëherë të shpreh vlerësimin tim të veçantë për të gjithë popullin e Peshkopisë. Ditët e festivalit, ditët e Odës dibrane, janë ditë ku përfshihet e gjithë oda shqiptare, janë ditë ku çdo shqiptar, e ndjen veten sikur është në qytetin e tij, krahinën e tij, sikur është në rajonin e tij.

Personalisht kam pasur fatin që të paktën në këto 20 festivale, në pesë prej tyre, kam qenë në pozicionin e një qytetari të thjeshtë, dashamirësit të artit e kulturës dibrane në veçanti, të odes dibrane, kam qenë në pozicionin e drejtuesit të lartë të Ministrisë së Kulturës,që e kam përshëndetur këtë festival të madh kulturor, këtë ngjarje të veçantë, kam qenë në atë pozicion ku kam shoqëruar grupe bashkëqytetarësh të mi nga Vlora dhe e kam ndjerë në çdo aspekt madhështinë e këtij festivali.

Unë i jam bashkuar atij kontributi e përpjekjeve modeste që shumë zyrtarë të rangut të mesëm apo të lartë, mbi të gjitha profesorë të nderuar personalitete të kulturës sonë kombëtare, biznesmenë të fuqishëm të qytetit të Peshkopisë, drejtues të lartë, të gjithë kryetarët e bashkive apo deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët janë për t'u përshëndetur, për atë gjithë ne i jemi bashkuar përpjekjeve madhore të mjeshtrit të madh Veli Vraniçi për të kontribuar në mbarëvajtjen e këtij festivali. Kontributi im modest është pjesë organike e asaj krahine nga unë vij, e Labërisë, për të qenë më i saktë, dashamirësia ime për "Odën Dibrane" është dashamirësi që buron në radhë të parë për vlerat e larta artistike, së dyti është një dashamirësi e respekt që buron nga ajo mikpritje e madhe, fisnike që unë personalisht dhe miqtë e mi vlonjatë kemi gjetur në qytetin e Peshkopisë dhe së treti është një kontribut modest që japim, unë mendoj, kur ndjekim këtë festival si artdashës. Të gjithë ne kemi nevojë për artin, kemi nevojë për festivale të tilla, për festivale të rëndësishme të kulturës sonë kombëtare dhe specifikisht në këtë zhanër të folklorit, festivali "Oda Dibrane" për mua zë vendin e parë. Është kryefjalë e festivaleve tona. Mjaftojmë të kujtojmë faktin që ne të gjithë drejtuesit dhe ish drejtuesit e Ministrisë së Kulturës, por edhe drejtues të tjerë, nuk po dimë të vazhdojmë atë traditë të mirë të festivalit të Gjirokastrës. Nuk po dimë të orientohemi drejt për t'i mbajtur këto festivale permanente. Është një punë, unë jo me kot e përmenda mjeshtrin e madh Veli Vraniçi, ai nuk ka nevojë për lavdërimet e mia, për përcaktimet e mia, por është një punë do të thoja e pashtershme, është një punë e palodhshme e duhet një përkushtim i madh, duhet me qenë një shërbestar i madh, siç thoshte i madhi Mit'hat Frashëri, që të realizosh këtë festival për 20 vjet. Dhe të mendosh në vite të vështira të tranzicionit, në vitet '94, në vitet '97-98, në vitet 2000.

Pra, ky festival përmbledh mikpritjen dibrane, përmbledh bujarinë dibrane, përmbledh kulturën e lartë dibrane, përmbledh njerëzit e palodhur të kulturës nga Dibra, por dhe nga krahina e qytete të tjera të vendit.

** Ish Ministër i Kulturës*

## Festivali, sinonim i pasurisë shpirtërore të një kombi

*Nga* **ARIAN SUKNIQI ***

Oda Dibrane tashmë është bërë sinonim i pasurisë shpirtërore të një kombi të tërë. Porta e vetme, e cila për 20 vite është hapur bujarisht duke i dhënë shpirtin trashëgimisë kulturore për të gjithë shqipfolësit kudo ku gjinden. Tashmë kjo odë është kthyer në monument kulture, ku artistët e ruajnë dhe i japin jetë me krijimtarinë e vet.

Dera e kësaj ode ndër vite kishte shumë vështirësi për t'u hapur, por kurrë nuk mbeti e mbyllur, e shtyu dashuria dhe serioziteti i organizatorëve model. Në fakt, unë dua ta citoj me forcë dhe shumë respekt për njeriun që i dha gjak nga i veti këtij aktiviteti, zemërbardhit, pasionantit z.Veli Vraniçi.

Folklori duhet t'i jetë mirënjohës për mundësinë që i dha. Unë uroj me gjithë shpirt që oda të vazhdojë dhe të zmadhohet si një strehëz bujare e etnofolkloristikës shqiptare. Ky aktivitet u ka dhënë jetë shumë perlave shqiptare që tashmë një komb i tërë krenohet me to.

*Koreograf baletmaester TKOB*




# "ODA DIBRANE", një institucion me karakter social – kulturor

**Oda dibrane bashkon në një festë të vërtetë artistike popullore, artistë e studiues nga të gjitha trevat shqiptare...**

*Nga* **Prof. ZEF ÇOBA**

Përvoja ime gjatë periudhës që kam kryer aktivitetin në qytetin e Peshkopisë në vitet 1973-1980 me një jetë shumë dinamike, më rezulton të them me plot gojë se: "ODA DIBRANE" në traditën e kësaj treve, ka qenë një institucion i rëndësishëm me karakter social – kulturor.

Ka 20 vite që Peshkopia këtë institucion e ngriti në KULT, me promovimin dhe zhvillimin e Festivalit "ODA DIBRANE". Për këtë, në këtë jubile vendosi respektin tim për ato që e ideuan dhe i bënë udhë dhe e mbështetën këtë aktivitet të rëndësishëm për këto arsye:

1.Në shkallë kombëtare pasuron me origjinalitet larminë e eveniment-eve artistike që zhvillohen në vendin tonë, duke evidentuar pasurinë e botës së madhe shpirtërore e artistike, mendimin kombëtar të farkëtuar në kudhrën e historisë që ka kaluar vendi dhe populli ynë, në rrjedhjen e viteve e të shekujve.

2. Bashkon në një festë të vërtetë artistike popullore, artistë e studiues nga të gjitha trevat shqiptare, për të promovuar brenda profilit të "ODES DIBRANE" në një mozaik të pasur, vlerat më të zgjedhura e origjinale të trashëgimisë kulturoro – artistike, folklorike.

3. Pasuron jetën kulturore - artistike të qytetit të Peshkopisë, duke argëtuar publikun e nderuar dhe duke edukuar brezat e rinj me thellësinë e mendimit të "shkollës së Dibrës", mikpritjes e bujarisë, artit fin të fjalës, të këngës e të valles dibrane.

4Aktiviteti "ODA DIBRANE", për seriozitetin e organizimit dhe të zhvillimit, gëzon statusin e respektit të fituar në këto 20 vite, nga dhjetëra e qindra artistë nga të gjitha anët e trojeve shqiptare, që u ngjitën në skenën e këtij aktiviteti, u njohën me vlerat që sollën, u bashkuan e u vllazëruan.

Përfitoj nga rasti të përshëndes miqtë e mi artistë që punojnë me pasion në qytetin e Peshkopisë, me të cilët gjithnjë bashkoj vullnetin tim. Përshëndes me respekt popullin fisnik e artdashës të Dibrës, që në shekuj ka krijuar, formuar e ruajtur një gjuhë artistike të shpirtit krejt origjinale e shumë të pasur në fjalë, këngë e valle, veshje e instrumente tradicionale.

# oda

## Promovuesja e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale mbarëkombëtare

*Nga* **ARIAN AVRAZI***

Pranova me shumë kënaqësi, pas ftesës që më drejtoi miku im, Drejtori i Pallatit të Kulturës "Haki Stërmilli" Peshkopi, z. Veli Vrançi, për të përshëndetur edicionin jubilar të 20-të të "Odës Dibrane, veprimtari e cila tashmë është kthyer në një traditë të padiskutueshme në kalendarin kombëtar të veprimtarive kulturore të trashëgimisë kulturore jomateriale.

Kujtoj prej vitesh punën e madhe të organizatorëve të kësaj veprimtarie, për një cilësi e nivel të lartë artistik në paraqitjen e folklorit të të gjitha trevave shqiptare, të instrumenteve popullorë të kostumeve popullore autentike si dhe të një repertori sa më origjinal, dhe puna e tyre 20 vjeçare u shpërblyer me paraqitje dinjitoze të folklorit shqiptar në skenën e Festivalit, si dhe me daljen e dhjetëra artistëve të rinj e të talentuar nga të gjitha viset e Shqipërisë, Kosovës, shqiptarëve të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Kështu, ky Festival u kthye edhe në një shkollë të interpretimit dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë shpirtërore shqiptare të krijuara prej shekujsh nga populli ynë, si dhe të kalimit të këtyre vlerave tek brezat e rinj.

Gjithashtu, ky Festival prej 20 vitesh ka arritur të bashkojë artistët shqiptarë kudo që ndodhen, me idenë brilante dibrane që "Oda Dibrane" do të jetë mikpritëse e gjithë "Odës Shqiptare". Padyshim që ky është një Festival shumë origjinal në llojin e vet, i cili ndër të tjera ka synuar dhe synon të rizgjojë edhe vlerat e papërsëritshme të trashëgimisë sonë shpirtërore, duke paraqitur rite të lashta dhe vegla karakteristike muzikore, të mikpritjes tradicionale që dibranët ju bëjnë të ftuarve në Odën karakteristike të tyre, si dhe të promovimit të vlerave turistike të qytetit tuaj e zonave për rreth tij, duke e kthyer këtë veprimtari në festë të madhe të kulturës dhe qytetarisë dibrane, por dhe të turizmit kulturor.

Kjo veprimtari e suksesshme ka treguar prej vitesh edhe një bashkëpunim mjaft të mirë midis pushtetit qendror, atij vendor, Qendrës Kulturore dhe biznesit dibran, bashkëpunim i cili ka ndihmuar edhe në organizimin prej 20 vitesh të Festivalit Folklorik "Oda Dibrane", duke e kthyer periudhën e organizimit të saj në një festë të qytetit dhe të folklorit mbarëkombëtar shqiptar. Gëzuar 20 vjetorin e "Odës Dibrane" artistë pjesëmarrës ndër vite dhe organizatorë të saj.

Uroj që kjo veprimtari, e cila tregon aspektin e shkëlqyer të dibranëve, atë të mikpritjes origjinale dibrane, të vazhdojë çdo vit në të mirë të mbrojtjes, promovimit dhe popullarizimi të folklorit mbarëkombëtar të të gjitha viseve ku banojnë shqiptarët, shtimin e vizitorëve dhe turistëve vendas dhe të huaj, gjallërimin e jetës kulturore artistike dhe të biznesit në qytetin e Peshkopisë, në veçanti dhe të zonave rreth saj.

** Kompozitor*

**Ky Festival prej 20 vitesh ka arritur të bashkojë artistët shqiptarë kudo që ndodhen, me idenë brilante dibrane që "Oda Dibrane" do të jetë mikpritëse e gjithë "Odës Shqiptare"...**




# Oda Dibrane, një festival unikal dhe me mesazh atdhetar

**NGA ERMIR DIZDARI** – *"Mjeshtër i Madh"*

Festivali folklorik "Oda Dibrane" që zhvillohet në qytetin e Peshkopisë vjen në edicionin e 20- të saj, si një veprimtari folklorike e qëndrueshme, me një fizionomi të qartë në llojin e vet, me një shtrirje të përfaqësimit gjeografik dhe etnografik nëpërmjet përzgjedhjes së grupeve apo ansambleve folklorike më të mira. Ajo nisi në vitin 1994 me idenë e pasqyrimit të cilësive më të mira të kësaj krahine, si mençuria, trimëria, fjalët e urta, dialogu alegorik etj, që shprehen më së miri nëpërmjet rapsodit popullor, duke mbetur kështu një veprimtari lokale.

Por shumë shpejt u zgjerua duke futur këngët, vallet, pjesët orkestrale nëpërmjet grupeve të ndryshme folklorike të të gjitha krahinave ku banojnë shqiptarët, pavarësisht nga kufijtë administrativë shtetërorë të tyre, duke u kthyer kështu në një veprimtari me përmasa mbarëkombëtare. Kënga popullore qytetare e Shqipërisë së Mesme, këngët polifonike toske dhe labe, rapsodët e Rrafshit të Dukagjinit, vallet e krahinës së Karadakut, materialet folklorike të Pollogut, Malësisë së Madhe, Ana e Malit e shumë e shumë të tjera, gjallërojnë jetën e qytetit për vite me radhë, por ato vlejnë më shumë në afrimin shpirtëror të shqiptarëve kudo që janë.

- Për të gjitha këto, "Oda Dibrane" është një veprimtari që ka dhënë një kontribut të çmuar për kulturën dhe traditën shqiptare. Ajo mbetet një aktivitet me karakter të veçantë Kombëtar në ruajtjen e folklorit dhe transmetimin e mesazhit tek brezat e rinj për rolin dhe rëndësinë e folklorit në identitetin e një kombi.

- Të shkruash për përmasat që ka "Oda Dibrane" duhen faqe të tjera vlerësimi, e me këtë rast nuk të jepet mundësia, mbasi unë kam marrë pjesë shumë herë në këtë veprimtari, duke pasur vlerësimet më të larta, përshtypjet, emocionet, për mënyrën e organizimit, gjeografi- shtrirjen e grupeve pjesëmarrëse, mikpritjen, korrektësinë, profesionalizmin, prezantimin dhe propagandimin. Në të gjitha këto aspekte "Oda Dibrane" mbetet një visar në gjerdanin e artë të folklorit dhe të përhapjes së kulturës shqiptare.

- Sigurisht që ky aktivitet zhvillohet me punën e shumë njerëzve, por nuk mund të le pa përmendur drejtorin e këtij festivali z.Veli Vraniçi, që së bashku me ekipin e tij e solli deri në edicionin e XX të tij "Odën Dibrane" me dinjitet dhe sukses të padiskutueshëm.

- Urime të gjithë kontribuesve, pjesëmarrësve në vite për këtë event kaq sinjifikativ, që ndoshta do të marrë ngjyrat e flamurit në këtë jubile të rëndësishëm të popullit tonë.



# Festivali që nxjerr në pah shpirtin e popullit

Nga Prof. Dr. **ISAK SHEHU**

Në këtë përvjetor burojnë vetëm falenderime për Odën Dibrane, e cila me bujarinë e me mikpritjen tradicionale të kësaj treve me kulturë të lashtë, ka ditur me shumë sukses të nxjerrë në pah shpirtin e popullit tonë nga të gjitha krahinat. Në skenën e Odës janë ngjitur që nga vallja çame deri tek lahuta e Malësisë se veriut, që nga vallja e Sharrit deri tek grupet polifonike labe, që nga rituali i dasmës dibrane, deri tek këngët humoristike të Gramshit, një numër i pafund kryeveprash të folklorit tonë, të cilat kanë lënë gjurmë në mendjet dhe zemrat e publikut artdashës dibran.

Por nga ana tjetër, roli i këtij manifestimi është shumë i rëndësishëm në ruajtjen dhe kultivimin e këtyre vlerave unikale kombëtare, duke patur parasysh globalizimin dhe tendencat moderniste që dëmtojnë drejtpërsëdrejti këto vlera. Këtu dua të theksoj rolin që ka luajtur Oda Dibrane në përfshirjen e brezave të rinj në këtë aktivitet, duke siguruar kështu vazhdimësinë e traditës sonë të mrekullueshme popullore. Pjesëmarrja e tyre ka qenë e përvitshme mbi 60 %, gjë që tregon më së miri arritjen e këtij pikësynimi.

Përshëndetje e veçantë shkon për organizatorët e këtij aktiviteti mbarëkombëtar, ku spikat në mënyrë të veçantë figura e drejtorit e regjisorit Veli Vraniçi, i cili me dashuri e përkushtim të jashtëzakonshëm ka punuar për të siguruar vazhdimësinë, nivelin e lartë artistik, pjesëmarrjen dhe mbarëvajtjen e tij; Bashkinë e qytetit Peshkopi, për mbështetjen ekonomike, morale e logjistike, gjë që tregon vizionin e saj për rolin që ka kultura në ecjen përpara të një kombi; Ministrinë Kulturës për mbështetjen e vazhdueshme të këtij aktiviteti; si dhe të gjithë ata biznesmenë dibranë, që me bujari kanë dhënë një kontribut të çmueshëm në ruajtjen e kultivimin e artit tonë popullor.

I uroj Odës Dibrane T'I BËHET DITA NJËMIJË e u uroj SUKSESE të gjithë organizatorëve e pjesëmarrësve.

## SPONSORË NË VITE

1. Fondacioni "Soros"- Tirane
2. Fondacioni Hollandez FPLQV"- Peshkopi
3. Hotel "Korabi"- Peshkopi
4. Hotel "Veri"- Peshkopi
5. Firma e ndertimit "Cani"- Tirane
6. "Aurora Gips"- Tirane
7. Ambasada e Mbreterise se Danimarkes
8. "Ylli Bingo" - Tirane
9. "Euraldi" shpk- Peshkopi
10. "Florian"-K shpk- Peshkopi
11. "Depllast" - Diber e Madhe
12. Firma "Blini"- Peshkopi
13. "Klevi Bingo"- Peshkopi
14. "Drini Konstruksion"- Peshkopi
15. Firma "Dibra"- Peshkopi
16. Firma "Haka"- Peshkopi
17. Kryesia e SHKASH- Maqedoni
18. "Paneli"imp-exp sh.p.k - Demir Rusi
19. "Diamand" sh.p.k - Tirane
20. "Risku" sh.p.k- Tirane
21. Botime "M&B"- Tirane
22. "Murati B.A."sh.p.k- Tirane
23. Firma e ndertimit "Selami"- Peshkopi
24. Firma e ndertimit "Dibra" (AGZA)- Durres
25. PSHM (Oportunity Albania)- Tirane
26. Raiffeisen Bank- Peshkopi
27. Societte Generale Albania- Peshkopi
28. Vodafon Albania - Tirane
29. Hotel "Klajdi"- Peshkopi
30. Hotel "Brazil"- Peshkopi
31. Hotel "Ergon"- Peshkopi
32. Hotel"Piazza"- Peshkopi
33. World Vizion- Peshkopi
34. Hotel "Ballkan"- Peshkopi
35. Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale ALCDF
36. Ambasada e Mbreterise se Hollandes
37. "Gjoka" konstruksion- Tirane
38. "Perxhola" sh.p.k. - Tirane
39. "NDREGJONI" sh.p.k.- Tirane
40. "PRO-GIPS" sh.p.k.- Tirane
41. "DAJTI CONSTRUXION" sh.p.k.- Tirane
42. Hotel "BRUKLIN" - Peshkopi

Rruga e Arbërit nr. 102

**Me mbështetjen e UN Women, një projekt për fuqizimin ekonomik të grave ka nisur në Shqipëri, duke ndihmuar gratë rurale të kultivojnë aftësitë e tyre në biznes dhe të rrisin të ardhurat nëpërmjet organizimit të kooperativave.**

sociale

# Puna në grup nxit biznesin dhe fuqizimin ekonomik të grave në Shqipëri

Nga **GIZEM YARBIL GUROL**



Në fushat pjellore të Dibrës, njëri nga rajonet më të varfër në Shqipëri, i lokalizuar në kufirin Verilindor të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, 47 vjeçarja Emrie Lata dhe bashkëshorti i saj po mbledhin të korrat e përditshme. Emrija ka punuar në këtë tokë pjesën më të madhe të jetës së saj, duke mbledhur fruta pylli, zarzavate, dhe bimë medicinale, të cilat i shet për të nxjerrë sadopak fitim për familjen e saj. Bashkëshorti i saj është i papunë dhe Emrija duhet të mbështesë familjen e saj, përfshirë 3 djemtë e tyre. Njëri prej tyre ka emigruar jashtë vendit për të ndihmuar familjen, por të ardhurat e tij të vetme nuk mjaftojnë.

Sot, falë një nisme të re që mundëson aftësi biznesi dhe mbështetje për gratë rurale në Shqipëri, biznesi i vogël bujqësor i Emries po bëhet fitimprurës, duke rritur ndjeshëm të ardhurat për familjen e saj. I zbatuar në Tetor 2013, nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe organizata lokale Agritra Vision, me mbështetjen e UN Women dhe Qeverisë Suedeze, projekti "Fuqizimi i Grave Nëpërmjet Zhvillimit Ekonomik të Klasterave" synon pikërisht të sjellë sëbashku gratë feremere për të shitur produktet e tyre në shoqata të përbashkëta dhe grupe të vetë-organizuara.

Projekti i mëson grave si Emrieja aftësi konkrete – ndarja efektive e roleve brenda grupit, rritja e produktivitetit dhe ulja e kostove, lidhja e rrjetëzimi me donatorë dhe organizata; arritja e granteve apo kredive mbështetëse, si dhe përmirësimi i aspekteve financiare dhe marketingu.

"Jeta ime ka ndryshuar shumë", thotë Emrieja. "Më parë nuk dija si të mblidhja dhe thaja produktet pa i dëmtuar ato. Por tani kam njohurinë e nevojshme, çka solli rritje në cilësinë e produkteve"

Emrija është një nga 20 gratë fermere që rrisin fruta të vogla dhe barishte në komunën Melan dhe Tomin në rajonin e Dibrës. Gratë sëbashku kanë krijuar edhe Shoqatën e Bashkëpunimit Bujqësor "Produkte Staraveci". Me mbështetjen e projektit të klasterave ekonomikë, gratë kanë zhvilluar strategjinë e biznesit të kooperativës, mësuan mbi marketingun, vendosjen e çmimeve, magazinimin dhe shërbimin e produkteve, si dhe etiketëzimin dhe paketimin e produkteve për të rritur vlerën e tyre në treg.

"Tashmë, me njohuritë dhe mbështetjen që kemi marrë, mund të marrim pjesë në panaire lokale apo rajonale", tregon Shpresa Tomcini, një tjetër përfituese e projektit. . "Kështu, unë kam qenë në gjendje të mbështesë familjen time nëpërmjet këtij projekti"

Për shumicën e këtyre grave, puna e tyre në sektorin e bujqësisë është burimi i vetëm i të ardhurave për familjen. Megjithatë, pa njohuritë, aftësitë dhe infrastrukturën e nevojshme për të përpunuar dhe magazinuar produktet e tyre si dhe pa një plan të mirë biznesi, rritja e tyre, fuqia negociuese dhe përfitimet do të cënoheshin.

"Sjellja bashkë si një grup është një mundësi që këto gra kanë për të mbështetur njëra – tjetrën në arritjen e tregut dhe klientëve. Vetëm do të ishte e pamundur!" thotë Majlinda Hoxha, Bashkëthemeluese e klusterit të Dibrës dhe drejtuese e organizatës Agritra Vision. Ajo tregon se qëllimi i projektit është t´u mësojë grave dhe vendimmarrësve lokalë mbi rëndësinë e punës në grup për suksesin e tyre në ekonomi. Gratë tashmë mund të arrijnë më shumë tregje për prodhimet e tyre, madje përtej qendrës së qytetit.

"Në të kaluarën gratë punonin për distributorët, por pa patur fuqinë për të negociuar me ta", shton Hoxha. "Tashmë, duke u regjistruar si biznes i vogël, është më e lehtë për to, të nënshkruajnë kontrata me kompanitë mbledhëse të cilat blejnë këto produkte"

Shpresa tregon se projekti e bëri atë të ndihet më e fortë sepse tashmë mund të përmbushë nevojat për familjen e saj, por në të njëjtën kohë edhe sepse komuniteti ku ajo jeton, e ka vlerësuar dhe respektuar punën që gratë bëjnë.


Sipas David Saunders, Përfaqësuesi i UN Women në Shqipëri, "...projekti në Dibër do të kontribuojë gjerësisht në fuqizimin ekonomik të grave dhe përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetës së familjeve të tyre dhe komunitetit lokal". Kjo iniciativë është bërë një model suksesi edhe për zona e rajone të tjera në vend, ku gratë përballen me barriera e pengesa të ngjashme në fuqizimin ekonomik të tyre.

"Ka plot gra të tjera që duan të marrin pjesë në projekte të ngjashme, sepse kanë parë rezultatet tona mjaft pozitive", thotë Shpresa.

Për anëtarët e klasterit të Dibrës, planet për fazën e ardhëshme të rritjes së biznesit të tyre tashmë janë bërë. Ata duan të themelojnë një magazinë multi-funksionale që do zgjerojë ndjeshëm aktivitetin e tyre si biznes.

*www.unwomen.org.*

## SPORT & BAMIRËSI



© *Foto: Zaim Elezi*

# Keta, flori i mbitokës së Bulqizës!

Këtë radhë udhëtimi i gjatë Mike Gjetan Ketës, ndali pikërisht aty ku filloi. Bulqiza, prej vitesh e lënë në harresë, mbrëmjen e 18 tetorit nusëroi e veshur e gjitha kuq e zi. Rreth 10 mijë tifozë të mbledhur të gjithë për një qëllim, mbushën rrugët e qytetit më të varfër, por me një pasuri të madhe nën tokë. Tashmë edhe me një pasuri tjetër mbi tokë: Vëllezërit Keta, që tani e më pas, në qytetin e tyre do të njihen si "Flori i mbitokës".

Boksieri Gjetan Keta më në fund e realizoi ëndrrën duke mbrojtur titullin kampion për Euroazinë në kategorinë ËBC në vendlindjen e tij, Bulqizë përballë rusit Marat Khuzeev.

Keta, i cili stërvitet nga vëllai i tij, Ismaili, një tjetër kampion bote, arriti që të fitonte duelin me boksierin rus me nokaut teknik në raundin e tretë. Fusha e Bulqizës u mbush me brohorimat e tifozëve në stadium, rreth stadiumit dhe në qytet.

"Sot realizova ëndrrën e shumë viteve për të mbrojtur titullin kampion në vendlindje. Falenderoj të gjithë të pranishmit që më mbështetën. Nuk do ta harroj kurrë këtë fitore" tha kampioni Gjetan Keta.

Pas ndeshjes së parë në Bulqizë tashmë pritet që në një të ardhme jo të largët, Keta të mbrojë titullin kampion, pse jo në Tiranë, ku mbështetja do të ishite akoma më e madhe.

Mike Gjetan Keta ishte në Bulqizë për të mbrojtur titullin kampion. Ishte aty për të na bërë të gjithëve krenar, ashtu siç në fakt ndodhi vërtet. Ishte një sukses i pastër fitorja e Ketës, por jo vetëm e tij, fitorja e të gjithë Shqipërisë. Sporti shqiptar pa një event të organizuar në mënyre fantastike, ndoshta më të mirin deri tani në boks. Ndonëse u zhvillua në një arenë modeste e të improvizuar me pak para, kjo ndeshje arriti të kthejë sytë e të gjithë Europës nga Bulqiza.

Mbarë Dibra festoi për këtë fitore historike, për më tepër që kjo u arrit mu në zemër të saj. Fusha e Torviollit ishte dëshmitarja e fitores së dytë më të madhe. Skënderbeu aty mposhti turkun, Gjetani aty mposhti rusin.

Kjo ndeshja nuk ishte vetëm boks: ajo ishte edhe një ndeshje humanitare. Të ardhurat nga shitja e biletave, rreth 4 milionë lekë të reja, janë si fondi i parë për ngritjen e një qendre sportive në Bulqizë. Bulqiza, pas vëllezërve Keta, ka shansin të bëhet një qytet i vogël që do të nxjerrë kampionë të tjerë Europë dhe Bote! ***/ S.Ndreka***



Zhvillohet edicioni i 13-të i Festivalit të Teatrit Shqiptar në Maqedoni

**Ky është edicioni i 13 i festivalit, ku për 7 net me radhë performuan 7 trupa teatrore profesioniste nga hapësira mbarëshqiptare...**

# **Zamira Kita** *dhe* **Sotiraq Bratko** *shpallen si aktorët më të mirë*

*Nga* **ATLI DEMA**

Me "Norën" e Ibsenit u hap më 27 tetor në Qendrën për Kulturë në Dibër "Festivali i Teatrit Shqiptar në Maqedoni".

Ky është edicioni i 13 i festivalit ku për 7 net me radhë performuan 7 trupa teatrore profesioniste nga hapësira mbarëshqiptare.

Festivalin e shpalli të hapur gjeneral Gëzim Ostreni, ndërsa mbarëvajtje të punimeve të këtij festivali shprehu edhe sekretari i shtetit në Ministrinë e Kulturës të Maqedonisë, z. Bexhihudin Shehapi.

Në natën e parë në skenë u ngjit trupa teatrore profesioniste e qytetit të Prizrenit me pjesën "Nora - shtëpi kukulle", të autorit Henrik Ibsen, me regji të Sokol Plakollit.

Artistët e mrekullueshëm të Prizrenit, në veçanti Niada Salihasi, sfiduan artin skenik duke bërë përpjekje për të realizuar një dramë postmoderne. Ata vënë në lojë struktura të ndryshme udhëheqëse, ku kërkojnë të ngopin epshet e tyre në kurriz të artit dhe artistëve të mirëfilltë.

Nora e Ibsenit "Shtëpi Kukulle" është personifikim i artistes simbol, e krijuar për të qenë e tillë.

Në natën e dytë të festivalit u paraqit trupa profesioniste e qytetit tw Tetovës me shfaqjen "Vdekja aksidentale e një anarkisti" të Dario Fo, në regji tw Kushtrim Bekteshit.

Pjesa u vlerësua si shfaqje e nivelit të lartë, e plotë, me koncept të mrekullueshëm regjisorial dhe me premisa profesionale.

Me shfaqjen "Vdekja aksidentale e një anarkisti", regjisori dhe aktorët me mjeshtëri të rrallë, ashtu siç dinë artistët profesionistë, arritën që të prezantojnë denjësisht thumbimin e pushtetit të ç'thurur, gjegjësisht degjenerimin e shoqërisë. Vënia në thumb e degjenerimit të moralit shtetëror japin mesazhin te publiku dhe bëjnë apel të qartë në shpëtimin e njeriut nga interesat materiale dhe degjenerimin e shoqërisë të mbytur në amoralitet.

Interpretimin virtuoz e mjaft interesant i shfaqjes nëpërmjet gjuhës skenike dhe mizanskenës arriti të familjarizohet dhe mishërohet me publikun.

Ngjarja realizohet në stacionin policor, ndërkaq personazhi kryesor është një i çmendur, i cili gjatë gjithë kohës do të hulumtojë incidentin në të cilin një anarkist bie nga dritarja e katit të katërt të stacionit policor ku është marrë në pyetje. Ai zbulon idiotësinë dhe gënjeshtrat e zyrtarëve policor. Autori përmes kësaj komedie të këndshme vë në dukje dobësitë dhe kurthet e liga që realizojnë strukturat shtetërore ndaj qytetarëve të pafajshëm.

Festivali i Teatrit Shqiptar në Maqedoni në natën e tretë të tij arrin që gradualisht të formojë fizionominë e tij para spektatorit dibran me pjesën "Borxhlinjtë" të teatrit "Petro Marko", Vlorë, e cila mirëpritet nga artdashësit. Autori përmes martesës së parë të dështuar dhe një e dytë që po shkon drejt fundit, ku ish-burri kërkon të hakmerret, duke i çuar dy personazhet drejt shkatërrimit dhe tragjedisë.

Strindberg, me aftësinë e penës së tij, vendos në qendër të ngjarjeve figurën e gruas dhe përmes



saj, përcjell atë dramaticitet që shoqëron prishjen e institucionit të martesës.

Në natën e katërt të festivalit në skenë u ngjit trupa profesioniste "Aleksandër Moisiu" nga Durrësi me pjesën "Këtu vallëzohet me hijet" të autorit dhe njëkohësisht edhe regjisorit, Bashkim Hoxha.

Autori i veprës sjell problematikën aktuale të shoqërisë shqiptarë, së cilës e kaluara e hidhët, pra koha e komuniste i ngatërrohet akoma nëpër këmbë. Në shfaqej gjatë gjithë kohës sulmohet mungesa e lirisë së sjelljes dhe fjalës, ndjekja nga sigurimi e familjeve shqiptare duke i përcjellë deri në vdekje.

Edhe pse ka afër një çerek shekulli nga shkëputja nga komunizmi, fabula e kësaj drame sjell ne vëmendje faktin se kjo e shkuar e hidhet vazhdon të na përndjekë.

Në natën pestë u prezantua teatri "Andon Zako Çajupi" nga Korça me dramën e "Kapitulli i Dytë", shkruar nga Neil Simon dhe vënë në skenë nga Qëndrim Rijani, me skenografi nga Beqo Nanaj dhe interpretim nga Sotiraq Bratko, Zamira Kita, Blerta Belliu dhe Mateus Frroku.

Kjo pjesë, shkruar nga autori për nder të Marsha Mason, gruas së tij të dytë, e cila e mirëkuptoi dhimbjen e tij të stërzgjatur për vdekjen e gruas së tij të parë. Ka diçka vërtet shumë të dhimbshme këtu, që e gjithë trupa rrotullohet përreth një njeriu që mundohet të pajtohet me vdekjen e gruas së parë, më shumë sesa me fillimin e një jete të re.

Në ditën e gjashtë para artëdashësve luajti Teatri i Kumanovës me dramën "Mbledhja në parlament" të autorit Ray Cooney, me regji të realizuar nga Sulejman Rushiti.

Të pasqyruarit të realitetit jetësor përmes dramës e rriti fizionominë e festivalit, dhe në veçanti këtë e dëshmoi loja e aktorëve nga teatri i Kumanoves, Sefedin Shabani, Enver Halimi, Linda Shabani etj. Loja e shprehur e aktorëve, koncepti regjisorial dhe detajet e tjera shtruan mesazhin e kësaj komedie, ku aktorët dëshmuan profesionalizmin, përkushtimin skenik dhe ndërtimin e karaktereve. Përmes lojës skenike sulmohet amoraliteti i politikanëve. Të gjithë aktorët janë protagonistë të një afere të një lidhje intime midis një ministri qeverie dhe sekretareje të opozitës, dhe kjo situatë bën që pozita si shkas i kësaj afere të humbasë zgjedhjet.

Në natën e fundit të festivalit para publikut dibran u paraqit Teatri Kombëtar i Baletit të Kosovës me pjesën "Dasma", me Koreografi të realizuar nga Mehmet Ballkan. Shfaqja ishte një befasi e këndshme, një "qershi mbi tortë" në përmbyllje të Festivalit të Teatrit Shqiptar në Maqedoni.

Përformanca e baletit të Kosovës u ndoq me vëmendje të madhe. Publiku dibran shfaqi bindjen se "nuk do ta mendonim kurrë që do të shikonim një trupë baleti nga Kosova me një nivel artistik kaq të lartë".


Pas shfaqjes së baletit, juria në përbërje të së cilës ishin Ilir Ajdin, Rajmonda Bulku dhe Elmaze Nura ndanë çmimet e festivalit.

Çmimi si aktori dhe aktorja jo/protagonist shkoi për dy aktorët e teatrit të Kumanovës, Shkëlqim Islamin dhe Linda Shabanin. Aktori më i mirë u shpall Sotiraq Bratko, ndërsa aktorja më e mirë u shpall Zamira Kita, të dy nga teatri "Andon Zako Çajupi", Korçë. Çmimin "Sulejman Pitarka" për shfaqjen më të mirë e mori Teatri i Kumanovës me pjesën "Mbledhja në Parlament", ndërsa regjisori më i mirë u shpall Qëndrim Rijani i teatrit të Korçë.

Në mbyllje të festivalit përshëndetën edhe dy kryetarët e Komunës së Dibrës dhe bashkisë së Peshkopisë, Ruzhdi Lata dhe Ilir Krosi.

Ky festival është mbështetur nga Ministria e kulturës në Republikën e Maqedonisë, Komuna e Dibrës së madhe dhe Qendra për Kulturë në Dibër.





**Aktori dhe aktorja joprotagonist shkoi për dy aktorët e teatrit të Kumanovës, Shkëlqim Islamin dhe Linda Shabanin. Çmimin "Sulejman Pitarka" për shfaqjen më të mirë e mori Teatri i Kumanovës me pjesën "Mbledhja në Parlament", ndërsa regjisori më i mirë u shpall Qëndrim Rijani i teatrit të Korçë.**

Rruga e Arbërit nr. 102

intervistë

Intervista me Iva Merën është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të gazetës "Rruga e Arbërit" me faqen sociale në FB "Peshkopi,Dibër,Albania". Ajo do botohet edhe në faqen në internet http: peshkopidiberalbania.wix.com. Bashkëpunimi synon të bëjë publike me anë të intervistave sukseset e dibranëve në fusha të ndryshme të jetës.





# Iva Mera

# **Babai** *nuk donte të merresha* **me art**

*Bisedoi*: **SASHENKA NDREKA**

Iva Merës nuk i ndahet pas emri i babait. Dialekti dibran ka ndikuar në sukseset e Behar Merës, ndërsa për të bijën ka qenë një kujtim i largët fëmijërie.

Iva është larguar nga Dibra që në moshën 6-vjeçare. Ajo ka studiuar për gjermanisht ndërsa arsimin e lartë e ka kryer për shkenca politike, dhe më pas ka një master në shkencat e komunikimit. Dikur ka bërë modelen, por karrierën në televizion e ka nisur nga Perform Fest, dhe më vonë në Klan dhe Vizion Plus.

Ndërsa një nga momentet më të suksesshme ka qenë bashkëpunimi me Zana Çelën, që e sollën Ivën si një prezantuese model dhe me plot sharm dhe pasion për punën.

Iva Mera mbahet mend si vajza bukuroshe e spotit për turizmin në CNN në vitin 2009, dhe në këtë fillim viti si zëdhënësja plot sharm e klubit sportive Tirana.

Tani drejton edhe një emision për kuzhinën në një nga televizionet qendrore, ndërsa në një intervistë ekskluzive për gazetën "Rruga e Arbërit" dhe portalin online "Peshkopi, Dibër, Albania" nuk ngurron të nxjerrë pak sekrete të karrierës së saj, "kontradiktat" me të atin, planet për të ardhmen dhe sidomos lidhjeve me Dibrën.

* * *

*- Jeni një person publik. Ishte zgjedhja juaj që në fillim apo shtysa e babait?*

- Përshëndetje dhe faleminderit për intervistën tuaj! Orientimi im drejt botës së bukur të televizionit ka ardhur krejt natyrshëm nga dëshira ime personale! E mbaj mend veten të vogël kur dilja para pasqyrës dhe këndoja e prezantoja me gjithë vrull derisa mami me merrte me zor e më ulte në librat e shkollës! Babi, edhe pse në botën e artit, nuk ka dashur asnjëherë të më shihte në fushën e artit, madje shumë herë është bërë dhe pengesë për iniciativat e mia!


*- Si ka ndikuar në jetën tuaj fakti i të qenit bija e një artisti të njohur?*


- Të jesh fëmija i një prindi, i cili është person publik, pavarësisht profesionit, ka avantazhet dhe disavantazhet e veta! Mos harro që je në vëmendje edhe kur e harron këtë fakt! Nuk mund të mohoj faktin që ndihesh e përkëdhelur nga fakti që babin tënd e njeh publiku dhe të mbushet zemra me gëzim për këtë gjë, por shumë herë do të doje të kaloje rrugën dhe pa u vënë re ose pa u cilësuar si vajza e Beharit!

*- Nuk e keni mohuar asnjëherë prejardhjen tuaj, Çfarë mbani mend nga Dibra?*

- Nuk e kam mohuar dhe kurrë s'do ta mohoj prejardhjen time! Dibra, një origjinë me të cilën nuk krenohem vetëm unë, por edhe emra të njohur dhe të nderuar! Ajo, Dibra, më dhuroi mua dhe familjes time disa vlera karakteristike. Unë jam larguar 5-6 vjeç dhe mbaj mend shumë pak . Por me kalimin e viteve kam shkuar dhe e kam vizituat vendin tim të lindjes, duke kujtuar ato rrugicat e lagjes ku unë u rrita, kopshtin tim, shtëpinë e gjyshes apo dhe atë markaton e madhe ku ikja me qejf për të blerë kasata. Mbaj mend

**Mendoj që publiku të sheh dhe të vlerëson për atë çka t'i ofron me punën tënde, që do të thotë tek unë se si prezantoj apo drejtor një format televiziv të caktuar. Nëse të pëlqejnë, shumë shpejt kthehesh në të preferuarën e tyre, nëse jo, nuk harxhojnë më kohën duke të ndjekur ty. se kemi tonën në rregull.**





njëherë që ka rënë shumë dëborë dhe bashkë me shoqet e pallatit nisem të rrëshkisnim deri në orët e vona të pasdites! E kujtoj këtë ditë sepse me ka rrahur mami aq shumë sa akoma dhe sot më dhemb!

*- Babai juaj flet gjithmonë në dialektin dibran. A e ka trashëguar dhe tek ju?*

Unë, në fakt, përpiqem ndonjëherë të kujtoj disa fjalë të cilat më shijojnë t'i them në dialektin dibran. Për shkak të moshës së vogël të largimit tim nga Dibra, u rrita me gjuhën letrare dhe s'mund të them që jam mjeshtre e dialektit dibran, por disa fjalë nuk i kam harruar, oj cuc ....

*- Ju kemi pare të eksperimentoni në fusha të ndryshme: në sport, gatim, emisione rinore. Ku e keni gjetur më shumë veten?*

- Aty ku se kam gjetur veten janë pikërisht emisionet rinore, që flasim për gossip apo modë! Nuk e di pse, kurrë s'jam ndier rehat me një format të tillë! Te projekti im i fundit përpiqem të bëhem njësh me emisionin, pasi është praktik dhe popullor, ashtu siç mua më pëlqen! Por, nuk mund të lë pa përmendur përvojën më të bukur që kam pasur me fëmijët në Performfest, projekt i Zana Çelës, ku kam kujtimet më të bukura!

*- Aktualisht po drejtoni një emision gatimi? Sa e mirë je në kuzhinë?*

- Në kuzhinë jam shumë e mirë, edhe pse s'do më besonit! Kam defektin që jam pak dorëlëshuar, që do të thotë nuk kursej në atë që gatuaj, por ama të jesh e bindur që për shije marr pikët maksimale!

*- A është në planet tuaja afatgjata, angazhimi ne politikë, meqë jeni diplomuar në këtë degë?*

- Unë jam diplomuar për shkenca politike dhe master në marrëdhënie me publikun! Po të shohësh, kam një devijim të formimit tim, Dashje pa dashje jam orientuar te komunikimi publik, masmedia. Kjo do të thotë që e shoh veten larg politikës. Duhet të jesh natyrë tjetër të merresh apo të bësh politikë.

*- Si do të jetë Iva pas 10 vjetësh?*

- Pa hë??? Se edhe unë jam kurioze ta di... Si do të jem unë pas dhjetë vitesh? Uroj të jem mirë me shëndet, si fillim, dhe për një gjë ju siguroj: do të kem ca kilogramë më shumë. Për këtë po, që jam e bindur!

*- Me të drejtë keni mbajtur gjithmonë larg jetën private nga mediat. Do të bësh ndonjë përjashtim të vogël për ne?*

- Unë mendoj që publiku të sheh dhe të vlerëson për atë çka t'i ofron me punën tënde, që do të thotë tek unë se si prezantoj apo drejtor një format televiziv të caktuar. Nëse të pëlqejnë, shumë shpejt kthehesh në të preferuarën e tyre, nëse jo, nuk harxhojnë më kohën duke të ndjekur ty. Prandaj dhe për mua është shumë me interes të flas për punën, sepse jeta private e gjithsecilit prej nesh nuk do të na interesonte shumë, në rast se kemi tonën në rregull. Diferencën e bën vetë fjala publike dhe private. Publike është për opinion të gjerë ndërsa privatja të përket ty!

Libri




# Sukses i panairit të parë të librit në Peshkopi

**Në këtë panair u paraqitën më shumë se 100 autorë dhe mbi 300 tituj librash, të cilat janë botuar nga 57 shtëpi botuese. Autorë paraqesin botime jo vetëm për Dibrën, por edhe me vlera të mëdha në aspektin kombëtar.**

Nga data 23-26 tetor, në Peshkopi u mbajt për herë të parë Panairi i Librit, bazuar këtë herë mbi autorët dibranë dhe botimeve për Dibrën.

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë shkrimtarë, lexues të të gjitha moshave, drejtuesit e pushtetit lokal, nxënës dhe dashamirës të librit.

### LIBRI, PJESË E NATYRSHME E ODËS

"Në kuadër të 20-vjetorit të Odës Dibrane në bashkëpunim me Shtëpinë Botuese "M&B", menduam që të bëjmë një surprizë, sepse këtij 20-vjetori i takonte jo vetëm kënga dhe vallja por i takonte dhe libri, tha në ceremoninë e hapjes Veli Vraniçi, drejtori i Pallatit të Kulturës së Peshkopisë. Këtu ka kaq shumë botime dhe ne nuk kemi arritur akoma t'i evidentojmë sikur duhet, theksoi ai, duke vlerësuar se "ky 20-vjetor i Odës u zbukurua nga ky panair".

"Dua ta nis me një falënderim për të gjithë ju që jeni këtu, sepse pa mbështetjen tuaj ky panair nuk do të organizohej, tha Bujar Karoshi, redaktor pranë Botimeve M&B.

"Ishte një ide e vjetër që më ka trokitur në kokë për ta zgjeruar Odën. Kur shoh vështirësitë e Veli Vraniçit dhe bashkëpunëtorëve të tij për ta organizuar Odën Dibrane mendova se mund të kontribuoj sepse dhe libri mendoj se është një vlerë e rëndësishme e Odës Dibrane", tha ai.

"Në këtë panair ju do të keni mundësinë të shihni botime nga më shumë se 100 autore dhe mbi 300 tituj librash, të cilat janë botuar nga 57 shtëpi botuese. Autorë në këtë stende kanë botime jo vetëm për Dibrën, por edhe me vlera të mëdha në aspektin kombëtar".

Duke falënderuar qendrën kulturore të Peshkopisë dhe Bashkinë për krijimin e hapësirave pa pagesë për këtë panair, ai theksoi se dëshironte që Panairi të kthehej në një traditë të përvitshme të Odës, dhe të sjellë në vitet e ardhshme edhe shtëpi të tjera botuese, në mënyrë që ky holl i Pallatit të Kulturës të mbushet në çdo cep me libra, për të gjitha moshat dhe për të gjitha zhanret."

Kryetari i Bashkisë së Peshkopisë, z. Ilir Krosi, në fjalën përshëndetëse theksoi bashkëpunimin e suksesshëm që bashkia ka pasur në disa veprimtari të përbashkëta me Botimet M&B. "Qeverisja vendore ka vështirësi në mbështetjen e veprimtarive për kulturën në përgjithësi, theksoi ai, Bashkia ka qenë gjithmonë pranë atyre që kanë dashur të bashkëpunojnë dhe kanë kontribuar për gjallërimin e jetës kulturore në qytet".

"Ky panair është një kontribut të madh në përpjekjet për të kthyer vëmendjen nga libri dhe leximi, dhe ky numër i madh botimesh cilësore janë një tregues se fëmijët dhe nxënësit e shkollave po i rikthehen seriozisht librit", theksoi kryetari i bashkisë së Peshkopisë.

I pranishëm në ceremoninë e hapjes ishte edhe deputeti i Dibrës, Sherefedin Shehu. "Për Dibrën natyrisht që kjo është ngjarje e madhe po unë do të thoja që këto lloj ngjarjesh janë të mëdha edhe për faktin se ndonëse shtëpitë botuese rriten, ndonëse autorët publikojnë përsëri sot ka një debat lidhur me dashurinë për librin. Besoj që ky është një rast i mirë jo vetëm për të promovuar autorët dibranë, autorët që kanë shkruar për Dibrën, por njëkohësisht edhe për të kontribuar për rritjen e dashurisë për librin. Natyrisht që libri është ai që ka udhëhequr shoqërinë sepse aty ka qenë mendja e njerëzve që kanë menduar, kanë punuar dhe kanë parë nga e ardhmja", tha ai në ceremoninë e hapjes. "Sot unë erdha me kënaqësi për të qenë prezent natyrisht dhe për t'i përshëndetur autorët dhe botuesit, por njëkohësisht edhe për të garantuar atë mbështetje që unë e kam për detyrë që t'ua jap juve dhe gjithë Dibrës. Por ndërkohë unë dua të shpreh mirënjohje për ata që kanë shkruar, për ata që mbështesin shkrimtarët për botuesit sepse sidomos për ne, vijmë me kënaqësi por kemi edhe nostalgji për Dibrën dhe natyrisht kur i shikojmë të shkruara gjërat, kjo kënaqësi shumëfishohet", theksoi deputeti Shehu.

Drejtoresha e bibliotekës së Peshkopisë znj. Liljana Sadiku tha se "një panair të tillë libri, një festë aq të bukur të librit, për herë të parë e shoh në Peshkopi". Ajo i ftoi autorët dibranë që botimet e tyre ti dhurojnë pranë bibliotekës, pasi "lexuesit kanë shumë dëshirë për t'i lexuar.



### SHKRIMTARËT PËR PANAIRIN

"Ky panair është i veçantë dhe rrallë se gjen të ngjashëm në trojet shqiptare, thotë Hysen Kosovrasti, shkrimtar nga Dibra e Madhe. "Ne gëzohemi që masivisht dhe në mënyrë dinjitoze janë përfshirë të gjithë shkrimtarët e trojeve të Dibrës. Se ne Dibër i themi nga ku lind Migjeni e deri në Burrel, ajo është krahinë e Dibrës", thekson ai.

"Ky është panairi i parë për Dibrën, për letërsinë, krijimtarinë e poetëve dhe e shkrimtarëve dibranë, thotë Lutfi Hanku, shkrimtar. Ky panair është me vlera të jashtëzakonshme dhe pasqyrojnë atë kulturë, ato vlera që ka Dibra, të kohëve të hershme, të sotme dhe aludon edhe për të ardhmen e Dibrës dhe të të gjithë Atdheut", thekson shkrimtari Lutfi Hanku, i cili në këtë panair është pjesëmarrës me romanet "Marsi i vrarë", "Loti rebel" dhe monografinë për Heroin e Popullit Gjok Doçi.




"Ky panair është një ngjarje e shënuar për Dibrën edhe për të gjithë autorët. Këtu janë prezantuar një larmi botimesh, me larmi tematikash, njerëzish të afirmuar. Organizatorët kanë ditur të zhvillojnë një veprimtari shumë të bukur që i bën nder jo vetëm Peshkopisë por edhe gjithë Shqipërisë", thotë Faik xhani, studiues nga Mati. "Më vjen mirë që gjej një kryetar bashkie që u krijon ambient që përpiqet t'i ndjekë artistët dhe letrarët", tha ai.

"Na u dha rasti që në këtë 20-vjetor të Odës Dibrane të marrim pjesë në panairin e librit, i cili për herë të parë organizohet në Peshkopi, si simbolikë e bashkimit shpirtëror ndërmjet dy Dibrave, thotë poeti Nuri Koleci nga Dibra e Madhe. Kam marrë pjesë me disa tituj të librave në këtë panair dhe mbresat e mia janë të atilla që ka dashamirë të librave, të rinj të reja. Gjithashtu impresionuese është pjesëmarrja masive e autorëve dibranë".

Xhemal Domi, njëri nga autorët pjesëmarrës në këtë panair, duke folur për veprën e tij në tre vëllime "Dibra në hulli të historisë", thotë se ky libër është bazuar në traditat dibrane dhe dashuria e madhe për kulturë, për arsim, për dije dhe për atdhetari. "Këto gjëra jam munduar t'i pasqyroj në në këtë vëllim, dhe nga ata që e kanë lexuar është vlerësuar si një nga veprat më dinjitoze të botuara deri më sot".

"Për mua qe kënaqësi e madhe që në radhë të parë bëhet një aktivitet i tillë me sa di unë është i pari i këtij lloji dhe pjesëmarrja në këtë aktivitet si dibran më jep shumë kënaqësi njëlloj si gjithkujt tjetër në këto stenda, thotë Sadik Lala. "Unë personalisht jam me tre tituj në këtë panair, "Fjalori i psikologjisë, "Psikopatologjia" dhe një tekst tjetër mësimor që është "Psikiatria ligjore" që është në bashkëautorësi me një ish pedagogun tim të vjetër. Është kënaqësi kur vij gjithmonë në qytetin tim të lindjes. Është një kënaqësi shumë e veçantë, që përveç ndryshimeve që përcillen nga pikëpamja e jetës sociale dhe artistike, është edhe nostalgji për ditët ku ne kemi kaluar rininë tonë, ku jemi rritur. Ndaj edhe jam shumë i kënaqur që marr pjesë në këtë veprimtari. Gjëja që më kënaq më shumë në këtë panair është se shumë





# **Sukses** i panairit të parë të **librit** në **Peshkopi**

autorë dibranë janë në panteonin e botuesve dhe kjo është një gjë shumë e këndshme".

Në Panair ishin pjesëmarrës edhe poetët e rinj që sapo kanë filluar të botojnë krijimet e tyre. "Jam e lumtur që unë si shkrimtare e re dibrane po marr pjesë në një organizim që bëhet për herë të parë në Peshkopi dhe uroj që evenimente të tilla të organizohen çdo vit", thotë poetja Urime Straka.

### PREZANTOHET "EZOPI I DIBRËS"

Të premten pasdite, në sallën e bibliotekës, në praninë e miqve dhe bashkëpunëtorëve të Hazis Ndreut, u prezantua libri i studiuesit Xhezair Abazi, "Ezopi i Dibrës".

Prezantimi i librit u moderua nga Hysen Uka, një prej miqve të Hazisit, i cili theksoi rëndësinë e këtij promovimi në ditët e Odës Dibrane, për të cilën Hazisi dha gjithë kontributin e tij.

Për librin foli Dr. Gafur Muka, njëri nga konsulentët kryesore, i cili e ka ndihmuar studiuesin Xhezair Abazi ta shkruajë librin. Më pas foli edhe Prof. Adem Bunguri, i cili vlerësoi kontributin e Hazis Ndreut në lëmin e historisë dhe arkeologjisë.

Autori i librit, Xhezair Abazi, foli për librin dhe procesin e shkrimit të tij, duke vënë theksin se ajo që është shkruar në libër, është shumë më pak se sa ai do të donte të shkruante. "Unë kam në dorë disa dokumente të kohës, me anë të të cilit mund të bëhet një rivlerësim i figurës së Hazis Ndreut, duke na e sjellë atë në një përmasë të re, të panjohur më parë".

### SHKRIMTARËT DHE VENDLINDJA

Të shtunën më 24 tetor, në një nga sallat e pallatit të Kulturës u mbajt takimi me temë "Shkrimtari dhe vendlindja", ku në panel ishin të ftuar shkrimtarët Eqrem Basha, Agron Tufa dhe studiuesi Shaban Sinani".

"Do të doja t'ju shpreh ndjesën për mungesën në këtë panel të shkrimtarit të njohur nga Dibra e Madhe që jeton në Prishtinë, Eqerem Basha, i cili nuk u bë e mundur të jetë këtu për arsye familjare", tha Miranda Goleci, drejtuese e shtëpisë botuese M&B.

"Në këtë panair, tha ajo, janë të pranishëm studiuesi Shaban Sinani, i cili vjen bashkë me botuesit e tij, Raimonda dhe Naim Zoto, të cilët e kanë pritur këtë panair me shumë emocione. Shaban Sinan prezanton sot për herë të parë librin "Kodikët kronografikë të Shqipërisë", një vepër shumë të rëndësishme për kulturën tonë kombëtare"

"Në këtë panel, tha ajo, është edhe shkrimtari Agron Tufa, i cili ka qenë i angazhuar për këtë panair. Ai ka anulluar veprimtari shumë të rëndësishme të tij jashtë shtetit, duke ardhur sot në këtë takim, titulli i së cilës shpresojmë të bëhet traditë, mban idenë e tij.

Agroni vjen posaçërisht për këtë panair të parë të librit me botimin e tij të ri, "Nga hiri i të vdekurve", një libër me ese kulturologjike, botim që mban logon "M&B". Në këto ese shkrimtari trajton raportet e tij me fëmijërinë, vendlindjen, kulturën, traditën, ideologjinë, gjuhën, historinë dhe artin e të shkruarit.

Përmes stilit të tij ekspresiv, dinamik e sugjestiv, Tufa në këto ese bën një guidë meditative nëpër stacione të trazuara të së shkuarës dhe bashkëkohësisë dhe në sëmundjet e qytetërimit tonë', theksoi botuesja e librit, Miranda Goleci.



*Në foto: Agron Tufa, Rajmonda Zoto, Miranda Goleci dhe Shaban Sinani*

## MUSA RIÇKU: 100 LIBRA PËR SHKOLLËN E VENDLINDJES

**"Dua të ndaj me ju një lajm dhe falënderim të veçantë, tha gjatë takimit të së shtunës Miranda Goleci, drejtuese e botimeve M&B. "Bëhet fjalë për zotin Musa Riçku, një njeri që qëndron shumë pranë shkrimtarëve, duke i ndihmuar vazhdimisht ata për botimet e librave, por i cili prej më shumë se 20 vitesh është i angazhuar në mbështetjen e kulturës dibrane, veprimtarive për Dibrën, për Odën Dibrane dhe veçanërisht me mbështetjen pa kufi ndaj gazetës "Rruga e Arbërit".**


**Nisur nga suksesi i këtij panairi, Musai ka vendosur blerjen e një sasie të konsiderueshme librash, mbi 100, të cilat do t'i shkojnë si dhuratë nxënësve dhe mësuesve të shkollës 9-vjeçare të Limjanit, vendlindjes se tij."**

**"Vlen të ritheksoj, tha ajo, se në këtë edicion të parë të panairit janë të ekspozuara mbi 100 autorë dhe mbi 300 tituj librash, të cilat do të ishin një pasuri e madhe për çdo bibliotekë publike apo shkolle. Shembulli i Musait është një veprim që jo vetëm duhet falënderuar, por është një shembull që duhet ndjekur. Nxënësit tanë përpara se të lexojnë letërsi të huaj të përkthyer, së pari duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm me letërsinë që buron nga vendlindja e tyre".**



*Musa Riçku duke ndjekur veprimtaritë për librin në Panairin e Peshkopisë*





*Dy botimet e reja, prezantuar për herë të parë në Panairin e Librit në Peshkopi, "Kodikët ikonografikë të Shqipërisë" - Botimet Naimi dhe "Nga hiri i të vdekurve" - Botimet M&B*



***Pas takimit, një autograf...***



Prof. Shaban Sinani foli për lidhjet e dukshme dhe të padukshme të krijimtarisë së tij me vendlindjen, për gjurmët e saj në formimin e tij, për fillimet e pranisë së në jetën publike dhe vështirësitë në këtë proces, për ndikimin e shkollës dhe të mësuesve në nxitjen dhe edukimin e të shkruarit. Ai pohoi se vendlindja mbetej gjithnjë një përgjegjësi e madhe në projektet e tij krijuese e studimore.

Ndërsa Agron Tufa foli për ndikimin që ka pasur Dibra në krijimtarinë e tij artistike, veçmas në poezi. Ai foli për censurën që ka qenë ushtruar mbi poezitë e para, të cilat megjithëse pranoheshin për botim, nuk u botuan. Vendlindja, tha Agroni, pavarësisht se nuk e shprehim në mënyrë të drejtëpërdejtë, gjenden në çdo cep të krijimtarisë dhe është e pashmangshme. Më pas ai foli për lidhjet e tij me leximin, përvojën personale që ka ndarë mes bibliotekës së qytetit dhe galerisë në minierë, për marrëdhëniet e tij me zyrtarët e kohës, etj..

Në takim ishte i ftuar dhe përshëndeti z. Naim Zoto, president i shtëpisë botuese Naimi, si një prej shtëpive botuese që ka treguar vëmendje e dashamirësi ndaj autorëve dhe veprave për Dibrën.

Në fund të takimit, nxënësja e klasës së dytë në shkollën e Burimit, Rezarta Gjeleshi i dhuroi një tufë me lule studiuesit Prof. Shaban Sinani, ndërsa Jonida Spahiu, nxënëse në klasën e 11 në Gjimnazin e Maqellarës recitoi një poezi të Agron Tufës nga vëllimi "Frymë mbi ujëra".

Më pas, Sinani dhe Tufa firmosën autografe për lexuesit si dhe u takuan dhe shkëmbyen përshëndetje me miq dhe lexues.

***Korresp. "Rruga e Arbërit"***

Flet Bujar Karoshi:

panairi i librit

# Ta bëjmë **librin** pjesë të pandarë të **Odës**!

*- Si lindi ideja e këtij panairi?*

- Janë disa arsye që na çuan në idenë e realizimit të panairit të parë të librit në Peshkopi.

Së pari, panairi i librit u mendua në kuadrin e Odës Dibrane. Oda sivjet mbush 20 vjet dhe libri, megjithëse ka munguar prej kohësh, tradicionalisht ka qenë një pjesë e saj.

Së dyti, në punën time të përditshme me shkrimtarë, poetë, studiues, një pjesë e madhe e të cilëve janë dibrane ose me origjinë nga Dibra, ndjeja mungesën e një kontakti të drejtpërdrejtë të autorëve me lexuesit.

Nëpërmjet gazetës "Rruga e Arbërit" jemi përpjekur vazhdimisht ta ndërtojmë këtë urë komunikimi, por një kontakt i gjallë në një panair libri është i pazëvendësueshëm.

Në këtë kuptim, në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Peshkopisë menduam hapjen e një panairi të librave të autorëve dibranë dhe të botimeve mbi Dibrën. Në fakt, dëshira është që në vitet e ardhshme kjo të zgjerohet dhe të bëhet një panair i përvitshëm, por sivjet u mendua kështu për shkak edhe të eksperiencës së munguar, përvojës së parë, si dhe për të parë se si pritet libri.

Ne në fillim mendonim se do të merrnin pjesë dy-tre shtëpi botuese, por jemi të surprizuar nga bashkëpunimi që kanë ofruar shtëpi të tjera botuese dhe veçanërisht autorët, duke bërë të mundur që në këtë stendë modeste të paraqiten mbi 100 autorë dibranë dhe jo dibranë, që kanë shkruar për Dibrën dhe më gjerë, dhe janë botuar nga 57 shtëpi botuese. Kjo do të thotë se është një iniciativë e përkrahur dhe e mbështetur dhe shpresojmë që do të ketë edhe mbështetjen e lexuesve dhe banorëve të Peshkopisë dhe të Dibrës.

Me këtë rast dua të falënderoj gjithë autorët pjesëmarrës në këtë stende të librit, pa ndihmën e të cilëve ky panair nuk do të realizohej dot. Gjithashtu, një meritë të madhe që kjo stendë të jetë kaq simpatike dhe e organizuar bukur ka edhe pronarët e librarisë "Fleta XXI" në Peshkopi, Besa dhe Hysen Uka, të cilët kanë punuar pa u lodhur që ky panair të kishte sukses.

*- Shtëpia juaj Botuese ka qenë për vite me radhë një ndër sponsorët modestë të Odës Dibrane. Ç'mund të na thoni për këtë?*

- Ne nuk e kemi konsideruar dhe nuk e konsiderojmë Odën Dibrane si veprimtari të një personi apo të një institucioni. Oda është një veprimtari që na takon të gjithëve dhe gjithkush duhet të kontribuojë sadopak. Që nga viti 2008 jemi munduar ta mbështesim me iniciativa të vogla, kryesisht me materialet të cilat ne i promovojmë dhe i botojmë vetë. Oda Dibrane ka nevojë për ndihmën e të gjithëve, çdo biznesmeni, çdo aktori, çdo kulturologu, çdo shkrimtari, çdo artisti për t'u bërë një odë që jo vetëm rritet dhe vërtitet rreth Dibrës së Madhe dhe Peshkopisë, por për të qenë mbarëkombëtare.

Oda Dibrane e ka fituar statusin e një festivali mbarëkombëtar dhe për ta mbajtur gjallë atë dhe për ta vazhduar në standarde të larta kërkohet kontributi dhe ndihma e të gjithëve. Ndihma jonë është shumë e vogël dhe e papërfillshme në krahasim me ndihmën që japin të tjerët.



*- A do të jeni në vijimësi me panairin e librit në edicionet e tjera të Odës Dibrane?*

- Ka disa vite që ne e mendojmë vendosjen e panairit të librit si pjesë të Odës Dibrane. Deri më tani kemi informacione se ajo po pritet shumë mirë, kështu që unë shpresoj se kjo do të jetë vazhdimisht, por ajo që shpresoj unë është se nga 57 shtëpi botuese në këtë sallë nuk do të jemi vetëm ne, por kjo sallë do jetë e mbushur plot me libra të të gjitha zhanreve, të të gjitha kategorive jo vetëm për Dibrën, por libra mbarëkombëtarë, për shkencën, për fëmijët, për kulturën, për letërsinë, për artin. Pra të jetë një Panair i Librit i Dibrës, siç janë panairet e ngjashme në Shkup, Tetovë, Ulqin, Vlorë, Fier, Prishtinë, Prizren, etj.




*- Ju jeni në kontakt të vazhdueshëm me krijuesit dibranë. Në raport mes krijuesve dhe Dibrës, çfarë mendoni se mund të përmirësohet?*

Kam vënë re me kënaqësi se nga Dibra sot janë një numër i madh krijuesish shkrimtarësh dhe artistësh, të cilët japin një ndihmesë të madhe në kulturën kombëtare, por janë pak të njohur apo të lexuar në vendlindjen e tyre. P.sh. mund të përmendim studiuesin Shaban Sinani, shkrimtarin dhe poetin Agron Tufa, shkrimtarët Eqrem Basha, Ramiz Gjini, Naim Berisha, Lutfi Hanku, studiuesin e kulturës dibrane Xhafer Martini, arkeologun Adem Bunguri e Iljaz Kaca, historianët Moisi Murra e Gafur Zota, dhe shumë të tjerë, të cilët me botimet e tyre e kanë ngjitur vetën në majat më të lartë të kulturës shqiptare.

**Panairi i librit u mendua në kuadrin e Odës Dibrane, në kuadrin e 20-vjetorit të saj. Gjatë kontakteve të shpeshta me shkrimtarë, poetë, studiues, një pjesë e madhe e të cilëve janë dibrane ose me origjinë nga Dibra, ndjeja mungesën e një kontakti të drejtpërdrejtë të autorëve me lexuesit. Shpresojmë dhe besojmë se kjo do të kthehet në traditë dhe në vitet e ardhshme pallati i kulturës të mbushet plot me libra, nga të gjitha gjinitë.**



Por, ajo që kam vënë re është së brezi i ri që nuk e ka humbur akoma dashurinë për librin, nuk i njeh këta autorë dhe shumë pak prej tyre janë të lexuar. Shkollave tona u mungojnë librat e tyre dhe nxënësit nuk kanë mundësi të jenë në kontakt me to. P.sh., nuk është aspak e pëlqyeshme për një student që shkon te studiojë për letërsi shqipe dhe kur takon pedagogun Agron Tufa, nuk i ka lexuar asnjë libër dhe ndjehet keq. Janë një plejadë studentësh që studiojnë në fusha të ndryshme, dhe kur ballafaqohen me pedagogët e tyre e shikojnë se nga Dibra ka shumë autorë, shkrimtarë dhe studiues që kanë bërë emër në fushat përkatëse. Dhe atëherë kuptojnë dhe u vjen keq, që gjithë këtë trashëgimni kulturore të vlefshme nuk e njohin.

Kështu që, edhe njëra nga synimet e panairit ishte njohja e këtyre personaliteteve kulturore me rang kombëtar. Madje takimi "Shkrimtari dhe vendlindja", që është programuar për këtë panair, njërin nga synimet është që t'i sjellim disa prej këtyre personaliteteve në një kontakt të drejtëpdrejtë me lexuesit.

*- Pse mendoni se ky kontakt është i ndërprerë?*

- Për shumë shkaqe, por së pari për mungesë vizioni. Ndërsa institucionet kanë menduar një lëndë të hapur lokale, që është historia, nuk kanë menduar për një lëndë tjetër, që mund të quhej p.sh. "Kultura e vendlindjes". Përpara se të njohim vendet historike, luftërat për liri e pavarësi, mendoj se është e vlefshme të njohim formimin kulturor.

Kjo do ti ndihmonte nxënësit dhe studentët në kërkime të tjera në të gjitha shkencat, duke krijuar më shumë hapësira studimi e kërkimi për studiuesit e rinj.

*- A mendoni se rivendosja e këtij kontakti do shumë kohë dhe përpjekje?*

- Nuk mendoj ashtu. Mendoj se për gjerat që konsiderohen të mëdha, mund tia nisim nga gjërat e vogla. Dhe ky panair është njëri prej tyre.

Gjithashtu, duhet të theksoj se në qoftë se çështjet shihen me dashuri, gjenden edhe zgjidhje. Me këtë rast, unë dua të vë në dukje rastin e zotit Musa Riçku, i cili i nxitur nga kjo veprimtari, ka blerë një sasi të konsiderueshme librash dhe do t'ia bëjë dhuratë shkollës së tij të vendlindjes, Limjanit. Janë mbi 100 libra, të gjitha të vlefshme për nxënësit dhe mësuesi, jo vetëm për përgatitjen e tyre sipas programeve të Ministrisë së Arsimit, por edhe për lexime jashtë klase. Botimet më të mira nga Shaban Sinani, Agron Tufa, Ramiz Gjini, Xhafer Martini, Naim Berisha, Lutfi Hanku, Arian Kadiu dhe shumë të tjerë do të bëhen pjesë e bibliotekës së shkollës.

*Bisedoi*: **NEKI FETA**




*Në foto: Bujar Karoshi, Shaban Sinani, Naim Zoto,*




*Grehansi dhe Redoni, dy të palodhurit në prapaskenë të Panairit*

Rruga e Arbërit nr. 102

botim i ri

Optika e qartë që ka përdorur autori në trajtimin e tërë asaj game problemesh që rroken për t'u dhënë një zgjidhje sa më bindëse si dhe qartësimin e asaj rruge të vështirë që kaloi Cereni e Kalaja e Dodës për të ruajtur identitetin e vet  nëpër rrjedhat e historisë.

# Promovohet libri "**CERENI**" i dr. Shefqet Domi

*Nga* **JAHE DELIA (SELMANI)**




Muaji tetor nuk është vetëm muaji vendimtar për të mbushur më bereqetin e shumëpritur hambarët për dimër, por dhe muaji më i frutshëm për të pasuruar më shumë thesarin kulturor të kombit tonë. Shumë e shumë vepra e veprimtari të të gjitha llojeve në kryeqytet e në rrethe plotësojnë me tej dëshirat e interesat e lexuesve dhe të artdashësve. Një e tillë u zhvillua me datën 19 tetor 2014 në sallën ``Unesko`` të Muzeut Historik Kombëtar si për t`i bërë jehonë dhe vitit të 70- Vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Si rrallëherë salla u zbardh nga kësulat e banorëve të Cerenit e te Kalasë së Dodës, që merrnin pjesë në promovimin e librit të fundit të bashkëfshatarit të nderuar të tyre e mjekut që vijon t'u shërbejë dhe në dekadën e 70-të në këtë detyrë humane, z. Shefqet Domi.

Në këtë promovim salla e madhe ishte e mbushur jo vetëm më cerenas e kaladodas, por dhe me intelektualë të të gjitha fushave nga Luma, Dibra e mbarë vendi, se doktorin e nderuar e njohin të gjithë, se ai u ka shërbyer e vijon t'u shërbejë të gjithve edhe sot në këtë moshë të cilën ai vijon ta sfidojë me energjitë e tij krijuese e shëndetin për ta pasur zili. Moderatori e gazetari i mirënjohur  Defrim Methasani e sfidon atë gjendje aq stresuese që i shkaktoi pabesia e Beogradit ku ishte gazetar e shoqërues, e sfidon dhe lodhjen që i shkaktuan vajtje-ardhjet e shpeshta në Bulqizën që, pas mërzisë së Beogradit, ktheu buzëqeshjen në zemrat e gjithë shqiptarve. Dhe gëzimi ishte i ligjshëm, se, bijtë e Ketës së Bulqizës, Dibrës e Shqipërisë, me gjerdanët Kampion Bote po tregojnë se ç'janë shqiptarët.Dhe nuk përtoi ta transmetonte talentin dhe në drejtimin e këtij aktiviteti mbresëlënës.

Për vlerat e librit foli fillimisht studiuesi i mirënjohur dhe redaktor i librit, dr.Fejzulla Gjabri. Ai vuri në dukje atë optikë të qartë që ka përdorur autori në trajtimin e tërë asaj game problemesh që rroken për t'u dhënë një zgjidhje sa më bindëse si dhe qartësimin e asaj rruge të vështirë që kaloi Cereni e Kalaja e Dodës për të ruajtur identitetin e vet  nëpër rrjedhat e historisë.

-Në procesin e ndryshimeve të kulturës,- thekson z. Fejzullai,- ka rëndësi të madhe ndjeshmëria, aftësia seleksionuese për të përthithur çdo gjë nga e kaluara, për të arkivuar e mënjanuar ato gjëra që u ka ikur koha, për të modifikuar të tjerat që t'u përqasen kushteve të reja shoqërore.

Pas vlerësimeve të tjera të merituara, redaktori shpalos dhe mesazhin kryesor që transmeton libri e që e formulon"Njeriu, toka që prek nën këmbë, siguria, forca, krenaria, janë identiteti që nuk duhet nënvlerësuar." Dhe këtë identitet cerenasit kanë ditur ta ruajnë si të shenjtë, ashtu siç e ruajtën të gjithë shqiptarët.

Prof. Dr. Shefqet Hoxha, që aq shumë i ka dhënë kulturës e historisë, jo vetëm të Lumës, e që na kënaqi aq shumë dhe me atë punë të madhe në kodifikimin e të drejtës zakonore të Lumës, foli me pasionin e një shkencëtari të mirëfilltë për vlerat e librit, vlera që lidhen pazgjidhshmërisht me atë punë të gjatë kërkimore të autorit për të zhbiruar në detajet më të imta e ineresante të Cerenit e Kalasë së Dodës. "Bashkësitë ( të përbashkëtat,J.D.) mes fshatrave,-thekson profesori,- janë të shumta, dallimet, të pakta."

Prof, Shefqeti ndalet jo pak te jeta vetëm me punë mjaft të dobishme e të palodhshme që ka kaluar autori i librit e që e ilustron dhe me ato që thotë aq qartë dokumentari i marrë nga arkivat e RTVSH që pasqyron punën kërkimore-shkencore të dr.Shefqetit në vitin 1982, kur themeloi Laboratorin kimik-biokimik  në spitalin e Peshkopisë dhe realizonte 88 mijë analiza në vit.  Gjithmonë në ballë të punës shkencore e në të kualifikimit të kuadrove të rinj kudo  ku punoi.

-Ky burrë i urtë, -theksoi më pas,- kurrë nuk e shkon kohën nëpër kafene, por vetëm në punë e është shembull për të rinjtë. Për lëvizjet e popullsisë si temë jo shumë e lëvruar, ai shpreh dhe rezervat e veta kur është fjala për ardhjen e disa fiseve nga Horosani, se ato mbeten akoma në kuadrin e legjendës.

Intelektuali cerenas, Metush Skeja falenderon bashkëfshatarin e tij që kurrë nuk e harron vendlindjen dhe bëhet shembull dhe për të tjerët për të bërë sa më shumë për të. Ai mbështet të dhënat e autorit për lashtësinë dhe origjinën e Cerenit duke dhënë dhe mendime shtesë mbështetur në fakte kur përmend se ky fshat është në moshë 2000-vjeçare, se tumat e gjetura e toponimet me origjinë të lashtë janë argumente mbështetëse për këto që thuhen, se ujësjellësi i Cerenit është i moshës 500-vjeçare etj. Duke folur për Cerenin si një fshat për shumë kohë qendër për Kalanë e Dodës, jep dhe të dhëna e fakte për pjesëmarrjen e këtyre banorëv në të gjitha ato ngjarjë që bënë epokë për kombin e krahinën si: Lidhja e Prizrenit, Kryengritja kundër Dervish Pashës, kundër Turgut Pashës e deri te kontributi në LNÇ.

Ai prek edhe atë urrejtje herë të mbyllur e herë të shfaqur që treguan fshatarët e Cerenit kundër regjimit monist që shkonte deri në mohimin e plotë apo mospraktikimin e luftës së klasave. Nuk harron të futet dhe në detaje të tjera që kanë të bëjnë me cilësitë e veçanta morale e sociopsikologjike të këtyre banorëve. Një surprizë për këtë tubim ishtë përshëndetja e mbesës së dr. Shefqetit, Shpresa Krasniqi, lindur e rritur në Prizrenin e historisë. –Ishim aq afër e nuk mund të vinim te njërëzit tanë, nëna shpesh derdhte lot malli, kurse tani vij për dy orë e çmallem me njerëzit e mi, me dajat, me Shqipërinë që e ëndërronim aq shumë. Dhe, duke kapërcyer momente emocioni, shton:" E lexova me shumë dashuri e mall të madh librin e dajës tim, edhe po të kisha jetuar gjithë jetën në Ceren, nuk do të mësoja më shumë për fshatin nga ku nëna u largua që në moshën 15-vjeçare."

Pedagogu shumë i nderuar i UT, prof. Dritan Spahiu, pasardhës i familjes Spahia të Lumës që bëri emër në histori, merr fjalën dhe përshëndet dhe në emër të Shoqatës Atdhetare e Kulturore "Luma". Mjaft lakonik e i qartë në shprehje, ai vlerëson punën e bërë nga autori në evidentimin e jetës së këtij fshati të nderuar të Kalasë së Dodës që, mbi të gjitha, diti të ruajë e trashëgojë gjithçka të mirë në shekuj, duke u përmendur për identitetin kombëtar.- Dashuria e jashtëzakonshme që autori shfaq në libër për vendlindjen, - theksoi profesori,-duhet të jetë një shtyse për brezat e rinj e model se si duhet të punojmë për të evidentuar e ruajtur traditat, zakonet, kulturën. Dhe Defrimi i jep fjalën një bije nga Puka, është mësuesja Elida Koxheri, që me fjalë zemra e të thjeshta shpreh respektin e madh që ka krijuar për doktor Shefqetin si njeri, si intelektual e studiues. Ajo numëron një varg arsyesh për ta lexuar këtë libër për ato vlera që shfaq në shumanshmëri. Përmes librave të autorit ajo e ka njohur Cerenin. Ka redaktuar pjesën e parë të librit të ardhshëm të doktorit dhe e falenderon për eksperiencën e fituar nga ai kur me fjalë prekëse shton:" Më dha një bllok të kuq, të vjetër, por të ruajtur me kujdes të madh. Brenda tij, fletët e zverdhura të shkruara herë me stilograf e herë me stilolaps, më lanë mbresa të veçanta. Nuk i ndieja orët e kaluara para kompjuterit duke i redaktuar shënimet e tij. Kjo, për faktin se isha rrëmbyer në lumin e kujtimeve të tij..."

Dhe, si për ta plotësuar më mirë gjeografinë e diskutimeve, në podium ngjitet avokati Agron Gjedia, njëkohësisht dhe kryetar i Shoqatës "Bytyçi". Është një admirues e vlerësues i punës së palodhur të doktorit dhe përmes librit ka krijuar njohje e respekt për Cerenin e Kalanë e Dodës. Dhe pse nga një zonë larg Kalasë së Dodës, ai nuk sheh shumë dallime, por vlerëson ato tradita të përbashkta që e bëjnë "një" këtë komb. Nuk e fsheh dëshirën që doktori të shpallet"Qytetar nderi i Kalasë së Dodës". Dhe ka të drejtë avokati. Nipi i dr.Shefqetit, Tajari, një intelektual shumë i respektuar jo vetëm i Cerenit, por dhe i Kalasë, përshëndet nga Filadelfia, ku jeton e punon me familje. Falënderon xhaxhain e tij për librin, falënderon pjesëmarrësit në sallë, shpreh dhe emocionet që janë të ligjshme për këtë rast e që dalin origjinale nga goja plot muzikalitet e Dodonës që i lexon në podium. Dhe lisat Shekullorë, ata që hijeshuan e nderuan historinë dje e të tillë qëndrojnë dhe sot, janë lënë për fund.Fjala e tyre ngjit si me magji në këtë ditë. Ngjitet në podium një burrë që ec afër shekullit, por plot energji e jetë: Është prof. Ibrahim Hoxha, që nuk e ndan penën nga dora për të shkruar për historinë e Çamërisë martire ashtu si nuk e ndau pushkën nga dora dje në rreshtat partizane. Shok i autorit, bashkëpunëtor në punën intelektuale, redaktor i librit të parë bashkë me të shoqen, bijë Dibre, Mynever. Ky bir i patriotit çam Daut Hoxha, që grekët ia shëtiten kokën e prerë nëpër Çamëri, ka shumë për të thënë për të tjerët, për vlerat e librit, por kurrë nuk mburret. –Veprat e mëdha fillojnë nga gjërat e vogla, ashtu si kalaja ndërtohet nga gurët për t'u bërë e pamposhtur,- aludon duke përfunduar fjalën e shkurtër përshëndetëse profesori që sfidon moshën.

Dhe nga tribuna përshëndet gjenerali i përjetshëm, lumjani me nam në tri epoka, lavdia e gjallë e Lumës, Rrahman Parllaku. Sa shumë energji ruan ky trup afroshekullor, sa shumë besim shperndajnë sytë e tij e sa kthjelltësi rrezaton mendja e tij! Këta burra dinë ç'thonë e fjala kurrë nuk u shkon dëm, ajo zë vend te çdo brez. Dhe vlerësimi për punën e autorit e porosia për t'u transmetuar brezave traditat më të mira nën shembullin e librit, janë fjalët e fundit të gjeneralit legjendë.  Dhe autori duhet të thotë fjalën e fundit, se për të u mbush kjo sallë. Ai i ka të përgatitura në fletë ato që do të thotë, por nuk flet.- Nuk di të flas pas atyre që thatë për mua, vetëm ju falënderoj me zemër,- dhe përsërit tri herë këtë fjalë magjike që, për shqiptarin, është mirënjohja më e madhe. Aktivitetin e kësaj dite të shenuar për autorin e pjesëmarrësit e bënë më të këndshëm dy zëra të bukur që na bënë të jetojmë magjinë e këngës së dikurshmë dibranë që ka vite që nuk di ku është fshehur.

Them kështu, se komercializmi po ia merr frymën edhe muzikës së bukur dibrane në këtë kohë të globalizimit të përgjithshëm ku, e para që duhet shpëtuar, është muzika, kënga vallja. Jo se janë të parëndësishme të tjerat si: gjuha e traditat e tjera, por muzika po çorienton shijet e një brezi të tërë në shoqërinë e sotme shqiptare e pashqetësuar nga shteti e shoqëria.

Këngëtarja e madhe dibrane, Saihe Poleshi na e kujtoi këngën e bukur dibrane si njëherë e njëkohë. Me të ishte dhe një zë i veçantë e original që nuk i nxjerr këmbët nga tabani, Arif Madana nga Radomira. Ai po ia ngre vlerat folklorit të Kalasë e më gjërë. Kronikën e kësaj dite ndofta do ta mbyllte më mirë lutja përgjëruese e autorit në fillim të librit të tij: -O njerëz të gjallë të Cerenit! Ngado që të shkoni, mos e harroni dheun ku lindët, u ushqyet,u rritët dhe sot po lëvizni në të gjitha anët e botës! Mjerë shpirtrat e varfër që të harrojnë, o Ceren i bukur!

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

recensë

- Rreth romanit me të njëjtin titull, të shkrimtarit Arian Kadiu -

# Kur dremiste Sahati i Tiranës


*Nga* **BESNIK RAMA***

Shkrimtari i njohur, prof. dr. Arian Kadiu, kësaj radhe vjen para lexuesve me romanin "Kur dremiste Sahati i Tiranës". Ky nuk është i pari libër i autorit, as romani i parë i tij. "Kur dremiste Sahati i Tiranës" është libri i parë për të rritur i A. Kadiut, pasi shkrimtari ka lëvruar në fushën e letërsisë për fëmijë, kryesisht në prozë, që u drejtohet moshave shkollore. 30 romane, vëllime me tregime e novela dhe disa monografi, të shkruara vitet e fundit, produkt i studimeve dhe hulumtimeve shumëvjeçare, kanë për audiencë edhe moshat e rritura, sidomos në didaktikë. Disa nga krijimet dhe librat e autorit janë përfshirë në tekste shkollore, në listën rekomanduese të miratuar nga MASh-i për leximet jashtë klase dhe për kualifikimin e mësuesve. Gjithashtu, para disa vitesh, A. Kadiu botoi romanin "Pas takimit me alienët", që u prit mjaft mirë nga shkollarët, dhe është një nga romanet më të mira të kësaj gjinie për adoleshentët.

Të mësuar ta shohim vetëm në profilin e krijuesit për fëmijë, romani "Kur dremiste Sahati i Tiranës" është, në një farë mënyre, një befasi, jo aq për faktin që autori vjen "i vonuar", por për temën që trajton dhe për mënyrën e rrëfimit të ngjarjeve, për skalitjen e personazheve, për skenat ku ndodhin ngjarjet dhe ku veprojnë personazhet, të cilat na rrëmbejnë faqe pas faqeje, na marrin me vete në vorbullën e befasive që i ngjan një labirinti me shumë hyrje, por pa një rrugëdalje optimiste.

Mendoj se romani i ri do të pritet me interes nga moshat e rritura, të cilave u drejtohet. Shkrimtari ka reflektuar nga një botë postkomuniste, me personazhe që nënshtrohen lehtë dhe me të tjerë, të cilëve jeta u është bërë Ferr, ngaqë ata janë të papërgatitur për situata e dukuri aq të vrullshme, ku imoralja mbyt moralen, e padrejta shtyp të drejtën, e pabesa sundon mbi besën, paraja zë për gryke njeriun e ndershëm. Në roman gjen Tomin, njeri i dallavereve dhe trafikant tipik i mishit të bardhë, që, kudo që hedh grepin, e zë gjahun dhe bën si t'ia dojë interesi i tij, por gjen dhe politikanë me pushtet të përlyer thellë në korrupsion dhe frekuentues të shtëpive publike ilegale, njerëz që u kanë zënë perde syri dhe zemra, njerëz që mund të shërohen vetëm nëse nga zemrat e helmatisura shkulen gjarpërinjtë, njerëz që hiqen sikur burojnë mirësi dhe besojnë në Zot, duke tradhtuar pas krahëve me Djallin.

Romanin e përshkojnë dëshpërimi e pikëllimi, tipike për ato vite në të cilat janë vendosur ngjarjet, ku edhe dhembja trembej nga lakuriqësia e realitetit që ofrohej, ku edhe mitologjia vyshkej nga ajo gjendje pa krye. Ka një çekuilibër që ushqehet e kapardiset me klane, me fise, me njerëz imoralë "të nderuar", që erdhën me brekë të grisur dhe të shkelnin me majat e këpucëve, që erdhën me një pare në xhep, po më pas lundruan e lundrojnë në pasuri të grabitura e në tregti të pandershme. Është një roman ku jepet realiteti i një jete të përçudnuar, ku mjerimi është ulur këmbëkryq dhe pasuritë e




**Me gjithë kujdesin që ka treguar, nuk ka mundur të mbetet jashtë qëndrimeve të tij për ndodhitë e ngjarjet që përshkruan. Ai, qoftë në skalitjen e personazheve, qoftë në rrëfimin e episodeve, me fjalorin e përzgjedhur na jep dhe opinionin e vet, se s'ka se si të shkëputet nga rryma, nga jeta reale rreth tij dhe rreth nesh.**

pista drejtojnë shtetin.

Romani ka një strukturë të goditur, me një arkitekturë të ndërtuar mjeshtërisht me kujdes. Heronjtë sikur dalin nga ngjarje groteske të pabesueshme (gruaja që ka gëlltitur në bark dy fëmijët e saj), nga fluiditete të flashkëta realiteti, me një protestë që nuk shpërthen, nga kontraste si vetë jeta në metropol e në periferi të tij (djali i Balës i sëmurë – djali i Netës përdorues droge; Tomi trafikant – Delua, Luli, Rita e plot të tjerë me ëndrra të pastra rinore për të krijuar familje; Ana e zgjuar dhe e rrahur nga jeta – Bala naive dhe fatkeqe; pylli që "shpyllëzohet" për firmën e huaj e xhepin e drejtorit dhe punëtori që pushohet nga puna dhe lihet në rrugë etj.). Në roman takon edhe personazhe karikatureske, që ëndërrojnë drejtësi, kur kandari i saj ka zënë ndryshk. Vepra na njeh me ngjarje e personazhe të ditëve tona. Është një roman që të fut në një botë rrejshëm të ndriçuar, që lëkundet rreth teje, dhe vetja të duket edhe si personazh.

Personazhet e romanit e dinë nga vijnë dhe cilët kanë qenë, dinë ku janë dhe cilët janë, por nuk i japin hall çfarë bëjnë e çfarë bëhet me ta. Disa nga personazhet kanë lidhje intime, disa janë në kërkim të lidhjeve intime, disa personazhe u tremben këtyre lidhjeve; disa personazhe i zhgënjejnë ëndrrat, megjithatë, përsëri ëndërrojnë, shpresojnë, por, për momentin janë pa shpresë dhe i nënshtrohen fatit. Balja bëhet me aq parfume sa mund të hapë një dyqan, ajo ka aq bizhuteri të florinjta, sa nuk do t'i mjaftojë jeta sikur secilin ta mbajë gjashtë muaj, por, kur e kupton se ku e ka zhytur fati dhe, kur zbraz dufin mbi ata të cilëve u zbulohet maska, i fiket jeta. Dhe nga kush? Nga i vëllai. Ajo është viktimë e vetes, por edhe e vëllait të saj, e burrit të saj, e djalit të saj, e shoqërisë, e shoqërisë që përjeton tragjedi edhe më të mëdha se kjo e Balës dhe e njerëzve të saj (mbytja e skafit me klandestinë, shpyllëzimet etj., etj.), sepse, siç shprehet autori, "*Askushi u bë ministër, Asgjëja u bë deputet, Askërkushi u bë biznesmen, Asgjësendi u bë i njohur.*"

Nuk mund të mos vë në dukje edhe gjuhën e përdorur nga autori. Është një gjuhë e punuar, e pasur me figuracion të ri dhe me një vëmendje të posaçme për qëmtimin dhe përdorimin e fjalëve të vjetra që ruhen në thesarin popullor (*namuzlie, birian, veremli, çilte* për *çelte; pareli, deshte* për *donte; kamatruc, hasha, dacëlloj, cicka, tallagjare, zatekem, dromcoj, milet, turisëz*, *çvoshk, dingaz, kuplara, açik, batakçi, i qorollepsur, qenef, kacafiu, çaprallis, tollovi, biçim, lizgatem, ofkëlloj, llomishte* etj.), si dhe të fjalëve të përbëra e të përngjitura që, në fjali e fraza të shumta, marrin vlera stilistike dhe emocionale, cilësojnë, etiketojnë, karakterizojnë dhe vlerësojnë personazhe e skena me episode nga jeta e gjallë. Figuracioni i pasur në roman është shprehje e pjekurisë artistike të shkrimtarit A. Kadiu, e mjeshtërisë dhe e origjinalitetit krijues të tij: *celulari tringëlloi si një zog i zënë në grackë (i Balës); pa një infermiere të re, të cilës bluza e bardhë i këndonte në trup (Tomi); kusitë e zemërimit të zienin përsëri; lodërtari "ecën me një ngadalësi si një ari i ngathët, gjithsesi madhështor, por pa hiret e zakonshme dhe me një hutim të përgjithshëm"; qosteku me sahatin roskop u burgos në raftet më të thella; Ka qenë derë e madhe, hanedane; të prish zemrekun e jetës; si një shtrazë qelbi helmatisës; të mbulohej me dafina fitoreje; këngë e ngopur me pika adoleshente shiu; Qielli është i rënë, i mërzitur, mbështetur me keqardhje me bërryla mbi malet e zymta të pushtuara nga hija e tij* etj.

Shkrimtari, me gjithë kujdesin që ka treguar, nuk ka mundur të mbetet jashtë qëndrimeve të tij për ndodhitë e ngjarjet që përshkruan. Ai, qoftë në skalitjen e personazheve, qoftë në rrëfimin e episodeve, me fjalorin e përzgjedhur na jep dhe opinionin e vet, se s'ka se si të shkëputet nga rryma, nga jeta reale rreth tij dhe rreth nesh. Me njëfarë pesimizmi, autori shkruan: "*Nuk donte ta besonte kurrë se e ardhmja kishte dalë në mes të rrugës açik, por ishte më anemike se e tashmja. Çfarë do të sjellë ajo më tepër? Gjithnjë lëviz me një kadencë të pagabueshme. Ishte atje, tani është këtu, por shpesh e më shpesh nuk e dimë se ku është. Në këtë univers është e vështirë të dallosh të tashmen nga e ardhmja e, sido që gjendja zgjat, ajo realizohet me një kadencë padukshmërie, gjersa nga kjo pakicë bëhet një blanë e madhe, mavi, që të dhemb.*"

Stili i zhdërvjelltë, dialogët domethënës, fjala e kursyer, skalitja si me daltë e personazheve, do të bëjnë që romani të përpihet nga lexuesit, të cilët do të njihen me një mori episodesh, pse jo, ata do të ndiejnë se, me dashje apo pa dashje, janë, ku më pak e ku më shumë, aktorë të një a disa skenave ku luhen episodet e romanit.

** Doktor i shkencave*



## Xhelal Marku, "Qytetar Nderi" i Reçit

Komuna Reç në Dibër, më datë 24 tetor 2014, në votim unanim të Këshillit të Komunës, ka shpallur birin e Reçit, gazetarin e shkrimtarin Xhelal Marku "Qytetar Nderi". Gazetari dhe telekronisti i Radio Televizionit Shqiptar për gati 25 vite mban dhe akordimin nga RTSH-ja urdhrin "Naim Frashëri" në vitin 1988 si dhe titullin "Mirënjohja e Mirditës" dhënë nga Bashkia Rrëshen në vitin 2009.


Kronika televizive, telereportazhe, dokumentare televizive janë të shumtë që mbajnë firmën dhe talentin e Xhelalit, por një eveniment i rëndësishëm është dhe botimi i librit "Turizmi shqiptar" i pari në llojin e vet në botimet në Shqipëri, me redaktor gazetarin e njohur Albert Zholi.

Gazetari Xhelal Marku është "Nderi i Reçit" por dhe nderi i Dibrës, Rrëshenit ku disa vite ka punuar e banuar por edhe një emër i nderuar dhe respektuar në gazetarinë shqiptare në atë vizive dhe të shkruar.

*Ilmi Dervishi*

Eja në Botën e Ngjyrave
"ZAYA STUDIO"
nën kujdesin e piktorit Zaim Elezi, me një eksperiencë të madhe në këtë fushë
**ORGANIZON KURSE PËR TË GJITHA MOSHAT**
Së bashku ne mund:
- Të mësojmë të vizatojmë
- Të mësojmë të pikturojmë
- Të mësojmë gjithçka rreth artit figurativ
*Adresa:* **Rr. "Zenel Baboçi", pall. Ferar.**
***Tel:*** **068 22 46 400**

Rruga e Arbërit nr. 102
kulturë



**Vahid Kormaku**
**ndër atdhetarët që kanë kontribuar në luftën për gjuhën, lirinë dhe përparimin e vendit. Patrioti, mësuesi, poligloti, historiani, biologu dhe atdhetari dibran...**

# **Vahid Kormaku**, *atdhetari dhe dijetari*

*Nga* **YMER STOJKU**

Ndër atdhetarët që kanë kontribuar në luftën për gjuhën, lirinë dhe përparimin e vendit, është edhe patrioti, mësuesi, poligloti, historiani, biologu dhe atdhetari dibran, Vahid Kormaku. Ai lindi në vitin 1894 në fshatin Steblevë, këtë fshat piktoresk me bukuri natyrore por dhe me tradita dhe histori, dhe ndërroi jetë para kohe, në moshën 52 vjecare, në vitin 1946. Vitet në të cilat ai jetoi ishin vite lufte për liri e pavarësi ku vendi ziente nën parullën "Ja vdekje ja liri" kundër sundimit osman.

Shkollën fillore dhe gjimnazin turk i kreu në Selanik të Geqisë, ku babai i tij punonte si ndërtues. Gjatë këtyre viteve, ai kreu paralelisht edhe mederesenë për të ushtruar më vonë profesionin e hoxhës.

Në kushtet e vështira të robërisë, Vahidi u ndodh midis dy rrugëve: të luftonte për çështjen kombëtare, ose të vihej në shërbim të Turqisë. Por ai zgjodhi rrugën e parë: atë të përkushtimit të çështjes kombëtare.

I pajisur me një kulturë të gjerë, ashtu si rilindasit tanë, Vahidi iu vu punës për njohjen nga vendet e tjera të historisë së popullit tonë, zakoneve, traditave kulturës etj. Në këtë kuadër, ky mësues filloi të punonte për të përgaditur një monografi për epokën e famshme të luftrave të heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Për këtë monografi ai punoi për një periudhë 8 vjeçare kryesisht mbi një temë të patrajtuar më parë, atë të betejave të Skënderbeut në Dibër, Pollog e Ohër (Maqedoni).

Eksperiencën e parë si mësues, Vahidi e pati në vitin 1921 në shkollën fillore të fshatit Tunjë të Gramshit. Pas vdekjes së tij, kësaj shkolle ju dha emri i tij, për nder të punës së palodhur dhe eksperiencës së tij të në këtë fushë, ku ai la gjumë të pashlyeshme ndër nxënës dhe kolegë të cilët e kanë kujtuar me respekt e mirënjohje.

Më pas, ai punoi pa u lodhur si mësues në shumë fshatra të Dibrës, madje, në vitin 1929, ai vetë personalisht, ndërtoi një ndërtesë tre katëshe buzë rrugës në fshatin e tij Steblevë për ta bërë shkollë, të cilën e rrethoi me lulishte dhe pemë të ndryshme duke rrezatuar në këtë mënyrë kulturë dhe qytetërim.

Pas shpalljes së pavarësisë në Vlorë më 1912, shtëpia e Vahid Kormakut ishte e para që ngriti flamurin shqiptar. Në vitet 1915 -1921, Vahidi së bashku edhe me bashkëfshatarë të tjerë të Steblevës mori pjesë në luftën kundër serbëve të cilët e kishin djegur tre herë këtë fshat dhe fshatra të tjerë në Dibër duke kryer në këtë mënyrë edhe shumë masakra në popullsinë vendase.

Historiani, Profesor Aleks Buda, gjatë një bisede me nipin e Vahid Kormakut, Shpëtim Kormaku, flet me dashuri dhe respekt për figurën e këtij patrioti të shquar. Ai e cilëson Vahid Kormaku si pionier të shkencës dhe historisë shqiptare.

Zoti Moisi Murra, i cili ka bërë edhe parathënien e librit "Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritën e realitetit" e cilëson këtë figurë si një atdhetar që i mati ngjarjet e kohës me grykën e pushkës por edhe me fuqinë e mendjes.

Jemin Latifi, ish nxënës i Vahid Kormakut në fshatin Tunjë të Gramshit kujton vështirësitë me të cilat ai u ndesh për pajisjen me mjete të shkollës dhe përkushtimin e tij për nxënësit duke punuar kokë më kokë. Motoja tij ishte: "Erdhi dita jonë".

Vdekja e parakohëshme e la të paplotësuar në monografinë e tij kapitullin për luftën antifashiste.

Vepra e tij mbetet aktuale edhe pas kaq vitesh që kanë kaluar dhe brezat që do të vijnë do ta kujtojnë me nderim dhe respekt të thellë.

# **Atdhedashuria**, *lajtmotivi kryesor në krijimtarinë e Halil Ramës*

*Nga* **SAKIP CAMI**


Vjen një kohë që krijuesit, veçanërisht ata të fushës së publicistikës, kërkojnë të mbledhin frytet e shpërndara ndër kohëra dhe ndër fusha të ndryshme. Kështu po ndodh edhe me gazetarin Halil Rama, i cili në një fazë pjekurie të plotë artistike dhe profesionale po na paraqet njëri pas tjetrit librat e tij publicistikë që qëndrojnë bukur në gjerdanin e publicistikës shqiptare.

Jo rastësisht në krijimtarinë e tij gjen edhe tre monografi historiko-letrare, njëra me e arrirë se tjetra. E para për filozofin popullor të vendlindjes se tij dhe të Dibrës, Dine Hoxha, e dyta për kompozitorin e tangos shqiptare, kompozitorin e harruar, krijuesin e muzikës së lehtë shqiptare me origjinë dibrane, Muharrem Xhediku dhe e treta për një hero të popullit shqiptar, për gjeneralin e Luftës së II Botërore dhe të kohës sonë, për Nderin e Kombit, Rrahman Parllaku. Në të tre këto monografi shkëlqen si një fill i kuq gjaku, atdhedashuria, dashuria për vendlindjen, për Shqipërinë, për shqiptarët kudo që janë.

Dhe së fundi del me librin e tij të pestë me publicistikë me titullin:"Testamenti i atdhedashurisë", botim i Shtëpisë Botuese "NACIONAL". Duket paksa deklarative, por në gazetari titulli shoqërohet me nëntituj e okelio që lexuesi të mos lodhet, por ta marrë informacionin sa më konçi,z dhe Halil Rama shquhet për këtë stil konçiz dhe për vërtetësinë e shkrimeve të tij.

Në librin e tij të fundit do të gjesh shkrime edhe për luftën e shqiptarëve të Maqedonisë dhe për gjeneralin e tyre Gëzim Ostreni, shkrimin protestë për Lumin e Radikës që kërkojnë t'ja ndalin rrjedhën, për Luftën Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, Konferencën e Bujanit dhe të Pezës, për ushtarin trim në provokacionet e gushtit 1949, për gardistin shëmbullor që ra në krye të detyrës etj.

Në libër dhe në shtypin e kohës do të gjesh shkrimet e gazetarit H. Rama për sensibilizim për vajzën e re 17 vjeçare Ambra Meda, që kërkon të jetojë dhe që dergjet në spital, sensibilizim që e gjen në Dibër të Madhe, në Bulqizë tek sportistët e famshëm vëllezërit Keta dhe kudo në Shqipëri, por që për ironi të fatit nuk e gjen tek organet shtetërore shqiptare.




Parë nga ky këndvështrim, edhe Dr.Fejzulla Gjabri – recensent i librit, konstaton se gazetari dhe shkrimtari i njohur Halil Rama vjen me një përmbledhje artikujsh, që bien erë Shqipërie. Shqipëri ngado ta shohësh: nga tema, nga frazeologjia, nga njerëzit – personazhe, nga… ....Ngado ta kthesh, gjen atdhedashurinë. Në shkrimet e tij nuk ka urrejtje, nuk ka frikë, nuk ka as teprime. Sigurisht, që jo gjithçka i pëlqen, por di ta shfaqë pakënaqësinë. Pra, di të bëjë kritikën.

"Tematika e këtij vëllimi me tregime është e mbrujtur me lëndë jetësore nga e cila buron një letërsi e mirëfilltë, e ndryshme nga krijimtaria eksperimentale, herë-herë e tejmbushur me frazeologji boshe. Kur lexon tregimet e këtij autori të mbërthen ideja e ndodhjes krejt rastësisht përballë një realiteti të njohur, por të paraqitur ndryshe, që të bën të ndjehesh mirë. Ndjehesh mirë kur bën një historik të shkurtër shkolle, që gjithsesi shumë vetë e kanë përjetuar fillimin e arsimit shqip në vendin tone", shprehet Dr.Gjabri në parathënien e librit. Sipas recenzentit Gjabri "Halil Rama nuk jep histori, por ngjarje. Bujanin historik e përshkruan ndjeshëm, me atë që i dha historisë. Në një farë mënyre, ai jep mesazh: Ja, kush asht Bujani, të tjerat le t'i thotë historiani, veçse dijeni se këtu u vendos 'vetëvendosja". Në këtë libër kemi dhe një tregim të bukur për një "hero" pak të njohur, që në gusht të 1949-ës, mori komandën në mbrojtje të kufijve. Më qartë: është historia e centralistit që urdhëroi hapjen e zjarrit ndaj monarkofashistëve grekë më 2 gusht 1949. E ka një lidhje me të mëvonshmen, që si grenzat vijnë e ngacmojnë në 'plagë', se ai kufi i marrë padrejtësisht, ku shqiptarët kufizohen me shqiptarë, mbeti plagë. Pikërisht përsëritja e disahershme më vonë, pas 2 gushtit 1949, e çon autorin në përkujtim të këtij centralisti 'hero'.

Sakrificat janë edhe në ditët e sotme, të cilat i jep nëpër disa tregime, siç është "Rekuiem për ishgardistin shembullor Arben Zhuzhi", e që duken se subjektet bashkëjetojnë natyrshëm.

Nëpër vëllim nuk mungojë vlerësime të autorve të tjerë, se fundja, autori ka marrë pjesë në promovimet e tyre, ka dëgjuar edhe të tjerët për to, njeh shumë krijues, se detyra e ka mësuar.

Në këtë libër do të lexosh edhe disa reçensione e kritika për libra dhe shkrimtarë të ndryshëm, mbledhës të folklorit, ku bie në sy shqetësimi i autorit që këta krijues ndër vite të mos harrohen, por të rivlerësohen në kohë. Në këto shkrime gjen analizën dhe komentin, gjen kritikën dhe fjalën e lirë, gjen fjalën e bukur shqipe.

Duke ju kthyer vendlindjes së tij ai shkruan për shkollën e Muhurrit të Dibrës dhe për mësuesit e dëgjuar Xhemal dhe Lik Berisha, për shkrimtarin dhe poetin Naim Berisha, pasues të fisit të dëgjuar Berisha të Muhurit të Dibrës ku dolën dy gjeneralë të Skënderbeut, Dhimitër e Nikollë Berisha.

Shqetësimi i autorit, si pjesë e shqetësimit të një grupi aktiv të shoqërisë shqiptare që ngre zërin kur punët nuk shkojnë mirë në këtë vend ku ne jetojmë dhe që do të jetojnë edhe fëmijët tanë, edhe brezat që do të vijnë, përshkon këtë libër me publicitikë që lexohet me dëshirë, sepse në të gjen personazhet dhe shqetësimet e kohës që jetojmë.

## LIBRI I RI




# Poeti dhe gazetari **Mentor Hoxha** publikon librin e njëmbëdhjetë *"Në studion time"*

Poeti dhe gazetari Mentor Hoxha paraqitet para lexuesit me librin e tij të njëmbëdhjetë "Në Studion time".

Në këtë studio ka ftuar disa nga personalitetet më të shquara të Dibrës dhe të Shqipërisë si Prof. dr. Shaban Sinani, Prof. dr. Agim Vinca, Prof. Agron Tufa, Mjeshtrja e Madhe Liri Rasha dhe mjeshtri i humorit Behar Mera. Krahas këtyre personaliteteve dibrane kjo studio ka edhe shumë kryengjarje dhe kryefigura të rëndësishme historike të hapësirës mbarë dibrane në gjithëkohësi. Në studion e Mentor Hoxhës kanë shkuar dhe kanë dëshmuar sukseset dhe jetën e tyre profesionale mbi 1000 personalitetet më të spikatura të kombit shqiptar të pasnëntëdhjetës, si presidentë, kryeministra, kryeparlamentarë, ministra, deputetë, politikanë, kryebashkiakë, kryebukuroshe, shkrimtarë, studiues, sportistë, artistë dhe gazetarë të nderur në hapësirën mbarëshqiptare.

Mentor Hoxha ka një master shkencor për "Studime Letrare" dhe disa kualifikime për mësuesi dhe gazetari në Angli. Ka punuar për disa vjet si Mësues i Gjuhës dhe i Letërsisë në disa shkolla të mesme dhe 8-vjeçare në Dibër si dhe gazetar dhe redaktor në disa media, si "Koha Jonë", revista "Blic", "Emigranti Shqiptar", "SOT", "Telegraf", "Vajza e Ditës" etj.

Ka botuar në shtypin ditor e periodik mbi 8500 studime dhe artikuj politikë, social e kulturor, 1500 intervista me figura publike dhe 10 libra me poezi, reportazhe e intervista exluzive me figurat më të njohura publike të tranzicionit shqiptar

Nga viti 1996 është anëtar i International Federation of Journalists (IFJ) me seli në Bruksel dhe anëtar i Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë.

traditë

# Reka e Epërme, plagë e pashëruar në popull

*Nga* **EDIBE SELIMI-OSMANI**

*(Vijon nga numri i kaluar)*

Në mesin e shumë dijetarëve atdhedashës nga Shtirovica, dallohet edhe Matej Milani, i cili ishte i lindur në fshatin Shtirovicë më 1886. Gjatë kohë jetoi dhe punoi në Rumani. Sipas rrëfimit të birit të tij Danielit, i ati i tij ka qenë atdhetar i flaktë. Aq shumë pat vepruar ai për përhapjen e librit shqip e të dritës së shenjtë të atdhedashurisë shqipare, saqë e zënë serbët dhe e nxjerrin ta dënojnë para krajlit në Beograd. Duke parë konotacionet ortodokse të emrit të tij (Milan), mbreti serb i ka thënë "Ti s'je shqiptar". "-Po të mos isha shqiptar, do t'i nxjerrja sytë e mi", ishte përgjigjur Danili në atë kohë para mbretit e gjykatësve, duke shtuar se është shqiptar dhe se dëshiron të vdes si i tillë. Duke parë se nuk e ka braktisur fenë e të parëve, nuk përkulet para armikut, nuk i shet shokët dhe është shembull i rrallë i patriotizmit shqiptar, mbreti pat dhënë urdhër të lirohet, por me kusht që të braktisë Jugosllavinë.[16]

Aftësinë e tyre artistike, anasit e Rekës së Epërme, i kanë shprehur qysh në shekullin XVIII. Në qytetin e Peshkopisë, ruhet një nga brenditë më tërheqëse të krahinës, që sipas stilit të daltimit i përket grupit të mjeshtrit të shquar Pjetër Filipit-artizan i dalluar i cili gjatë fillimit të shekullit XIX kreu disa vepra zbukuruese në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e sotme.Punën e tyre e vazhduan mjeshtrit Ramadan Dibra në shek.XIX.[17]

Në gjirin e popullit liridashës e patriot të kësaj krahine lindi dhe u rrit njëri prej figurave të shquara të Rilindjes sonë kombëtare, atdhetari, poeti dhe publicisti Josif Jovan Bageri i lindur në fshatin Nistrovë. Fshatarët e krahinës së Rekës në shekullin XIX filluan të emigrojnë jashtë atdheut, për të gjetur punë e jetesë më të sigurtë.[18]Qysh në moshën shtatmbëdhjetë vjeçare Josifi u largua nga vendlindja dhe u vendos në Sofije të Bullgarisë, me shpresë se do ta përmirsojë sadopak gjendjen e vështirë ekonomike dhe do të ndihmojë në kauzën e drejtë të Rilindjes Kombëtare. Më 1893, me ndihmën e mërgatës shqiptare, u themelua në Sofie shoqëria Dëshira. Bageri, ishte njëri ndër themeluesit e kësaj shoqërie. Gjithashtu udhëheqte revistënShqypeja e Shqypenis, Sofi, 1910. Publicist në revista të ndryshme si Drita e Shpresa e Shqipnisë (1901), Kalendari i Kombit, e tjerë. Më 1910, mblodhi një pjesë të mirë të poezive që pat botur në shtypin e kohës dhe i përfshiu në vëllimin me vjersha Kopësht malsori.Autor i shumë poezive me tematikë patriotike dhe motiv social. Veçuam disa vargje:

".. . Me vdek ktu uni këtë 'rend,
S'due tëm lini n'këtë vend, -
Korpin ktu mos ma vorroni,
Po në Shqypni të ma çoni. . .
S'due ktu uni me vdek,
Po n'Shqypni, atje në Rek!"[19]

Në veprën e saj Mirjana Mirçevska, në më shumë se 50 fjali përdorën një fjalor diletanti në fushën e shkencës , si që thamë edhe më lartë me qëllim që të shfaqe urejtje në mesin e njerëzve të cilët edhe sot nderojnë njëri tjetrin pa dallim se cilës fe i takojnë. Edhe në këtë shekush në të cilin gjendemi sot mundohet ta fsheh realitetin. Citojmë nga vepra në fjalë, faq.46

...Shpërnguljet sistematike të shqiptarëve mysliman në rretin e sotëm të Shqipërisë së veriut dhe në hapësirën etnike të Rekës së Epërme ku sundonte feudali Dalip Begu, pikërisht në këtë periudhë kur ai ishte udhëheqës në malësinë e Korabit dhe Sharrit, janë popullarizuar shumë shqiptarë mysliman barinj dhe diár. Si fise baritore (bëhet fjalë për banorët e Rekës së Epërme) gjithmonë janë mësuar të enden me kopenë e tyre të dhenve nga një zonë malore në tjetrën. Ashtu ka qenë Korabi i shkretuar, gjithmonë me bandit malor, në të cilët mund të shihen vetëm me kope shqiptarësh, shqiptarë barinj që çdoherë kanë qenë të përgaditur për luftë si kusarë.Shqiptarët në këtë mënyrë i kanë uzurpuar tokat maqedonase krishtere të fshatrave Vrbjan, Dëbovë, Tërnicë, Shtirovicë, Reç dhe Strezimir duke i dhunuar që ata të shpërngulen.[20]

Siç duket Mirçevska, shfleton literaturën e A. I.Selivçev, akademik rus që shkruan të nisur nga motivet nacionailste e shoviniste, duke shtrembëruar të vërtetën që në vitin 1914, autorja në fjalë përveç se t'i ofendoje shqiptarët se janë hajdut, vrasës, barinj nuk din si ta mbroje doktoraturën e saj.

Si dëshmi se kush janë krishterët e Rekës së Epërme, do t'a veçojmë fshatin më karakteristik Beliçicën. Më 21 janar të vitit 1995, në ditën e tretë të Kryshes (Voj Jordani), ishim prezent dhe të ftuar në këtë festë. Në vendin e quajtur Te kroi i madh, inçizuam këngën:

Oj ti kryshe, bardha kryshe,
Ti na shton e na ndihmon, ooo ih!
Sa lula ka dardha,
Ajsh cuca me korpa t'bardha,
Po sa lula kishte molla,
Ajsh nuse me marhoma, ooo ih!
Po sa lula kishte dardha,
Ajsh Trima me kfal me shala, o o i h![21]

Po t'a kishin kënduar në gjuhën sllavo-maqedone do të ishte kështu:

O ti krste , belo krste,
Ti ne mno`i{ i ni pomaga{,
Kolku cvetovi ima kru{ata,
. . . . . .

Këngë dhe rite me kryqin mund të gjejshë në mesin e krishterëve që gjuhë amtare e kanë gjuhë shqipe.

Në librin e Mirçevskës, vërrejmë në faqen 53 edhe këtë (citat):Nga një pjesë e fiseve të cilët janë me preardhje më të hershme nga viset shqiptare, Reka e Epërme, për ta ka qenë etapë kalimtare stacionesh, të cilët pjesa më e madhe e tyre janë shpërngulur në fshatrat e Pollogut të Epërm në fshatin |egran, Forinë, Koritë... Të gjithë këta ardhacak nga Reka e Epërme në trevat e përmendura kanë ardhur më shumë se 150 vjet në kohën e Perandorisë Otomane. Edhepse një pjesë e tyre janë islamizuar, e më pas janë shqiptarizuar në maqedonas krishterë, sot ata përgjithësisht janë shqiptarizuar dhe aspak nuk e përmendin lidhjen e tyre që e kanë preardhjen nga krishterët sllav.

## BURIMET E AUTORËVE ANTIK PËR ILIRËT DHE ILIRINË

Nga literatura e shfletuar do të përmendim vetëm disa nga argumentet e shkruara:

Sipas udhërrëfyesit të shek.VI, Synekdemit të Hieroklit, në provincat ilire aso kohe kishte 20 qendërbanime të konsideruara si qytete.[22]

Ky numër përputhet me të dhënat e koncileve kishtare të kohës, mbasi thuajse të gjitha qytetet e mëdha ishin edhe seli peshkopate. Të tilla qenë Skodra, Lisi, Dyrrahu, Skampini, Scupi(Shkupi i sotëm).Ulpiana(pranë Prishtinës) Lyhnidi(Ohri), Apolonia, Bylisi, Amantia, (Ploça e Vlorës)Aulona, Butroti(Butrinti) Onhezmi, Foinike(Finiqi i Sarandës) dhe Hadrianopoli- Justiniapoli.[23]

Në vitin 1774 në Lajpcig u botua libri shkencore i Joahn Tunmanit [24].Ai duke ndjekur zhvillimet historike mijëvjeçare në këto troje shkruan: populli i parë që njeh historia në këtë vend janë ilirët, një popull i madh, i shumtë në numër dhe i fuqishëm që sipas Strabonit dhe Apianit, banonte në detin Adriatik, nga lumi Po deri në Gjirin e Ambrakisë, e në veri deri në Danub. Straboni e shtrin këtë popull drejt perëndimit deri në liqenin Boden, (liqeni Boden në Gjermaninë Jugore shënim i përkthyesit) domethënë deri në Norik e Vindelicie. Ai lë të kuptohet gjithashtu se edhe panonët i përkisnin po atij fisi. Apiani, thotë shprehimisht se panonët ishin ilir.Istrianët, inët, jastët, japodët, dalmatët, liburnët, dardanët, ardianët, autariatët , me një fjalë të gjithë popujt deri në malet Keraune, përgjithësisht shiheshin si ilir. Por ata gjendeshin kudo në Maqedoni, në Epir e në Thesali [25]... Thunmani që atëherë duke pasur në dispozicion vetëm burimet historike përfundoi se shqiptarët janë banuesit e lashtë dhe si argument për këtë hipotezë solli dokumente të shkruara të ruajtura të mesjetës, në të cilën nuk hasim gjurmë më të vogla për ndonjë shpërngulje shqiptarësh në vendbanimin e tyre të sotëm.Ky dokument edhe sot është i qëndrueshëm ku mbështetet teza e autoktonisë së shqiptarëve. Gjithashtu profesori i historisë, akademik Aleks Buda , pos të tjerash ka thënë:"Vepra e Tunmaniut përbën një ndihmesë për ta vënë mbi baza shkencore problemin e formimit të popullit shqiptar e të gjuhës shqipe."

Profesori Tunman në Lajpcing, duke u mbështetur bazë prej 1200 fjalësh shqipe parashtroi tezat e para historiko filologjike rreth prejardhjes dhe të shkruarës së shqiptarëve dhe i nxerr ata si një popull të lashtë të Siujdhesës Ilirike, si fqinjë të helenëve të lashtë dhe, rrjedhimisht, si pasardhës vijëdrejtë të ilirëve të Gentit, të Teutës dhe të Piros.

Gjeografi më i madh i kohës, akademiku i dëgjuar aleksandrian Klaud Ptolemeu, qysh në shekullin II(125-161)dëshmon se në Maqedoninë mestokësore janë qytetet Arnisa e taulantëve, Elima e elimiotëve, Amantia në Orestis, Albanopolis i albanëve, Orma, Europus dhe Apsalus të almopëve.[26] Këtë dëshmi e mbështet edhe studiuesi i mirënjohur Muzafer Kortuki ku thotë se Albanët ishin aty me siguri edhe disa shekuj më parë për të qenë i shënuar në hartën e këtij gjeografi antik[27].

Nuk duhet haruar edhe tezën e historianit të madh ballkanik, çekun Konstatin Jireçek, ku shkruan:

Shqiptarët kanë qenë një popullatë e vjetër krishtere me kulturë të ndjeshme qytetare, që kanë qëndruar më afër grekëve bizantinë dhe romakëve, dalmatinasve sesa me elementin sllav.

Klerikun frëng, Guillelmus Adac, i njohur me emrin Brocardus Monacus më 1332 në veprën e tij latinisht shkruan se shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin në përdorim dhe në tërë librat e tyre".[28]

Gjithashtu ua bëjmë me dije akademikëve sllavo-maqedonas se rreth kombësisë së lashtë ilire të shqiptarëve shkruan edhe studiuesi gjerman Malte-Bruni në veprën e tij thotë :se gjuha e ilirëve të lashtë ose e shqiptarëve të sotëm është një gjuhë e veçantë, prejardhja e së cilës shkon deri në lashtësinë e thellë e madje në një kohë kur filluan të formoheshin, secila në sferën e saj, edhe gjuhët greqishte, latinishte, iberishte, keltishte, teutonishte, gotishte e tjerë.

Një mendim e përkrahën edhe studiuesi gjerman Johan Gfon Hani që në fillim të veprës së tij Studime shqiptarebotuar më 1854, ku e shtron problemin e prejardhjes së shqiptarëve dhe thotë : Meqë shqiptarët nuk janë sllavëdhe nuk lidhen ngushtë me ndonjë nga popujt e tjerë që njohim, meqë burimet fare të pakta që kemi nuk flasin për ndonjë shtegtim tjetër(veç atij sllavit) i cili të ishte aq i madh sa të krijonte një popull të madh, duhet pranuar se shqiptarët e sotëm janë banorët e hershëm parasllav të atij vendi. Ai në vazhdim të veprës shkruan: se elementi shqiptar jo vetëm që e kalon malin Sharr(Skardus), sepse Tetova, pellgu i burimit të Vardarit, është një qark i përzier shqiptaro-bullgar, por që arrin deri në grykën e parë të Vardarit, në jug të Shkupit, deri në bregun e djathtë të këtij lumi. Si duket bullgarët banojnë vetëm jashtë trekëndëshit të formuar nga Vardari, Treska dhe vargu i Goleshnicës, kurse brenda kësaj bërthame jetojnë vetëm shqiptarë... Por këta janë vende në të cilat u ndie rëndë dora e pushtuesve bizantinë pas peradorit Basilios Bullgaroktoni, mbi armiqtë e trashëguar bullgarë të nënshtruar e më pas edhe pushtimi turk. Kështu ne mund të pranojmë si të padiskutueshme se shqiptarët e sotëm janë pasardhës të ilirëve dhe epirotëve të lashtë[29].

Jozef Riter fon Ksilanderi, ka qenë i pari që ka përmendur në një faqe të veçantë në fillim të librit të tij:Ata-shqiptarët nuk janë aspak të huaj, por një popull i lashtë i familjes evropiane...[30]

Studiues kosovar, doktor Musa Ahmeti, pas më shumë se shtatë vitesh kërkimi, ka arritur të zbuloje në Arkivat e PAPATIT (Arkivin Sekret të Vatikanit në Vatikan), një dorëshkrim në gjuhën shqipe që daton vitin 1210. Bëhet fjalë për një dorëshkrim prej 208 faqesh, të ruajtur mjaft mirë në kohë, i cili është shkruar mbi një pergament me kopertina të forta druri dhe e mbështjellur me kapakë druri.Është i shkruar me shkronja latine i tëri në gjuhën shqipe, në dialektin e veriut .Autorë i veprës Teodor Shkorani ku shkruan:Me ndihmën e zotit dhe me dëshirën e madhe që kam përfundova me këtë vepër më 9 Mars 1210.[31])

E pyesim Mirjana P.Mirçevskën, se cili popul në Maqedoninë e sotme është më i hershëm ata me vepër që nga vitet 1210 në gjuhën shqipe me alfabet latin ose gramatika e Bllazhe Koneskit e vitit 1945?

Të shkruash një studim historik mbi islamizimin e laraminizmin e shqiptarëve, dhe njëkohësisht ta njihnim zhvillimin e disiplinës kishtare që nga fillimi e deri më sot, është një punë mjaft e vështirë . Kështu , ai(ajo) do të duhej të jetë njëkohësisht historian, kanonist, teolog... madje bile edhe një poliglot.

Për hirë të asaj që nuk duam t'a lodhim lexuesin do t'i veçojmë disa të dhëna që në veprën e saj Mirçeska, nuk ka njohuri të shkruaje:

Po t'i hedhim një sy veprës së Dr.Don Gaspër Gjinit Ipeshkvia Shkup Prizren nëpër shekuj , ku ndër të tjerat shkuan se: Dardania ishte një krahinë e veçantë kishtare dhe administrative. Selia e parë ipeshkvore në Dardani, me sa dihet deri më tani ka qenë në qytetin e Scupit.Ilirët (shqiptarët) kanë filluar të kalojnë në krishterim shumë herët.Madje, dihet se edhe Shën Pjetri dhe Shën Pali, apostuj të Krishtit, pra, bashkëkohës të tij, kanë predikuar fenë e re ndër shqiptarët në Iliri. [32]Pas ndarjes së krishterimit në kishën e lindjes-ortodokse dhe në kishën e perëndimit-katolike më 1054, shqiptarët mbetën me kishën ortodokse, sepse në trevat e tyre sundonte Bizanti (Greqia), e më vonë Serbia [33]. E tillë ka qenë gjendja, sidomos në Kosovë. Gjatë sundimit të Bizantisë e të Serbisë, shqiptarët janë asimiluar nëpërmasa shumë të mëdha, ata bënë presion edhe në (|amëri dhe në vise të tjera në Greqi) dhe sidomos në Maqedoni e në Mal të Zi, duke i sllavizuar kështu një numër të madh. [34]

Në veprën Psaltiri, e shkruar në ebraishtën e vjetër, e përkthyer nga K.Kristoforidhi (1872), citojmë: në kishat shqiptare të Maqedonisë, është mbajtur liturgjia në gjuhën shqipe, objektet fetare krishtere nuk janë sllave por shqiptare, ndërsa emërtimi i kishave ndryshoi pas ardhjes së sllavëve [35].

## FESTAT

Gjatë viteve (1920-1935) kur nëpër kishat e fshatrave të Rekës së Epërme, erdhën priftërinj nga vendet e tjera, na thonë nënat ortodokse, mesha dhe këngët filluan të mos këndohen më në gjuhën shqipe. Prifti ua ndaloi këtë reptësisht. Përsa kujton brezi i moshuar, ato kanë filluar të përshpëriten në vehte, Edhe sot nënat përshpërisin meshën në gjuhën shqipe.Për shembull:

Voj Jordani pagezuet,
Dy-tre vetë t'u m'pal e t'u u m'fat,
Ere shokët, ere shoçet t'u kënduet,
Ere fryma jote si pëllumb vegëtuet,

Edhepse ishim të detyruar meshën ta këndojnë në gjuhë të huaj, por nuk mundeshim, ashtu e kemi mësuar nga nënat, gjyshet tona na thotë brezi i moshuar i nënave.[36]

### Pashkët

Në këto reshta, nuk është qëllimi ynë dhe as që mundemi t'i përfshim të gjitha kremtet . Rituale të shumta që kryhen nga banorët e Rekës së Epërme që i praktikojnë janë plot e përplot me besime magjike. Pashka, është fesë e hebrenjve (e çifutëve) e cila festohet shumë shekuj para Krishtit, si kujtim i ditës, kur këta dolën nga robëria e egjiptianëve dhe u vendosën në Palestinë. Kësaj dite hebrenjtë i thoshin pas-ha. Kjo fjalë depërtoi edhe në gjuhën shqipe. [37]

Banorët e kësaj krahine kudo që gjenden festojnë Pashkët, shkojnë për urime te njëri-tjetri, vizitojnë të afërmit dhe farefisin. Gjatë vizitave shënuma disa shprehje të bukura:Për shumë mat ( mot) Pashkët! Tjetri ia kthen:Gzuet qoft e për shumë mat!. Ngrejnë dolli duke thënë :Gzuet qofshim e për shëndet!Amin, n'mat ngjefshim ma mirë! Në orët e pasditës, Ditën e Pashkës, tubohen fshatarët grupe-grupe e shëtitin për të uruar festën në çdo shtëpi. Pasi perëndon dielli ( para se të errësohet ) në rrugicat e fshatit Beliçicë, fshatarët kapen në formë rrethi dhe ndezin duaj thekre . Ato na thonë bëjmë xhuguli dhe "ceravitemi" Djegin, përcëllojnë këmbët, duke thënët'dojxha, t'pojsha (të dogja, e të poqa).Gjatë ritualit grupi i grave këndon:

Proni lula bardhë e duku bardhë
Proni te ajo kisha mes kërshele
Po aty kishte trima shumë,
Trima shumë e nuse t'reja
Cuaca t'reja e fmij t'rij
Qera here ene ma shumë, o o i h [38]

Kulti i diellit është dëshmuar edhe nga një lajm interesant i shkruar, filozofi Maksim nga Tiri, i cili jetoi në kohën e Antonomit, në librin e tij "A duhet t'u ngrihen perëndive shtatore", përmend se Peonët, fis ilir në Maqedoninë e sotme, e adhurojnë diellin në formën e një disku të vogël, të ngritur mbi një shtyllë të gjatë [39].

*(Vijon në faqen 18)*

Rruga e Arbërit nr. 102

portret

# Vëllezërit Miftari – Një histori suksesi në ishullin Staten Island







**Në faqen e internetit të biznesit "Pronto Pizza Pasta", mësojmë se ditët e fundit vëllezërit Miftari me origjinë nga Dibra e Madhe - hapën dje edhe shitoren e 6, në një nga qendrat tregtare në ishullin njujorkez Staten Island...**

*Nga* **BEQIR SINA**

Vëllezërit, të cilët erdhën në Shtetet e Bashkuara në fund-vitet 70'', e ngritën biznesin e tyre nga hiçi dhe tani janë duke e zgjeruar vazhdimisht, në ishullin e Staten Island - duke u bërë dhe një nga bizneset më të mëdha në këtë ishull - por, edhe në Nju Jork..

Popullariteti i picave në kulturën amerikane, ka mbajtur të fortë biznesin edhe të shumë shqiptarëve në SHBA - për dekada të tëra. Mbasi disa biznesmen të suksesshëm duke e filluar nga një dyqan pica - tash kan potenciale të mëdha për të prodhuar fitime të mëdha, nëpërmjet një procesi i filluar dhe me drejtimin e një operacioni të suksesshëm që natyrisht në fushën e të bërit biznes kërkon "guxim", planifikim dhe durim.

Me numrin e madh të dyqaneve pica në Amerikë, sipërmarrësit e ndryshëm sidomos shqiptarët të cilët po bëhen "Mbretërit e Picave" në Amerikë, duke ua "marrë' zanatin e vjetër italianëve , dëshirojnë të fillojnë suksesin e tyre me pica restorante të reja pica për të sjellë diçka unike në tregun e tyre në Amerikë.

Pronarët shqiptarë të dyqaneve Pizza Restaurant duke filluar me nga një dyqan pica të vogël, kanë arritur në një sipërmarrje të madhe dhe emocionuese, duke hapur dyqane të tjera të një biznesi të suksesshëm duke u bërë edhe" Një histori suksesi në SHB" .

Kështuqë, mbas suksesit të katër vëllezërve nga Kosova(Ndoi, Paulini, Gjoni dhe Gjergji, të lindur në Kosovë dhe të ardhur në Amerikë, pa asnjë para në xhep në vitet 70 bashkë me motrën Zoja dhe nënën Roza, që janë bërë tashmë të famshëm në Shtetet e Bashkuara për dhjetra restorantet e tyre të quajtur Famous Famiglia Pizzeria, janë edhe 6 vëllezërit Miftari, me nënën e tyre Laze (njëri prej tyre më i vogëli i tyre Blerim Bill Miftari vdiq në moshën 33 vjeçare dy muaj më parë) janë bërë tjetër histori suksesi në biznesin e Piceria - Reastaurant në Nju Jork.

Në faqen e internetit të këtij biznesi "Pronto Pizza Pasta" , mësojmë se ditët e fundit vëllezërit Miftari me origjinë nga Dibra e Madhe - hapën dje edhe shitoren e 6 në një nga qendrat tregtare në ishullin njujorkez Staten Island . Shitorja më e re Pronto Piza, është më e madhja në Staten Isalnd me tre furra pjekje, dhe një sipërfaqe të madhe të lokalit dhe me parkingun falas.

Vëllezërit, të cilët erdhën në Shtetet e Bashkuara në fund-vitet 70'', e ngritën biznesin e tyre nga hiçi dhe tani janë duke e zgjeruar vazhdimisht, në ishullin e Staten Island - duke u bërë dhe një nga bizneset më të mëdha në këtë ishull - por, edhe në Nju Jork..

Ata po hapin Pizza restorante të reja në ishullin njujorkez Staten Island dhe emri Pronto Pasta Pizzeria, po bëhet gjithnjë e më i njohur, në mesin e qytetarëve amerikanë. Janë pesë vëllezër, katër në Nju Jork dhe një në Dibër të Madhe Flamuri, Enveri, Besniku, Shpetimi dhe Dashi (mbasi vëllai i vogël i tyre u nda nga jeta ) suksesi i biznesit të tyre - kuntributiti të tyre humanitar edhe për kombin tonë- është bërë i njohur në të gjithë ishullin e Staten Island -, ku vëllezërit Miftari, kan bërë aq shumë klientë, miq dhe shok, për gjithë jetën. .

Në prani të dhjetra kilentëve dje në Staten Island të mbledhur në një ceremoni e cila thirret këtu Grand Open, Pronto Pasta Pizzeria organizoi hapjen e saj tradicionale të dyqanit më ri dyqanit të gjashtë. Promovime, të tilla në SHBA bëhen vetëm nga biznese të njohura.

Vëllezërit Miftari duan që emri i Pica - restorantit të tyre, Pronto Pasta Pica të përhapet në të gjithë Nju Jorkun - mbasi si thotë njëri prej tyre Dashi - ata kan synim që në të ardhmen të hapin ndonjë shitore tjetër edhe në Manhattan - Nju Jork

Familja Miftari - fëmijët e Tasim dhe Laze Miftari, gjithashtu përmendet në komunitetin shqiptarë se ka dhënë ndihma në luftën e UÇK-ës, luftën në Maqedoni, ndihma sa herë që është lypur për çështje të ndryshme humanitare dhe kontribute financiare në komunitetin shqiptarë, për thirrje të ndryshme, ndihma për të sëmurët, familjet e varfëra, fakeqësit natyrore e tjera e tjer.

Pronto Pizza - me të gjashtë lokalet e saj në Staten Island - thuhet se ka qenë e përfshirë edhe ndihmat që u mblodhën nga komuniteti i këtij ishulli - për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga stuhia Sandy në vitin 2012 ..

## REKA E EPËRME, PLAGË E PASHËRUAR NË POPULL

*(Vijon nga faqja 17)*

Me ritualet e djegies së zjarreve, fshatarët besojnë se gjatë vitit dielli do të ndriçojë si flaka e duajve. [40]

Pra, ua bëjmë me dije akademikëve sllavo-maqedonas, se kemi të bëjmë me një popull të lashtë ilir siç janëPeonët. Karakteri i këtyre zjarreve është i mbështetur mbi veprimet imitative magjike. Përmes imitacionit aludohet në rezultate pozitive në dritësi dhe nxehtësi më të madhe nga dielli, si kusht i rendimenteve më të larta nga të lashtat në bujqësi [41].

Elementin solar e plotëson edhe mënyra e të manifestuarit të këtyre ceremonive. Kështu në mënyrë simbolike-imitative përmes heqjes së valleve në rreth, duke iu sjellë zjarrit, imitohet rruga e diellit në horizont .

Gjithashtu edhe kryqi ka filluar të përdoret në shekullin VIII-IX, por jo dhe më herët. [42]

### Ceremoni rituale me ujin

Është Dita e ujit të Bekuar, e premtja e parë pas Pashkëve.

Ritet e kësaj feste qoftë parakrishtere, qoftë krishtere kanë të bëjnë me kultin e ujërave e me rite magjike të ujit për pjellori e mbarësi. [43] Ceremoni rituale magjike të shumta që kryhen nga ana e popullatës vendase i hasim te kroi i fshatit. Në fshatin Bogdi Te Kroi i Kryshes, në fshatin Beliçicë Te Kroi i Madh në fshatin Krokornicë Te kroi i Katundit, në fshatin Sencë Te Izvori i Kryshes, në fshatin Duf Te kroi i Madh . . .[44]Nga grupi i grave shënuam këngën:

Oj ti kroi, kroi naltë, o o i h!
Po sa trima pret me natë, o o i h!
Po sa nuse t'reja, ooih!
Pa bukën e kryshes, , ooih!
Bashkë do ta dajmë, ooih!
Po venën e ombël, ooih!
Bashkë do ta pijmë, ooih!
Po penin e kryshes, ooih!
Bashkë do ta dajmë, o o i h [45]

Të shkruajsh për vendasit e Rekës së Epërme dhe të mos e përmendish veshjen kombëtare është e pamundur. Etnograf të shumtë shkruajnë:Veshja e femrës është shumë vështirë t'a përshkruaj me pendë, por edhe me fotografi nuk mund ta prezentosh atë. Qendisjet janë të bukura, simtrike në anën artistike të jep mjaft interes që të merresh me motivet të një artisti të rrallë [46]. Këtë qëndisje artistike mundesh t'a gjejsh vetëm te fermat e kësaj krahine, ku dukshëm shifet preciziteti, aftësia, imagjinata, kreativiteti i saj gjatë thurrjes, qëndisjes, të cilat me shekuj e kanë traditë artizanatin, edhe sot këto femra të vyera ia përcjellin gjeneratave që vijnë mbas artizanatin e tyre..

Edhe vetë Mirçevskën, e habit fakti që në Rekën e Epërme: janë të përbashkëta rite që krhyhen në burimin e fshatit(dhe ajazma) që kan veti shëruese dhe gjapëri si mbrojtës i shtëpisë [47].

Në këtë libër të Mirçevskës mund të gjejsh edhe shkrime mjaft qesharake, (citat faqe 52): Eshte per t'u cituar gazeta Dnevnik 26 Nëntor 2003, që shkruan:Ngjarje të tilla janë regjistruar në të gjitha fshatrat e Rekës së Epërme të cilët gjenden në kufi me Shqipërinë, të pasigurtë nga plaçkitja e barinjve shqiptarë, të cilët edhe sot hyjnë dhe e vjedhin bagëtinë dhe e dërgojnë jashtë kufirit në Shqipëri...[48] E pyesim Mirçevskën, sa vjedhje janë bërë në Maqedoni që nga viti 2003 deri më sot 20.01.2011? A thua vallë vetëm shqiparët janë ata që vjedhin. E drejta e çdo njeriu është se cilës fe ai i takon, dhe si ndjehet ai shqiptar apo sllavo-maqedonas.

Por, ortodoksëve shqiptar u duhet thënë e vërteta, t'u thuhet se deri tani kanë qenë të mashtruar, sepse kombin e bëjnë gjaku i njëjt, gjuha, trditat, doket , zakonet, folklori e jo besimi fetar.

Definicioni i Sh.Sergej (citat) Etnosi është grupa e njerëzve të cilët flasin të njejtën gjuhë, të cilët pajtohen se kanë të njejtën preardhje, me rite të përbashkëta, mënyra e jetesës, traditat, diçka që dallohen ata nga grupi tjetër. [49]

## REFERIME

[16] Mr.Seadin Xhaferi, dr.Mustafa Ibrahimi, Baki Ymeri, Emigracioni nga Maqedonia Perëndimore në Rumani, 2004, str.150-154.
[17]G.Polikru{eva, K.Tomoski, Les tekkes en Macedoine aux XVIII/5 , vo Atti del II Congr.Intern.di arte turca, str.203-207, më gjërësisht në revistën e Ministria e arsimit dhe e kulturës instituti i monumenteve të kulturës, Tiranë, Monumentet nr.20, 1980,
[18] Josif Bageri – Ruzhdi Mata, Shtëpia botuese 8 Nëntori, Tiranë, faq.19-102.
[19] Po aty, vepër e cituar.f.44.
[20] Po aty vepër e cituar f.49.
[21] Edibe Selimi- Osmani, Rite e besime populore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit, vepër e cituar f .27-28.
[22] Hierocli Synecdemus, 651-656, në në vëllimin Ilirët dhe Iliria te autorët antikë" f.455-456
[23] Prof.Aleks Buda Etnogjeneza e popullit shqiptar f.73
[24] Johan Tunman Untersuchungen ueber die Geschichte oestlichen europaeischen Voelker (Kërkime në historinë e popujve të Evropës Lindore, Leipzig, 1774,
[25] Jordanus ap.Raynald, T.XII A 1217 f.11
[26] Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Rilindja-Prishtinë, faq.416-420
[27] Muzafer Kurkuti Rreth formimit të etnosit ilir, në Studime ilire vëll.I, Tiranë, 1974, fq.77-79
[28] Ditrctorium ad passagrum facienda(lib.I, pj.8) në Dh.Shuteriq i Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850., f.23
[29]Reise von Belgrad Nach Salonik-Fallmerayer, Das alban.Element in Griechenland, Abtheil, I, und die dort Angeführten, Zeus. f.50-78
[30] Jozef Riter fon Ksilander Die Sprache der Albanesen oder Schkipëtaren, 1835
[31] Studime gjuhësore, vëllimi VI , f.12, referenca nr.29, Prishtinë 1988
[32] Gaspër Gjini Ipeshkvia Shkup Prizren nëpër shekuj Shtypi KS Zagreb, 1992, faq.34 dhe
Ptolomacus III 9, 4: Bekkerus I Bonae 1840, 436
[33] Skënder Riza, Albanci u turskem imperiuju ( në librin Albanci...) f.46-49.
[34] Shif më gjërësisht në Mark Krasniqi Aspekte mitologjike besime e bestytni f.78.
[35]H. Boyoxhianit-prevedeno od Kristo Foridi, 1872 g. str.125.(Vepra gjendet në bibliotekën e D.Braila, në Bukuresht.)
[36] Po aty f.24.
[37] Andrija Gams, Biblija i društvo, Matica srpska, Novi Sad, 1979, str.245
[38] Vep.Rite e bes..... f.60.
[40] Maximus Tyr. Philosophumena, II, 8, p.25. Më gjërësisht shif Simbolet e kultit te ilirët – Aleksandër Stipçeviq, faq.17.
[41] Ukë Xhemaj Zjarri në besimet populloe shqiptare, Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore Prishtinë, 1983, faq.105-121.
[42] A.S.Tokarev Vera v zgodovini nardov sveta, Ljubljana 1974, str.16.
[43] A.S.Tokarev, Vera i zgod....f.45.
[44] E.Selimi-Osmani, vepër e cituar f. 26.
[45] E.Selimi-Osmani, vepër e cituar faq.26-30.
[46] Monografi e shkurt-Unikate e gjetur në Arhivin e Stambollit.
[47] M.Mirçevsk, vepër e cituar.
[48] M.Mirçevska, vepër e cituar f. 52
[49] 28.01.2011, Tetovë




Ja si do dukej Liqeni i Dibrës pa Radikën...

# blogger

## ANEKDODA E MUAJIT

Selimi, një fshatar nga një fshat i thellë i Dibrës, çdo mbrëmje vone dilte dhe me një krrabë dhe lidhte korentin e shtëpisë te linja elektrike që kalonte pranë dhe, herët në mëngjes, pa zbardhur dita, ngrihej dhe i hiqte.

Kur u shpall lajmi se do kishte burg për vjedhësit e energjisë, ai nuk hoqi dorë nga zakoni, por e ndryshoi orarin: Tani i hidhte telat mbi linjë me dy pashë diell, dhe e hiqte vonë në mëngjes, kur njerëzit fillonin lëvizjen.

Një dite, një bashkëfshatar i tij, që kaloi aty pranë dhe e pa që hidhte telat, i tha:

- O Selim, mos e lidh ma korentin ashtu, se kan për të t'fajt n'burg! A i ke pa lajmet çish kanë than', apo si ke ngjue?

- Aaaa, bre, Brahim! I kam pa mor lajmet, i kam pa, se gjith natën sa ke njani kanal, ke qetri, se xhumi nuk m'ze! Por, mor kushaj, kur qeveria nuk dënon ata si na kanë vjedhë miliona çe 20 vjet, se ka kush menjen ke un' e ke taj! A e shef si na ka met vetëm koci, se xhakun na e kan paj çato qeveri...

- Ngjom mue, kanë fillue me shtaj n'burg fukarejtë, si taj e si unë, ene na nuk kemi pare me dal prej burgu, si ministrat e qeverisë, e kemi për t'met mrena e s'ka kush me na ardh mrapa!, këmbëngulte në të veten Brahimi.

- Vallahi, o Brahim, çat dekik jam tu prajt! T'paktën ni pjat grosh kanë me ma pru, se me këtë koh si ka ardh, burgu asht tu mu duk ma i majr se varfnia si m'ka kap mu...

## Ditari i një vajze...

# Leksione dibrançe nga një jo-dibran

E po mor ditar, me marr leksione dibrançe nga një jo-dibran s'ma kish marrë mendja. Po, po, me rregulla, sintaksë, intonacion e të gjitha! Po ja, kam një mik unë që ka origjinën nga jugu dhe herën e parë që ka ardhur në Peshkopi e kanë pyetur:

- "A burrë i fortë?"

- "Jo dhe aq...", -u përgjigj ai, pasi kish kujtuar se po e ftonin në ndonjë duel.

Që prej asaj dite mendoi se duhet ta njihte më mirë gjuhën dibrane nëse do rrinte me dibranë, dhe duke qenë studiues, e morri shqyrtimin e dibrançes me shumë rigorozitet:

- "Mirë bëhet m**ëj**r, shp**i** bëhet shp**ëj**, p**i** bëhet p**ëj**, .. atëherë edhe b**i**rrë bëhet b**ëj**rr!"

- "Joooo, -i them unë,- jo çdo fjalë me ***i*** bëhet me ***ëj***!"

- "Mirë, - më thotë dhe kur vjen kamarjeri porosit,- un' desha nji kapuç**ëj**no me bust**ëj**n."


"Boboo na marrëj!", -mendova me vete. Pastaj vazhdoi me rregullin e rradhës:

- "Në dibrançe çdo grup bashkëtingëlloresh ***pl*** apo ***pj*** bëhet ***q***."

Ndërkohë që unë po e shikoja krejt habi, ai vazhdon:

- "**Pl**ep bëhet **q**ep, **pl**uhur bëhet **q**uhën.. kështu i bie që edhe fjala **pl**uralizëm të bëhet **q**uralizëm. Ashtu si edhe **pj**ek bëhet **q**ek ..dhe kështu për**pj**ekje bëhet për**q**ekje. Pastaj çdo ***mj*** bëhet ***nj***: **mj**alt - **nj**alt, **mj**aft - **nj**aft, **mj**ekër - **nj**ekër, madje edhe macet në Dibër duhet të bëjnë '**nj**au', jo '**mj**au'.

Kurse tjetra është kur ***bl*** bëhet ***gj*** tek fjalët **gj**et (**bl**etë) apo **gj**ej (**bl**ej). Por nuk mbaron këtu, pasi edhe fjalët, që në gjuhë letrare duken si këto në dibrançe, lakohen më tej dhe ju nuk ngatërroheni kurrë. Psh. vërtetë **bl**etëve iu thoni **gj**et, por 'të **gj**ej' i thoni 'me **xh**et'.. dhe pavarësisht se **pl**epi bëhet **q**ep, **q**epës i thoni **ç**ep dhe çdo gjë është në rregull."




Për këtë të fundit m'u kujtua një histori kur një gjyshe dibre kish takuar nipin e rritur në Tiranë dhe i kish thënë:

- "Jalla me nanën qëke rrëjt e qëke bë si qep!"

- "Ua mi nana, pse a si qepë të dukem unë ty?"- i thotë djali që nuk e kishte mësuar këtë lakimin e fjalëve në dibrançe si ki lum mëjku.

Diçka tjetër që i kish bërë përshtypje "studiuesit" të dibrançes ishte kur shtohet **ç** para fjalëve **ç**tu, **ç**aj **ç**aqe, **ç**tahaj, etj. si dhe shumësi i fjalëve:

- "Shumësi i mollëve bëhet molla, qershi thuhet qershia. Kurse kos dele i thuhet kos delje, lule delje, lesh delje."


Ndërkohë që të gjitha këto i shqiptonte me intonacionin tipik dibran, më thotë se sipas tij, dibranët janë shumë praktikë pasi shprehja më origjinale dibrane është: "***Cullve lloju mullën e fëjtu shpullën***".

Duke qeshur me të madhe po mendoja, po qe se këto rregullat bruto të shqiptimit dibrançe përmblidhen në një monografi, a thua ka treg shitje?

*Ndiq linqet e mëposhtëme në Web dhe Facebook për më shumë foto dhe komente nga Peshkopia e Dibra...*


***http://peshkopidiberalbania.wix.com***

***https://www.facebook.com/PeshkopiDiberAlbani***



Petitioning The Albanian Government after 2013 general elections

Complete the construction of the Arbëri Road - Ndërtoni sa më shpejt dhe me standarde Rrugën e Arbërit




**Firmos** dhe **komento peticionit** në **change.org**

**http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides**

**Pajtohu në gazetën**

***RRUGA E ARBËRIT***

***Merr versionin* PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj**



**Për informacion: E-mail: rrugaearberit@gmail.com**

**Tel: +355 69 20 68 603**

Rruga e Arbërit nr. 102

portret

# Heroina e Popullit **Hibe Palikuqi**

*Nga* **XHELAL ROÇI**

*(Vijon nga numri i kaluar)*

Në fillim të verës 1944, Hibe Palikuqi u kthye përsëri në radhët e partizanëve, në batalionin partizan të Dibrës. Mori pjesë në të gjithë veprimet luftarake të Batalionit.

Më datën 18 gusht 1944 u krijua Brigada e XVIII Partizane Sulmuese në fshatin Sllatinë të Sllovës në Dibër. Gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre bënë të gjithë përpjekjet për të shpërndarë forcat partizane të Brigadës së V partizane sulmuese si dhe forcat e tjera partizane në zonën e Dibrës me synim që të sabotonin e të mos lejonin formimin e Brigadës së XVIII Sulmuese. Efektivi i Brigadës së XVIII Sulmuese u hodhë menjëherë në luftime të ashpra në qafën e Skërtecit. Vargmalit të Korabit ku ishin përqendruar forcat gjermane. Kampin gjerman e sulmoi Brigada e V partizane dhe forcat e Brigadës XVIII partizane të sapo krijuar. Forcat gjermane u shpartalluan duke lënë shumë të vrarë dhe lanë shumë materiale luftarake me të cilat u kompletuan partizanët e Brigadës XVIII.

Në këto veprime luftarake mori pjesë edhe efektivi i Batalionit të IV të Brigadës XVIII ku ishte efektiv Hibe Palikuqi i me detyrë zëvendëskomisar i Kompanisë së Parë dhe vëllai i saj Esheref Palikuqi me detyrë zëvendëskomisar i kompanisë së dytë.

Shtab i Divizionit të parë partizan Sulmues urdhëroi Shtabin e Brigadës XVIII partizan Sulmues që të dërgonte batalionin e IV partizan në zonën e Kërçovës në territorin e Maqedonisë për të bashkëpunuar me forcat partizane maqedonase për të çliruar nga nazistët gjermanë e bashkëpunëtorët e tyre zonën e Kërçovës.

Deri atëherë Batalioni i IV i Brigadës XVIII partizane "Sulmuese" vepronte në zonën e rrethit të Matit për spastrimin e bandave e mbeturinave të reaksionit, ishte bashkëpunëtor të okupatorit.

Në bazë të urdhrit të dhënë nga Komanda Eprore, Batalioni i IV partizan shoqërohej nga zëvendëskomandanti i Brigadës XVIII Sulmuese Sotir Vullkani. Nisja e Batalionit u bë më datën 16 shtator 1944 nga fshati Lis i Matit, kaloi nëpër Qafë Muhurr, në Peshkopi dhe natën e datës 18 shtator 1944 mbërriti në qytetin e Dibrës së Madhe.

### DITARI PARTIZANIT PANDI ALLABASHI, PËRGJEGJËS RINIE I BATALIONIT

Nga komanda partizane e ushtrisë shqiptare Maqedonisë ishte ngarkuar për t'i pritur Qemal Agolli, shqiptar nga qyteti i Dibrës së Madhe, i cili mori takim me komandantin e batalionit të IV të Brigadës XVIII dhe me shokun Sotir Vullkani. Qemali e orientoi dhe caktoi itinerarin e rrugës që duhet të ndiqte efektivi i batalioni ttë IV partizan për të shkuar në vendin e veprimeve luftarake. Batalioni vazhdoi marshimin sipas detyrës.

Partizanët shqiptarë kudo që kalonin priteshin me dashuri e respekt nga banorët vendas dhe Këshillat Antifashistë Nacionalçlirimtar, atje ku ata ishin ngritur. Këshillat Antifashistë Nacionalçlirimtar bashkë me fshatarët strehonin partizanët për t'u çlodhur e për të fjetur, u jepnin për të ngrënë e për të pirë më shumë respekt e dashuri. Komandanti i Batalionit të IV të Brigadës XVIII Gafurr Mehmeti dhe Komisari Garip Sojli (më vonë ky i fundit u dënua për arratisje jashtë shtetit) mori në dorëzim detyrën luftarake. Komandan i Kompanisë së Parë ishte Demir Leka nga fshati Zogje i Dibrës dhe komisar Asllan Keta nga Bulqiza e Dibrës. Është dëshmor i atdheut.

Zëvendëskomisar i kompanisë së parë ishte Hibe Palikuqi, ndërsa i vëllai i Hibes, Esherefi ishte zëvendëskomisar i kompanisë së dytë.

Gjatë datave 19-20 dhe 21 shtator 1944, Batalioni kreu marshimin nëpër fshatra. Në zbatim të detyrës së marrë në mes të natës 21 dhe 22 shtator 1944 duke u gdhirë, batalioni u grumbullua dhe u nis në drejtim të lartësisë së malit Ceconit (kulla), kuota 1172-1234 në lindje e në verilindje të qytetit të Kërçovës. Në fund të këtij Mali në drejtim veriperëndimor dukeshin fshatrat më të afërt, me banorë shqiptar të Maqedonisë si Irinovski, Llazarefski, Premka, Shutova, Strelci, Gorani etj si edhe një pjesë e qytetit të Kërçovës. Forcat partizane maqedonase e kishin detyrua armikun që të tërhiqej në fushën e Zajasit. Në këtë vend ishin dislokuar forca të mëdha të ushtrisë naziste dhe bashkëpunëtor të tyre, të garnizonit të Kërçovës. Prej këtu ku ndodhej efektivi i batalionit të IV partizan dëgjoheshin edhe krisma të armëve, pushkë e automatike të partizanëve maqedonas që vazhdonin sulmin ndaj armikut, në krahun e djathtë të batalionit të IV.

Në të gdhirë të datës 22 shtator 1944, shtabi i batalionit të IV partizan filloi sulmin në zbatim të detyrës luftarake. Forcat e batalionit do të mësynin armikun për të çliruar qytetin e Kërçovës duke i kryqëzuar goditjet me forcat partizane maqedonasve që vepronin në dy anët e batalionit partizan të IV, në të djathtë e në të majtë.

Kompania e parë me komandant Demir Lekën dhe me zëvendëskomisaren Hibe Palikuqin u takoi të mësynin në drejtim të fshatit Shutova. Duke shfrytëzuar terrenin e thyer e të pyllëzuar, forcat partizane u afruan deri afër pozicioneve armike dhe porsa e u dha sinjali, partizanët u hodhën në sulm kundër armikut. Luftimet ishin të përgjakshme, forcat armike u thyen. Gjermanët lanë 19 të vrarë dhe dy vetë u kapën rob. Nga forcat partizane u plagosën dy partizanë. Njëri prej tyre ishte mitraljeri dhe skuadërkomandanti trim i kompanisë së dytë Nazif Iskurti nga fshati Pollozhan i Peshkopisë që pas disa ditësh vdiq dhe është dëshmor.

Komanda e kompanisë së parë me të hyrë në fshatin Shutovë, menjëherë ngriti flamurin shqiptar, shqiponjën me dy krenare, në minaren e xhamisë së fshatit Shutovë. Ky veprim i gëzoi pa masë fshatarët e këtij fshati. Ata shkuan tek partizanët e i përqafuan dhe i përgëzuan. I ftonin në shtëpitë nga ky sukses, armiku solli forca të shumta në numër të komanduar nga bashkëpunëtori i gjermanëve Xhem Gostivari dhe në orët e pasdites forcat e armikut u hodhën menjëherë në kundërsulm. Forcat partizane maqedonase duke mos e përballuar sulmin e forcave armike u tërhoqën nga vija e frontit pa njoftuar forcat partizane të batalionit të IV të Brigadës XVIII. Ky veprim krijoi situatë të rëndë për forcat e batalionit partizan të IV. Armiku mori masa të shpejta për t'i rrethuar këto forca nga të tre anët (drejtimet). Mbeti vetëm një rrugëdalje, në një terren territor të zhveshur dhe që rrihej pa reshtur nga zjarri i mitralozave të rëndë dhe të lehtë të forcave armike. Forcat armike rrezikonin ta rrethonin batalionin e IV partizan. Forcat e batalionit të IV luftonin me heroizëm. Raporti i forcave me armikun ishte 8 me 1 në favor të armikut.

Komanda e Batalionit urdhëroi tërheqjen e forcave partizane, efektiv të kësaj njësie, në mënyrë të kujdesshme pa e ndërprerë sulmin ndaj armikut. Në orën 18 të datës 22 shtator 1944 filloi tërheqja e kompanisë së parë. Drejtimi i tërheqjes ishte në një terren shumë të vështirë ku armiku godiste papushim. Forcat armike përpiqeshin me të gjitha mënyrat për të mbyllur shtegun e tërheqjes. Forcat armike kishin përparuar shumë në mbylljen e krahut të djathtë të Batalionit. Ata arritën të kapin kodrat duke qenë në pozita të favorshme hapën zjarr të dendur kundër partizanëve të kompanisë së parë që sapo kishte mundur të shpëtonte nga rreziku i rrethimit të plotë dhe po tërhiqej nën breshërinë e predhave të armikut, nëpër një shpat kodre të zhveshur, deri sa doli tek qafa. Ndërsa pararoja e Batalionit vazhdonte rrugën e tërheqjes, forcat e tjera t ë batalionit mbanin të gozhduar armikun mos përparonte e të mbyllte rrethimin forcave të Batalionit të IV.

Hibes dhe shokut të saj, Zenel Pacit nga fshati Cerian i rrethit Dibër iu mbaruan fishekët dhe bombat. Ata hidhen dhe i rrëmbejnë pushkën njërit nga personave të rradhëve të armikut. Po kështu qëlluan dhe i marrin armën e bombat edhe një personi tjetër nga radhët e kundërshtarit.

Ata u nisën nëpër mes breshërisë së plumbave të armikut në rrugën e tërheqjes. Luftimet për të çarë rrethimin vazhdonin gati që para disa orësh por pikërisht kur po ngjiteshin në kodër për të dalë nga rrethimi, automatiku i Hibes pushoi. Atë e kishte goditur një predhë e armikut. Ajo ishte në gjendje të rëndë dhe u rrëzua për tokë. Partizani Zenel Paci që ishte pranë saj, bënte përpjekje që ta ngrente, por edhe ai mbeti në vend i goditur nga një plumb i armikut. Zeneli është dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Komandanti i kompanisë së parë Demir Leka gjatë bisedave i kishte shpjeguar të vëllait të Hibes, Esheref Palikuqit:



"Ne menduam dhe kërkuam nga Hibia si partizane, meqenëse ishte vajzë dhe në moshë të re, të tërhiqej e para nga luftimet në pozicion. Ajo nuk pranonte, në asnjë mënyrë. Kjo bëri që Hibia dha jetën për të shpëtuar shokët që të tërhiqeshin duke i mbrojtur me zjarr. Ajo ishte bërë tmerr për armikun. Ajo dha jetën për çlirimin e atdheut, përfundoi tregimin vëllai i saj Esheref Palikuqi.

Gjatë kësaj beteje ranë heroikisht duke luftuar për çlirimin e qytetit të Kërçovës dhe partizanë të tjerë trima efektiv të kompanisë së parë të batalionit të IV, të Brigadës XVIII Sulmuese, Myrtezan Xhemal Zuna nga fshati Pesjake, Maqellarë i rrethit Dibër, Zenel Paci nga fshati Cerjan, Peshkopi, Haki Bajram Xhika nga fshati Mustafaj i Çidhnës Dibër dhe Haxhi Agush Xhediku nga fshati Sohodoll i Dibrës.

Autori i vrasjes së Hibe Palikuqit pasi u kap në vitin 1945, në hetuesinë e Kërçovës ndër të tjera ka deponuar (pohuar):

- Në luftë e sipër rrethuam disa partizan. U thirrëm të dorëzohen, por s'dëgjuan.

Ajo me automatikun e saj s'na linte të ngremë krye, përgjova çastin kur iu mbaruan fishekët e karikatorit dhe i duhej ta mbushte... Sa mora nishan e plagosa. Nuk u besoja syve të mi kur pashë se ishte vajzë. Isha i bindur se kisha vrarë partizan ndër më trimat se s'ma kapte mendja që një vajzë të luftonte me një trimëri dhe zotësi të rrallë.

I shtyrë nga trimëria e saj e mora dhe e çova në shtëpinë e Hoxhës me shpresë se mos shpëtonte. Aty ajo më tregoi se ishte nënkomisare..." dhe më tej ai pohoi, se ajo ishte shprehur, se kot e keni more të mjerë luftën do ta fitojmë ne, ju do të merrni veten më qafë.

Për shkak të plagosjes së rëndë, Hibia, pas disa orësh mbylli sytë për jetë në shtëpinë e hoxhë Osman Hysenit në Premka Shutova.

Në çastin e fundit të jetës së saj Hibia e porositi të zotin e shtëpisë se: "Merre këtë krëhër dhe këto vathë ia çoni nënës time në Dibër e i thoni të mos qaja se unë vdiqa si dinë me vdes cucat shqiptare për liri...

Në shenjë kujtimi në atë fshat ku u varros Hibia i është ngritur një lapidar. Ndërsa Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë i dha titullin e lartë "Heroinë e Popullit", të njëjtin titull i dha edhe shteti jugosllav.

Gojët e këqia, thashethemexhinjtë çfarë nuk trillonin e kurdisnin kundër Hibe Palikuqit. Ata arrinin të shpifnin duke e akuzuar Hiben për dobësi në karakter. Këto thashetheme dhe intriga i kurdisnin armiq e bashkëpunëtorët e armikut. Vlerësimin Hibia ia bëri vetes.

Ajo skuqi tokën me gjakun e saj dhe populli i këndon:

"... Kush është ajo që prin matanë?
Po thotë Hibia: "Para partizanë!"
Fyt më fyt me nazifashistë
Shtatëmbëdhjetë vjeç ndër komunista
Kush është ajo që truallin skuqi?
Thonë është Hibe Palikuqi..."

## *Jeleku i nusërisë*

Këtë jelek ma kish qep nana
Nuse për t'më ba
Nër jelek i mbylla këngët
Kënga s'kishte za...
Or jelek, jelek me ar
T'rujta pal' në arkë
Me do pika loti
Me do pika gjaku.
Këtë jelek e kish qep nana
Për cucën dibrane
Të ma veshësh kur t'vish nuse
Me liri në male.
Këtë jelek e veshi Hibia
Nuse pa u bë
Ja këtu e ka shpuar plumbi
Me gjak ai është la.
O jeleku me nishan
Yll je për mejdan
O jeleku i nusërisë
Për cucat t'Shqipërisë.

*Këngë për Hibe Palikuqin*

Populli i qytetit të Dibrës së Madhe mbushi radhët e njësive partizane shqiptare. partizanët shqiptarë me emrin e në kujtim të Hibe Palikuqit hidheshin në sulm e në beteja kundër armikut e bashkëpunëtorëve të tij. ata nuk kursyen asgjë për çlirimin e vendit. Dhanë gjakun, mundin dhe bënë gjithçka për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Familjet shqiptare ishin strehë për furnizimin me ushqime, veshmbathje, municione për luftëtarët e lirisë. Ata qëndronin në roje të tyre dhe ua çonin ushqimin e municionin në pozicione.

Në vitin 1946 kur qeveria shqiptare tërhoqi eshtrat e dëshmorëve nga Jugosllavia edhe eshtrat e Hibe Palikuqit u sollën në Shqipëri dhe u varrosën në varrezat e dëshmorëve në Peshkopi.

Më vonë mbi bazën e një marrëveshje eshtrat e Hibes u zhvarrosën dhe u varrosën në vendlindjen e saj në qytetin e Dibrës së Madhe.

Varri i saj në varrezat e dëshmorëve në Peshkopi vazhdon të jetë si varr simbolik. Për veprën e saj revolucionare deri sa dha edhe jetën janë shkruar e botuar shkrime e artikuj të ndryshëm, në gazeta e në revista si dhe emri i saj u është vënë disa objekteve, rrugëve, shkolla e shoqëri kulturore në Shqipëri, Maqedoni e në Kosovë.

Me dekret të Presidiumit të Kuvendit popullor të Republikës së Shqipërisë nr. 4600 datë 22.11.1969, Hibe Palikuqi është shpallur "Heroinë e Populli". Ky dekret historik mban firmën Presidentit të Shqipërisë, Haxhi Lleshi, ish Komandanti i Batalionit Partizan të Dibrës ku ishte efektiv i tij edhe Hibe Palikuqi. Heroinë e popullit e ka shpallur edhe ish shteti jugosllav. Në muajin qershor të vitit 2003 shteti i sotëm maqedonas i ka ngritur një lapidar, bust në qytetin e Dibrës së Madhe, në përjetësim të emrit dhe jetës së saj...

Më datën 22.9.2004 në qytetin e Dibrës së Madhe u organizua mbledhje përkujtimore me rastin e 60-vjetorit të rënies së Hibe Palikuqit në Shutovë, Kërçovë. Ajo u vlerësua si ish bashkë luftëtar. Në mbledhjen përkujtimore të organizuar nga maqedonasit, janë lexuar materiale e folur, sikur ajo ka qenë e ndikuar nga Shkupi... Hibia që nga viti 1942 dhe deri sa vdiq nuk ka njohur as takuar asnjë person maqedonas nga ata të luftës ANÇL.

### LITERATURA


Haki Stërmilli, ditar "Shtigjet e lirisë"
Haxhi Lleshi, kujtime "Vite, njerëz, ngjarje"
Hajri Hoxha "Rinia dibrane në LANÇ". Faqe 120-130
Xheladin Krifca "Dibra dhe Dibra e Madhe në luftë", f. 37
Historiku i LANÇ të popullit dibran
Brigada e XVIII Sulmuese, f. 75-85
Kujtime nga njerëz të familjes. Esheref Palikuqi, Vasfi Xheladini
Qytete shqiptare Dibra e Madhe, f. 68, 368, 370, 419, 432
Ditari partizan i Pandi Allabashit
Gazeta "Flaka" e vëllazërimit, nr. 17, viti 1946
Dibra Almanak, nr. 2 viti 1970
Libri "Gruaja Shqiptare në LANÇ.

# Mësuesja Vera Shkurti në Greqi, një zë i qetë rilindësish

*Nga* **NEXHMIJE MEHMETAJ**
*mësuese në Zvicër*

"Vera - mësuese në dy ishuj" - Një film dokumentar nga Abdurahim Ashiku dhe Arian Melonashi nën vështrimin e Nexhmije Mehmetaj, mësueses nga Kosova që për më se një dekadë u mëson fëmijëve të mërgimtarëve në Svicër të shkruajnë, lexojnë, recitojnë dhe këndojnë në gjuhën e nënës, gjuhën e bukur shqipe... Dokumentari për herë të parë u shfaq për mësuesit mërgimtarë mbledhur në seminarin e 10-të mbarëkombëtarë për mësimin plotësues të gjuhës shqipe më 31 korrik 2014 në Berat... Një pikë loti mbi qerpik u mbeti mësuesve ndërsa ndiqnin Vera Shkurtin, mësuesen e ishujve Tinos e Siros në hapësirën detare të Egjeut, një pikë që do të formonte një rrjedhë malli dhe dashurie për Verën dhe mësuesit në Greqi, që tash që nga 7 marsi 2001 përpiqen me një vullnet të jashtëzakonshëm të hapin shkolla për tu mësuar fëmijëve, pa asnjë shpërblim, përmes privimeve të panumërta , gjuhën e nënës... Pritet që shpejt filmi dokumentar do të jepet i titruar në gjuhën greke për banorët shqiptarë dhe miqtë e tyre grekë që ndihmuan për hapjen e shkollave shqipe në dy ishujt e Egjeut.

***Nexhmije Mehmetaj nënvizon:***

***...Në disa qytete mërgimtarët kanë hapur shkolla, në të cilat mësuesit vullnetarë, pa rroga, ua mësojnë fëmijëve shkrim - leximin në gjuhën shqipe.***

***....Ministria e Arsimit e Republikës së Shqipërisë, mjerisht, nuk e hapi edhe të vetmen një shkollë shqipe të mësimit plotësues, diku në Evropë, kështu duke e lejuar shprishjen e kombit shqiptar.***

***...Duke parë e përcjellë filmin "Vera-mësuese në dy ishuj" ndjen se ecën dhe nëpër kohën e romantizmit të kaluar të motrave të ndritshme Qirjazi që bënë aq shumë për shkollat e para të shqipes dikur.***

***...Në traditën shqiptare mësuesit i kanë prirë lëvizjes kombëtare e jo rastësisht ata janë martirë ndër të parët. Emrat dihen nga historia.***

***... Vetë emërtimi "Vera-mësuese në dy ishuj" është një zë me shqetësime, për gjuhën tonë dhe kulturën shqiptare, për edukatën familjare, për lidhjen e saj me trashëgimin e të parëve, hap një etapë të re në fushën e arsimit dhe të kulturës shqiptare.***

***... Mësuesja Vera e fillon punën me të njohurit me prindërit, t'i bindë se gjuha amtare është e rëndësishme për fëmijët edhe në kushte larg atdheut. Në anën tjetër merr nismën për t'i parashtruar organeve arsimore greke kërkesën për mbajtjen e mësimit të gjuhës shqipe në shkollën greke. Për fat të mirë autoritetet greke kanë gatishmëri, u lejon falas klasën. Në këtë rast, ajo "luan" rolin e ambasadorit të Shteti – amë, ka dhe s'ka ambasadë shqiptare në Greqi.***

***... Është e domosdoshme që në kuadër të Ambasadës shqiptare të caktohet një person që do të merrej me koordinimin e shkollave të mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Mësuesit të verifikohen dhe t'u lëshohen vendimet dhe t'u rregullohet marrëdhënia e tyre e punës. Kështu duke njohur vetveten do të na njohin dhe të tjerët.***

***.. Sipas mendimit tim filmi duhet të paraqitet në festivalin e përvitshëm Doku Fest, në Prizren.***

* * *

E nisa qetësisht, pastaj me tepër vëmendje kam parë dokumentarin,"Mësuesja e dy ishujve ..." të publicistit Abdurahim Ashiku (skenari) realizuar me mjeshtëri nga regjisori Arjan Melonashi. Në llojin e vet, filmi dokumentar hyn në krijimet që janë sa thesar kulture për njeriun- mësues dhe mjekim për shumë plagë kombëtare.






**Vetë emërtimi "Vera-mësuese në dy ishuj" është një zë me shqetësime, për gjuhën tonë dhe kulturën shqiptare, për edukatën familjare, për lidhjen e saj me trashëgimin e të parëve, hap një etapë të re në fushën e arsimit dhe të kulturës shqiptare. Mësuesja Vera e fillon punën me të njohurit me prindërit, t'i bindë se gjuha amtare është e rëndësishme për fëmijët edhe në kushte larg atdheut.**

Në ndërtimin e tij jepet një panoramë mërgatës së re shqiptare e ngulitur në skajet më të largëta të Greqisë, në ishujt Tinos dhe Siros të lidhur me detin Egje. Ndërkaq mësova se jetën e bashkatdhetarëve tanë në Greqi para se gjithash e karakterizojnë përpjekjet për të ruajtur identitetin dhe integritetin e vet kombëtar, kulturor dhe shpirtëror krahas integrimit në shoqërinë pritëse.

Dhe, në disa qytete mërgimtarët kanë hapur shkolla, në të cilat mësuesit vullnetarë, pa rroga, ua mësojnë fëmijëve shkrim - leximin në gjuhën shqipe. Për fatin e shqiptarëve në mërgim sikur edhe më përpara askush nuk interesohet, sidomos për të organizuar bashkëpunimin arsimor, kulturor me ta! Çka do të thotë kjo padrejtësi? Cili popull tjetër evropian ka sot kësi fati? Ministria e Arsimit e Republikës së Shqipërisë, mjerisht, nuk e hapi edhe të vetmen një shkollë shqipe të mësimit plotësues, diku në Evropë, kështu duke e lejuar shprishjen e kombit shqiptar.

Duke parë e përcjellë filmin "Vera-mësuese në dy ishuj" ndjen se ecën dhe nëpër kohën e romantizmit të kaluar të motrave të ndritshme Qirjazi që bënë aq shumë për shkollat e para të shqipes dikur.

Me sa duket, shqiptarëve u duhet herë pas herë të përsërisin diçka nga e kaluara e tyre, pikërisht atë pjesë që të huajt apo rrethanat e krijuara prej tyre nuk e kanë lënë kurrë të piqet e plotë. Kur them kështu mendoj sidomos te gjuha dhe shkolla shqipe të cilën fëmijët shqiptarë edhe pse larg atdheut nuk duhet ta harrojnë! Pedagogia dhe patriotja Vera Shkurti, mësuesja vullnetare këtij fenomeni të pikëlluar i thotë "JO", qoftë dhe duke përballuar në mundin e djersën saj e të familjes halle të vazhdueshme.

Në mërgim vështirësitë janë të kuptueshme, ajo flet qetë si me zë rilindësish: "Kjo duhet bërë, e dikush duhet ta bëjë"! Sikur në epokën e madhe të Rilindjes sonë Kombëtare! Të kujton thënien e bukur të një dijetari vetëflijues për kombin e vet: "Po s'u dogja unë, po s'u dogje ti, kush do bëjë dritë " ?! Më shumë se "Vera..... ", s'do të fliste asnjë titull për një dokumentar që sjell rrugëtimin e saj atdhetare dhe arsimor. "Mërgimtarët këtu punojnë të mbajnë familjen, d.m.th. kanë ikur nga halli e ndodhen në hall. Megjithatë mendjen nuk e ndajnë nga vendlindja, që ta ndihmojnë sa mundin atë". Ajo gjykon se shërbimi më i mirë për ta është që t'u mësojnë gjuhën amtare fëmijëve të tyre për të ruajtur e përcjellë shqipen në breza. Në traditën shqiptare mësuesit i kanë prirë lëvizjes kombëtare e jo rastësisht ata janë martirë ndër të parët. Emrat dihen nga historia.

Vetë emërtimi "Vera-mësuese në dy ishuj" është një zë me shqetësime, për gjuhën tonë dhe kulturën shqiptare, për edukatën familjare, për lidhjen e saj me trashëgimin e të parëve, hap një etapë të re në fushën e arsimit dhe të kulturës shqiptare. Mësuesja Vera e fillon punën me të njohurit me prindërit, t'i bindë se gjuha amtare është e rëndësishme për fëmijët edhe në kushte larg atdheut. Në anën tjetër merr nismën për t'i parashtruar organeve arsimore greke kërkesën për mbajtjen e mësimit të gjuhës shqipe në shkollën greke. Për fat të mirë autoritetet greke kanë gatishmëri, u lejon falas klasën.

Në këtë rast, ajo "luan" rolin e ambasadorit të Shteti – amë, ka dhe s'ka ambasadë shqiptare në Greqi. Shqiptarët në mërgim me doemos duhet ta ruajnë identitetin shqiptar, kulturën dhe gjuhën e vet! Kjo nuk është një reklamë "patriotike"e vjetruar, por për të ndërtuar identitetin dy kulturor e dy gjuhësor në të cilin edhe elementet e kulturës amtare edhe ato të vendit të ri kanë rëndësinë e duhur. Kjo gjë ndihet më afër kur Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës dhe e organizmave të tjerë ndërkombëtar, të ushtron autoritetin e bashkëpunimit për mes marrëveshjeve mes dy shteteve. Në bazë të misionit që ka, të përpiqet për integrimin e kulturës gjuhësore të nxënësve në kulturën evropiane dhe paralelisht me këtë edhe përgatitjen për ta njohur mësimin plotësues të gjuhës shqipe për fëmijët shqiptarë jashtë atdheut. Kjo natyrisht edhe një realizim i të drejtave dhe zbatim i detyrave të përcaktuara në ligjet ndërkombëtare të drejtave të fëmijës dhe e Republikës së Shqipërisë.

Është e domosdoshme që në kuadër të Ambasadës shqiptare të caktohet një person që do të merrej me koordinimin e shkollave të mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Mësuesit të verifikohen dhe t'u lëshohen vendimet dhe t'u rregullohet marrëdhënia e tyre e punës. Kështu duke njohur vetveten do të na njohin dhe të tjerët. Natyrisht që vlera e filmit do t'i shtohej sikur të përmendeshin edhe emrat e mësueseve tjera që punojnë me përkushtim në Greqi. Do donim t'i shihnim këtu të gjithë: Valbona Hystiuna, Dashmirë Zaçe, Iris Hajdinaj në Selanik, Alma Hani, Almira Gjini e shumë të tjera. Sipas mendimit tim filmi duhet të paraqitet në festivalin e përvitshëm Doku Fest, në Prizren, të gjendet mundësia që të përkthehet në anglisht.

*Delemont, 13 tetor 2014*



Rruga e Arbërit nr. 102

homazhe

"Megjithëse babai im, Miftar Fana, mbante medalje e titujt më të lartë, asnjë prej tyre nuk i hynte në sy përpara nderit që i bëri Bashkia dhe Këshilli Bashkiak i Peshkopisë".

# "Nderi i vendlindjes" mbi të gjithë titujt

*Nga* **FAIK XHANI**

Më datë 25 tetor 2014, në një nga sallat e Pallatit të Kulturës, në një atmosferë shumë komode dhe të ngrohtë, me një pjesëmarrje si rrallë herë Këshilli Bashkiak i Peshkopisë organizoi ceremoninë e dhënies së titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Peshkopi Miftar Fanës, pas vdekjes.

Në këtë ceremoni nderimi e vlerësimi morën pjesë: Deputeti i zonës Sherfedin Shehu, nga Federata e Radioamatorizmit z. Fatos Demeti, N/kryetari i Komunës Sllovë Dashuri Leka, familjarë, të afërm, këshilltarë, njerëz të artit e kulturës, krijuesit: Hysen Kosovrasti, Ymer Keta, Hamdi Skeja, Donika Paci dhe plot shokë, miq dhe sportistë jo vetëm nga qyteti i Peshkopisë, por edhe nga Kruja, Elbasani dhe Tirana.



Nën kujdesin e moderatores Era Balliu fjalën fillimisht e mori Kryetari i Bashkisë Peshkopi z. Ilir Krosi. Ai falenderoi të pranishmit dhe bëri një rezyme të shkurtër rreth figurës, rolit dhe veprimtarisë të birit të Dibrës, Miftar Fanës. Kryebashkiaku theksoi se Miftar Fana qe një personalitet dhe figurë e spikatur e sportit shqiptar, një dibran që ka bërë shumë për Dibrën e dibranët. Ai mbante Medaljen "Nderi i Kombit", por vlerësimin që i bëri Këshilli Bashkiak i Peshkopisë e priti me shumë kënaqësi. Ne patëm menduar ta organizojmë shumë më ndryshe këtë ceremoni dhe qemë në detajet e fundit, kur sëmundja e rëndë i mori jetën Miftar Fanës.

Bashkia Peshkopi dhe Këshilli Bashkiak i saj organizoi këtë ceremoni modeste, duke qenë krenarë për një figurë dhe personalitet të tillë si Miftar Fana.

Në këtë ceremoni nderuese foli edhe Deputeti i Zonës z. Sherfedin Shehu, i cili vuri theksin në vlerat humane dhe njerëzore të Miftar Fanës. Në veçanti ai u fokusua: Në vështirësitë, këmbënguljen dhe vullnetin e fortë që pat Miftar Fana, cilësi që me meritë e bënë të bëjë karrierë. Miftari qe një njeri i thjeshtë dhe shumë i dashur. Si qytetar dhe si kuadër që kishte bërë vend mirë në komunitetin e kryeqytetit ishte shumë i vëmëndshëm, i kujdesshëm dhe përpiqej t'i ndihmonte njerëzit, e në veçanti dibranët. Edhe mua personalisht më ka qëndruar shumë afër, në vitet e para, kur u vendosa me banim në kryeqytetin e Shqipërisë. Gjithashtu deputeti Shehu falenderoi kryetarin e Bashkisë Ilir Krosi dhe Këshillin Bashkiak për vendimin e duhur që mori.

Lidhur me vlerat dhe kontributin që ka dhënë Miftar Fana si personalitet i Sportit Shqiptar foli z. Fatos Demeti dhe ish-një nga radioamatorët më të spikatur e më të vjetër z. Hyqmet Shupeja.

Konsiderata të larta për Miftar Fanën solli edhe z. Rrahim Kaleci, ish-radioamator, ku jo vetëm ai, por të gjithë sportistët radioamatorë të Dibrës krenoheshin dhe ndiheshin mirë, se kishin në krye të atij sporti një figurë si Miftar fana, i cili interesohej mrekullisht për ta.

Djali i Miftarit, Neshat Fana, u fokusua kryesisht në disa tipare dhe veti të Miftar Fanës, veçanërisht si prind dhe si njeri human, i cili i shtriu dorën dhe i dha krahun cilido dibrani, qytetari e sportisti që iu drejtua për ndihmë. Njëkohësisht z. Neshat Fana vlerësoi shumë kujdesin dhe dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Peshkopi babait të tij, falenderoi Këshillin Bashkiak, Kryetarin e Bashkisë z. Ilir, të gjithë të pranishmit që morën pjesë në këtë ceremoni vlersimi. Ai Theksoi: "Megjithëse babai im, Miftar Fana, mbante medalje e titujt më të lartë, asnjë prej tyre nuk i hynte në sy përpara nderit që i bëri Bashkia dhe Këshilli Bashkiak i Peshkopisë. Ai garantoi për mirënjohje dhe kontribut të vazhdueshëm në dobi të Dibrës dhe dibranëve. Gjithashtu për të pranishmit shtroi edhe një kokteil.

Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës "BPPSH" Faik Xhani vlerësoi lart dhënien e titullit "Qytetar Nderi" Miftar Fanës. Ai ndër të tjera theksoi: "Vendimi që morët ju sot përligj më së miri jo vetëm nderimin e Miftar Fanës, por edhe civilizimin e progresin e këshilltarëve të kësaj bashkie. Hulumtimi, vlerësimi dhe nderimi i Miftar Fanës, por edhe shumë figurave e personaliteteve nga komuniteti dibran tregojnë se Kryetari i Bashkisë z. Ilir Krosi dhe këshilltarët e kësaj Bashkie nuk kanë mbetur pre e miskinitetit, mediokritetit, por ecin me kohën, janë të vendosur dhe të obliguar për t'i dhënë Peshkopisë, Dibrës dhe dibranëve më të mirën e mundëshme. Dhënia e këtij titulli Nderi është nxitës e motivues jo vetëm për familjarët e Miftar Fanës, por për të gjithë ata që e patën koleg, shok e mik Miftarin, për t'i shërbyer sa më mirë vendlindjes, atdheut e kombit..."

...është koha për t'u pajtuar...
KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com
vetëm 600 lekë në vit

# Genc Bardulla, njeriu që jetoi lirinë



Me disa emra, gjithmonë i flasim krenarisë sonë. Brenda kësaj të kaluare është jo vetëm nostalgjia për të, por ftesa që ne i bëjmë vetes për të nënshkruar këtë të kaluar në vlera. Prandaj ju jap të drejtë edhe vetes edhe atyre që, qytetarët si Genc Bardulla, i shihnim si legjende, sa më shume që kalojnë vitet.

Zakonisht, kur përkujtojmë ato që nuk jetojnë më në mesin tonë, guxojmë të themi se sa na mungojnë se janë në mesin tonë etj. Në fakt, jo se nuk më vijnë në mendje keto rreshta, por ndryshe deshim të shpreheshim për një mësues që ishte i ndryshem, për një mik, koleg, bashkëqytetar, i cili diti të na thotë me të gjithë qenien e tij se "njeriu kur jeton është i lirë".

Në të vërtetë, mësues Genci ka dhjetë vjet që na mungon. Na mungon mbretëresha e mendjes së tij, fjala, urtësia me të cilën trajtonte gjithë arsyetimet sociale të kohës, aftësia për t'u përballur me gjithçka që e rrethoi dhe në çdo moment diti të triumfojë tek ai vetëm arsyeja.

I lindur dhe i rritur në një nga familjet më të heshme të qytetit të Peshkopisë, që në fëmijëri do të provojë bashkë me gjithë familjen "T'i ndizet zjarri në sy". Babai i pushkatuar, vëllezër e motra nën kujdesin vetëm të nënës. Por dikush zgjedh të mos ia kthejë shpinën dhembjes. I pëlqente shkenca, matematika, fizika, muzika, letërsia, gjuhët e huaja. Mendjes, askush nuk mund t'i verë tela me gjëmba, as nuk mund t'a arrestojë.

Për këtë, kur nisi të mësonte gjermanisht, në moshë shumë të re, e paditën tek partia. Një fjalor në gjermanisht që kish nisur t'a mësonte kur shkonte të kulloste dhinë, ua kish treguar shokëve në shkollë. Por ai nuk e dinte se çdo lëvizje e çdo fjalë e tyre ishte e "shitur". Ndaj do ta thërrasin nënën dhe ajo do të shfajësohej se "nuk dinte të lexonte dhe nuk e dinte se djali i saj lexonte libra të huaj dhe se sa të shkonte në shtëpi, do t'ia griste". Libri nuk u gris, por u mësua e u lexua fshehurazi.

Harresa e kujtesa, shpesh janë dhurata. Janë dhurata, sepse kujtojmë ata që duam dhe harrojmë ato që duam. Jo vetëm pse duam, por sepse mësues Genci qe ndër ne një investim i gjenialitetit dhe fisnikërisë qytetare. Në çdo bisedë apo debat me të, ai gjithmonë ridimensiononte veten në vlera të reja. Vlera që shpesh i kalonin hamendësimet tona si nxënës, si ish nxënës të tij dhe më vonë si qytetar.

Në përpjekjet tona për të sjellë ndër ne kohë të reja, përsëri diti të ulet në njerëzoren dhe për t'iu shfaqur asaj në të gjitha pamjet. Ajo që nuk mund të harrojmë, pos të tjerave, ishte se pranoi gjithmonë të vinte njerëzishëm drejt nesh dhe drejt të gjithë atyrë që e njohën e biseduan vetëm njëherë me të. Mësuesi që kishte lexuar aq shumë dhe që gjithmonë përpiqej të transmetonte edhe tek ne dëshirën për të lexuar, pasionin për muzikën dhe që kur niste të të shpjegonte se sa të rëndësishme janë, nuk harronte të tregonte hollësitë më të vogla.

Në atë gërshetim personazhesh, dukurive të natyrës, shpjegimeve shkencore dhe lidhjeve të tyre me njëra-tjetrën, tregonte se njeriu ka nevojë për librin sepse e ndihmon të rritet dhe duhet të bëjë udhëtime shpirtërore.

Shpesh, ngulmonte aq shumë, sa tani na duket sikur na thotë, si atëherë kur e kishim në mesin tonë: "Më lini të respektoj veten". Dhe në fakt, vlerat dhe kulturat duhen themeluar dhe jo gjithkush ka pjesë në to.

Familja, bashkëshortja, fëmijët, motra, të afërmit, nipërit dhe mbesat nuk mund ta fshehin thyerjen e shpirtit për mungesën e tij. Ndërsa për të gjithë miqtë, shokët e fëmijërisë, kolegët, të njohurit që e kujtojnë me aq nostalgji dhe mirënjohje, po të ishte e mundur takimi me të, do t'i thirrnin me të madhe, sepse u largua shpejt nga kjo bote. Njëzëri do t'i thonin: "Mos thuaj jam i pafajshëm, thuaj nuk e bëj më".

Para disa muajsh, bashkia e qytetit, këshilli bashkiak e vleresoi qytetarin e saj, ish mësuesin e disa brezave, kandidatin e parë pluralist për deputet, z.Genc Bardulla me titullin: "NDERI I QYTETIT".

Për këtë mori shumë vlerësime edhe nga qytetarët e thjeshtë, banorët e hershëm të tij, shokë e miq që nuk mungonin edhe atë ditë. Në fakt, tituj të tillë qytetarie, kishte vite që kishte marrë nga ata që e njohën. E veçanta qe se shumica e atyre që ngritën dorën për të aprovuar vëndimin, ishin ish-nxënësit e tij.

Jeta të rezervon edhe dhembje, edhe lavdërime, edhe suksese. Por kur le pas një emër të mirë, ajo e mund të keqen.

***Sabri Laci, Emrie Skuka, Telman Perleka, Abas Hoxha, Astrit Shehu, Sazan Skuka, Hajrie Uka, Naim Mera***

Vehbi Keta bën pjesë në plejadën e mjekëve më të vuajtur. Kushtet e vështirësitë tejet të mëdha të kohës, kërkesat absurde dhe të egra të ish nomenklaturës së kohës, përfshirë dhe huqet e tekat e saj, ishin aq të ashpra e po aq lodhëse, sa ishte e vështirë t'i përballosh për të mos thënë e pamundur.

# **Vehbi Keta,** *njeriu dhe doktori i mirë*

*Nga* **HASAN LLESHI**
**RAMAZAN BUCI**



Doktor Vehbi Keta ndërroi jetë më 16 shtator 2014-të, duke lënë në pikëllim të thellë jo vetëm të afërmit e tij, por njëkohësisht edhe kolegët, shokët, miqtë e dashamirësit e tij të shumtë, si në Bulqizë, Peshkopi e në mbarë trevën e Dibrës. Vehbiu lindi në Vajkal të Bulqizës më 10 tetor 1939, në një familje me vlera të mira, ku spikatnin mikpritja, bujaria, urtësia, zgjuarsia dhe dashuria për arsim e kulturë. Një dashuri e tillë për shkollën u vu re tek ai që në fëmijëri ku me zell e pasion të papërshkruar ai mbaroi në vendlindje arsimin fillor dhe atë 7 vjeçar të kohës në Zerqan larg familjes, të cilat i përfundoi me rezultate të shkëlqyera. I etur nga dashuria e pasioni i madh që kishte për të vazhduar shkollën, nisur dhe nga rezultatet e shkëlqyera në mësime me të cilat ai kishte mbaruar arsimin 7 vjeçar, u regjistrua pa probleme për të vijuar mësimet në shkollën e mesme atë të teknikumit mjekësor në Tiranë, që gjithashtu edhe këtë shkollë e përfundoi me rezultate të larta. Këto rezultate të arritura në mësime u bënë shkak që ai në vitin 1958-të të nisë studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Tiranës në degën Mjekësi e Përgjithshme. Në vitin 1963 mbaroi fakultetin e mjeksisë po me rezultate të larta, ashtu siç dhe kishte mbaruar ciklet e arsimit parauniversitar, duke u diplomuar kështu si mjek i përgjithshëm.

Nevojat e mëdha që kishte vendi dhe aq më tepër Dibra në atë kohë, për kuadro të lartë në çdo fushë të jetës e veçanërisht në atë të mjekësisë, bënë që dr. Vehbiu të niste punën me vrullin djaloshar të moshës plot pasion e përkushtim në zonën e Gollobordës, e pikërisht në Ostren. Pas qëndrimit prej një viti në këtë zonë, ku "brodhi" në çdo cep të saj pa u lodhur për asnjë moment në shërbim të shëndetit të banorëve, për arsye të ngutshme kuadrosh, dërgohet në një tjetër zonë të Dibrës, kësaj radhë në veri të saj, Sllovë. Në vitet 1965-1967 rikthehet përsëri në zonën e Gollobordës, por kësaj here jo në Ostren, por në skajin më jugor të saj, Klenjë. Pasi ka përshkuar Dibrën nga jugu në veri dhe anasjelltas, në vitin 1967 për merita të dukshme në punën e tij profesionale e shkencore, Vehbi Keta kthehet në vendlindje, në spitalin e Bulqizës, ku pas pak kohësh emërohet drejtor i këtij spitali, për të qendruar në këtë detyrë deri në vitin 1971.

Pikërisht këtu, në vendlindjen e tij, doktor Vehbiu shfaq aftësitë dhe talentin e tij, jo vetëm në fushën profesionale atë të mjeksisë, por spikat dukshëm për aftësitë e talentin në drejtimin e këtij spitali, duke fituar dashurinë, simpatinë e respektin e gjithë banorëve të trevës së Bulqizës.

Puna e tij e mirë plot pasion e përkushtim, ra në sy për mirë edhe tek drejtuesit e kohës, që panë tek ai jo vetëm mjekun pasionant e të përkushtuar në shërbim të shëndetit të banorëve, por edhe drejtuesin e talentuar e mjaft korrekt. Bazuar në të gjitha këto arritje e virtyte, në vitin 1972, Seksioni i Shëndetësisë të ish Komitetit Ekzekutiv të Dibrës, e emëron doktor Vehbi Ketën, drejtor në Qendrën Sanitare Epidemiologjike të Dibrës, vend të cilin e mbajti deri në vitin 1977. Por, duket se edhe pse kaluan vite, dashuria, pasioni dhe vullneti për mësim e dije tek ai nuk u zbehën për asnjë moment, duke bërë që në vitin 1977 tu rikthehet përsëri studimeve për tu specializuar në Spitalin Civil në Tiranë në degën e Gastroenterologjisë. Pas specializimit, ai caktohet mjek gastroenterelog në repartin e Pathologjisë në Spitalin e Peshkopisë, ku punoi me humanizëm, përkushtim, dashuri e kompetencë të plotë. Për të gjitha këto cilësi e vlera, ai emërohet shef i Shërbimit të Pathologjisë, detyrë të cilën e vazhdoi deri sa doli në pension.

Vehbi Keta bën pjesë në plejadën e mjekëve më të vuajtur, kjo duke patur parasysh periudhën e viteve kur ai punoi 1960-1990, vite që karakterizoheshin nga mungesa e kuadrove dhe mjeteve mjekësore në shërbim të pacientëve. Kushtet e vështirësitë tejet të mëdha të kohës, kërkesat absurde dhe të egra të ish nomenklaturës së kohës, përfshirë dhe huqet e tekat e saj, ishin aq të ashpra e po aq lodhëse, sa ishte e vështirë t'i përballosh për të mos thënë e pamundur. Me të tilla vështirësi të kohës u përball edhe Vehbiu, i cili me intelektualizmin, profesionalizmin dhe korrektesën që e karakterizonte në punë dhe jetë, diti të përballojë me mjaft sukses këto vështirësi të asaj kohe, duke e bërë kështu figurën e tij të nderuar e respektuar në të gjithë trevën e Bulqizës, Dibrës dhe më gjërë. I gjithë portreti i tij në misionin fisnik të mjekut, si kuadër, intelektual, shoqëri e kudo, do të mbahet mend gjatë për të mos u harruar në kujtesën e çdo njeriu që e njohu Vehbiun nga afër, si njeri i aftë, serioz, i përkushtuar dhe tejet korrekt. Dhe këta njerëz pa dyshim që janë të shumtë. Por, ajo që do të dëshironim të theksonim në këtë shkrim homazh për doktor Vehbiun, është fakti se nga puna e madhe dhe e vështirë që i takoi të bënte, nisur edhe nga lëvizjet e tepërta të vendeve të punës cep më cep të Dibrës: Gollobordë, Bulqizë, Sllovë, etj, Vehbi Keta mund të konsiderohet me tërë kuptimin e fjalës një "Norman Betyn" i Dibrës.

**Vehbi Keta ishte një njeri i dashur me pacientët, shokët e që respektohej prej tyre për vlerat e spikatura njerëzore, profesionale dhe intelektuale, gjë për të cilën Këshilli Bashkiak Bulqizë, në unanimitet të plotë i ka akorduar atij titullin e lartë "Qytetar Nderi" i qytetit të Bulqizës.**

Vehbi Keta ishte një njeri i dashur me pacientët, shokët e që respektohej prej tyre për vlerat e spikatura njerëzore, profesionale dhe intelektuale, gjë për të cilën Këshilli Bashkiak Bulqizë, në unanimitet të plotë i ka akorduar atij titullin e lartë "Qytetar Nderi" i qytetit të Bulqizës.

Doktor Vehbi Keta u nda prej nesh për tu mbajtur mend si një figurë e nderuar dhe e respektuar e mjekësisë dhe shoqërisë dibrane, statura burrërore e të cilit do të kujtohet me shumë dashuri, respekt e mirënjohje prej tyre.

Me ndarjen nga jeta të doktor Vehbi Ketës, familja humbi njeriun e saj më të dashur, ne humbëm kolegun, bashkpunëtorin, shokun, mikun tonë të nderuar, pacientët e Dibrës dhe Bulqizës humbën mjekun me përvojë, të cilëve u ka shërbyer me devocion e profesionalizëm gjatë gjithë jetës së tij.

Homazhet për doktor Vehbiun u drejtohen djemëve Edit dhe Gentit, vajzës Keti, e të afërmve të tij.

# *Ikja e doktorit* **Ramazan Gjeci**

*Nga* **SABRI GJECI**



Vetëm pak javë më parë u nda nga gjiri i familjes, shokëve e miqve, Ramazan Gjeci ose siç ishim mësuar ta thërisnim, "doktori". Ndonëse në një moshë të konsiderueshme vdekja e tij e papritur la një pikëllim të thellë në zemrat tona, la një zbrazëti të madhe mes miqve e shokëve të shumtë që ishin mësuar ta kishin atë çdo ditë në mes tyre .

Ramazani u lind, u rrit dhe u edukua në një mjedis familjar me ndjenja patriotike e punëdashëse, ruajtës i traditave shqiptare dhe i vlerave më të spikatura të saj. Jeta dhe shkollimi i tij, ashtu si ai i gjithë bashkëmoshatarëve kaloi përmes një kalvari mundimesh të kohës, por që skalitën edhe karakterin e tij ndër vite. Figura e tij humane e njerëzore, dashuria e tij për profesionin e nderuar të mjekut, puna e tij e palodhur në shërbim të njerëzve, inteligjenca dhe maturia në gjykim, vlersimi për njerziët dhe shëndetin e tyre, e bënë atë një figurë të dashur e të respektuar mes tyre.

Të gjithë ato që e kanë njohur doktorin, të gjithë ato shokë e miq të shumtë që ndanin me të çdo ditë hallet e shqetësimet por edhe gëzimet, e mbajnë mend atë si një njeri babaxhan, me një karakter mjaft të fortë, mjaft komunikues e shprehës, një profesionist në fushën e mjekësisë, një portret gjithmonë të ciltër, të qeshur e shakaxhi dhe si një figurë tejet e pastër në sjellje e profesion. Me një përvojë mbi gjysëmshekullore dhe me një begraund të pasur në profesion, ai edhe pse kaloi moshën e pensionit nuk u nda nga detyra humane e mjekut, por me një vullnet dhe karakter të fortë, akoma studionte shkencën mjekësore dhe të rejat në fushën farmaceutike për t'u shërbyer njerëzve kudo me profesionalizëm dhe për të lehtësuar sadopak dhimbjet e tyre. Përveç aftësive profesionale ai në jetën e përditshme, me inteligjencën e tij të lindur në komunikimin me njerzit, nëpër raste gëzimesh apo hidhërimesh, gjendej kurdoherë midis tyre. Mes shakave, alegorive, gojëdhënave apo vetë humorit të tij të hollë, Dr.Ramazani promovonte mes njerëzve vlerat e mëdha të trevave Dibrane, historinë e tyre të lavdishme, fjalën e mençur e të urtë të konakut të Dibrës që shumë figura të njohura të huaja të penës me të drejtë e kanë quajtur "Universiteti i Dibrës". Shpesh njerëzit në bisedat mes tyre e quanin Ramazanin "të veçantin", apo "lezetin e konakut", sepse aftësitë e tij në marëdhëniet me to linin një shije shumë të ëmbël e dashamirëse. Ai jo vetëm me vizita e ilaçe por edhe me fjalë i shëronte njerëzit, u jepte atyre shpresë e kurajo për të haruar e sfiduar sëmundjen e dhimbjen. Shpresa e besimi i të sëmurëve tek doktor Ramazani ishte aq i madh sa ato nuk pranonin të shtroheshin në spital pa u vizituar më parë tek ai. Me punën dhe karakterin e tij të palodhur edhe ai u shërbente atyre në ditë me shi e me diell, në kohë të mirë apo të keqe, ditën dhe natën, në mes të dimrit me dëborë baltë e shi, duke i bërë sfidë moshës dhe shëndetit të tij, vetëm për të qenë pranë të sëmurit, për t'i shërbyer atij me aftësitë prej mjeku dhe me fjalët e tij shëronjëse.

Njerëzit si ai grumbullojnë rreth vetes respekt, admirim dhe konsideratë sa janë gjallë, por ato mbeten në kujtesën e njerëzve dhe respektohen edhe pas vdekjes. Një respekt i tillë u demostrua edhe në përcjelljen e tij për në banesën e fundit ku qindra dhe mijëra shokë , miq e dashamirës i dhanë atij lamtumirën e fundit nga të katër anët e Dibrës. Ndihemi me të vërtetë shumë krenarë për atë respekt e përkushtim të jashtëzakonshëm që na rezervuan njerëzit në ato ditë të vështira për ne. Jemi të obliguar dhe borxhlinj ndaj të gjithëve dhe me këtë rast duam të falenderojmë me dorë në zemër të gjithë ato shokë e miq, të afërm e dashamirës, për nderin që na bënë, për respektin që na falën dhe për fjalët e tyre që lehtësuan zemrat tona. Respekt e mirënjohje për ju o shokë e miq; falenderim e dëshirë që shpërblimi ynë për ju të jetë me vullnetin e Zotit në dasma e gëzime familjare tek të gjithë . Le të mbetet mes nesh kujtimi i bukur i figurës së doktorit të paharruar, le të shërbejë vetë jeta e tij si një frymëzim për brezin e ri që të ecim nën shembullin e tij e t'i shërbejmë njëri-tjetrit siç na shërbeu gjithë jetën e tij doktor Ramazani.

## NGUSHËLLIM

**Qindra bashkëfshatarë dhe miq të familjes, përcollën ditët e shtunën më 1 nëntor për në banesën e fundit Altin Bitrin, i cili në moshën më të mirë u nda nga kjo jetë, duke lënë pas në dhimbje familjen e tij dhe vajzën e vogël.**

**Redaksia i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes!**

# KORABI
## pesë ndeshje me fitore



Shënim

### Është koha të ndihmojmë Korabin!

Ekipi i Korabit, themeluar që në vitin 1935, vazhdon të ruajë akoma traditën shumëvjecare, veçse me këtë sezon me disa ndryshime: Ka mbi 5 javë në kampionat dhe Korabit kryeson renditjen pa asnjë humbje të pësuar. Dhe gjithë ky sukses falë mbështetjes morale tifozërisë dibrane, si në ndeshjet brenda ashtu edhe kur ekipi luan në transfertë.

E vetmja gjë që çalon për momentin me skuadrën e futbollit është financimi. Të gjithë djemtë e ekipit, bashkë me drejtuesit e tij, punojnë krejtësisht në mënyrë vullnetare.

Natyrisht, kjo është për tu përshëndetur, por ka ardhur momenti që të gjithë së bashku të mblidhemi dhe të kontribuojmë për ekipin, qytetarë dhe biznesmenë, që të japim kontributin në të gjitha format dhe mënyrat, edhe kundrejt reklamimit të biznesit që posedon çdo financues, në stadium dhe në fanelat e lojtarëve, në mënyrë që t'a ndihmojmë ekipin e futbollit të vazhdojë sukseset dhe vitin e ardhshëm ta shohim në kategorinë e parë.

Kjo është një thirrje publike, pikërisht në këtë moment suksesi për ekipin e futbollit, e cila është një shenjë që Korabi do ta kthejë shumëfish kontributin në vitet që vijnë.

Korabi është në një moment kyç, dhe çdo kontribut me çdo lloj mënyrë është i mirëpritur!

***S.Ndreka***

**KRYESON GRUPIN DHE RIKTHEN TIFOZËRINË NË STADIUM**

# Kërkohet mbështetje financiare për ekipin

*Nga* **SASHENKA NDREKA**

Kohët e fundit duket se fati po i buzëqesh sportit dibran. Krahas fitores historike të Gjetan Ketës, këtë muaj, ekipi i futbollit Korabi, thyen rekord me pesë ndeshje të fituara rradhazi. Kjo ka entiziazmuar tifozerinë dibrane, të cilët prej shumë vitesh e kishin braktisur stadiumin e Korabit. Pas javës së pestë të kampionatit të futbollit, ekipi i Korabit mban vendin e parë në kadegorinë e dytë me 15 pikë, duke lënë pas ekipe me emër sic janë Erzeni dhe Partizani B.

Nisjen e mirë të sezonit e pohon për gazetën "Rruga e Arbërit" edhe tranjeri i Korabit Erblin Laçi, i cili ka kërkuar që skuadra të qëndrojë me këmbë në tokë, pasi kampionati është i gjatë dhe nuk përfundon me pesë ndeshje.

"Jam tejet i kënaqur me arritjet e deritanishme të ekipit. Më vjen mirë që puna e lodhshme parapërgatitore po na shpërblehet.

Skuadra e tanishme e Korabit ka arritur një rekord të ri. Që nga viti 1935 kur kjo skuadër është krijuar, asnjëherë nuk ka arritur pesë fitore rradhazi brenda dhe jashtë. Duke iu referuar rezultatit të deritanishëm, kryesimit të grupit dhe sulmit më të mirë me dhjetë gola të shënuar, skuadra ka ambicje për t'u ngjitur në kadegorinë e parë", thotë Laçi. "Gjithësesi, thekson ai, asnjë kundërshtar nuk duhet zhvlerësuar. Për momentin ekipi po stërvitet fort për ndeshjen e radhës kundra Domosdovës së Përrenjasit, nën kujdesin e veçantë edhe të ikonës së futbollit dibran, Shpëtim Toskës".

Është për tu përshëndetur puna e lojtarëve dhe drejtuesve të ekipit të Korabit, pasi e gjitha është e bazuar vetëm në pasion e dëshirë, vetëm në vlera morale, pasi asnjëri nga ato nuk marrin asnjë mbështetje financiare. Bashkia e qytetit të Peshkopisë, mbulon vetëm pjesën e infrastrukturës, siç është mirëmbajtja e fushës dhe fjetjen bashkë me ushqim kur ekipi është në transfertë. Mbështetja më e madhe për ekipin e Korabit është tifozeria dibrane, të cilët u bëjnë ballë edhe kushtëve të papërshtatshme klimaterike vetëm për të mbështëtur ekipin e tyre të zemres.

"Tifozeria dibranë sikur është ringjallur. Unë jam për të tretin vit radhazi trajner i Korabit, por të tillë pjesëmarrje nuk kam parë asnjëherë, madje edhe festimet që bëhen në qytet pas ndeshjes, janë diçka e re për ne, që pas ndeshjës Shqipëri-Serbi, tifozët kanë filluar të jenë më të ndjeshëm. Shpresoj shumë që kjo mbeshtetje të shtrihet edhe më gjerë duke mos mbetur vetëm në kuadrin e moralit", ka theksuar për gazetën trajneri i Korabit, Erblin Laçi!




cyan magenta yellow black